

PROFETI  
**JEZUS**  
(PROFETI ISA)

(AS)

**DO TË KTËHET**



**HARUN JAHJA**  
(ADNAN OKTAR)

Profeti Jezus (Isa) (as), ashtu si të gjithë profetët e tjerë, është rob i zgjedhur i All-llahut, të cilin All-llahu e ka caktuar për t'iu bërë thirrje njerëzve për në rrugën e drejtë. Mirëpo, All-llahu i ka dhuruar Profetit Isa (as) disa veti që e veçojnë atë prej profetëve të tjerë, duke qenë ngritja e tij tek All-llahu dhe ardhja e sërishme e tij në tokë ajo më e rëndësishmja prej tyre.

Profeti Jezus (Profeti Isa) (as) nuk u kryqëzua dhe as nuk u vra dhe as që vdiq për ndonjë arsye tjetër. Kur'ani na tregon se ata nuk e vranë dhe as nuk e kryqëzuan atë dhe se All-llahu e ngriti atë në praninë e Tij.

Për më tepër, Kur'ani përmban informacion lidhur me disa ngjarje nga jeta e Profetit Jezus (Profetit Isa) (as) të cilat nuk kanë ndodhur ende. Kështu, ardhja e tij e dytë në tokë është një parakusht që këto ngjarje të ndodhin. Nuk ka dyshim se ngjarjet e rrëfyera në Kur'an me siguri do të ndodhin.

Ky libër paraqet dëshmi se Profeti Jezus (Profeti Isa) (as) nuk ka vdekur, se ai u ngrit në praninë e All-llahut dhe se do të kthehet përsëri. Burimet e përdorura janë vargjet Kur'anore dhe interpretimet e dijetarëve Islamik.



## DY FJALË RRETH AUTORIT

I njohur me emrin HARUN JAHJA, Adnan Oktar, u lind në Ankara në vitin 1956. Pasi kreu studimet fillore dhe të mesme në Ankara, ai studioi për arte në Universitetin Mimar Sinan në Stamboll dhe filozofi në universitetin e Stambollit.

Që nga viti 1980, ai ka botuar mjaft


libra në lidhje me çështje politike, shkencore, dhe fetare. Duke qenë mjaft të vlerësuara në të gjithë botën, këto vepra kanë shërbyer për shumë njerëz si mjet për të gjetur besimin në Zot dhe për të arritur një njohje më të thellë për besimin e tyre. Librat e Harun Jahjasë u drejtohen të gjithë lexuesve, pa marrë parasysh moshën, racën, apo kombësinë e tyre, sepse ata përqendrohen në një synim: të hapin horizontin e lexuesit duke e nxitur atë të mendojë për disa çështje të rëndësishme, si qenia e Allahut dhe Njëshmëria e Tij dhe të jetuarit sipas vlerave që Ai ka përcaktuar për ne.



بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ



اللَّهُ  
رَسُولُ  
مُحَمَّدٍ



**PROFETI JEZUS  
(PROFETI ISA)  
(AS)  
DO TË KTHEHET**

**HARUN JAHJA  
(ADNAN OKTAR)**



## PËR AUTORIN

The author, ëho ërites under the pen-name HARUN YAHYA, ëas born in Ankara in 1956. Having completed his primary and secondary education in Ankara, he then studied arts at Istanbul's Mimar Sinan University and philosophy at Istanbul University. Since the 1980s, the author has published many books on political, faith-related and scientific issues. Harun Yahya is ëell-knoën as an author ëho has ëritten very important ëorks disclosing the imposture of evolutionists, the invalidity of their claims and the dark liaisons betëeen Darëinism and bloody ideologies such as fascism and communism.

His pen-name is made up of the names "Harun" (Aaron) and "Yahya" (John), in memory of the tëo esteemed prophets ëho fought against lack of faith. The Prophet's seal on the cover of the author's books has a symbolic meaning linked to their contents. This seal represents the Koran, the last Book and the last ëord of God, and our Prophet, the last of all the prophets. Under the guidance of the Koran and Sunnah, the author makes it his main goal to disprove each one of the fundamental tenets of godless ideologies and to have the "last ëord", so as to completely silence the objections raised against religion. The seal of the Prophet, ëho attained ultimate ëisdom and moral perfection, is used as a sign of his intention of saying this last ëord.

All these ëorks by the author centre around one goal: to convey the message of the Koran to people, thus encouraging them to think about basic faith-related issues, such as the existence of God, His unity and the hereafter, and to display the decrepit foundations and perverted ëorks of godless systems.

Harun Yahya enjoys a ëide readership in many countries, from India to America, England to Indonesia, Poland to Bosnia, and Spain to Brazil. Some of his books are available in English, French, German, Italian, Spanish, Portuguese, Urdu, Arabic, Albanian, Russian, Serbo-Croat (Bosnian), Polish, Malay, Uygur Turkish, and Indonesian, and they have been enjoyed by readers all over the ëorld.


Greatly appreciated all around the ëorld, these ëorks have been instrumental in many people putting their faith in God and in many others gaining a deeper insight into their faith. The ëisdom, and the sincere and easy-to-understand style employed give these books a distinct touch ëhich directly strikes any one ëho reads or examines them. Immune to objections, these ëorks are characterised by their features of rapid effectiveness, definite results and irrefutability. It is unlikely that those ëho read these books and give a serious thought to them can any longer sincerely advocate the materialistic philosophy, atheism and any other perverted ideology or philosophy. Even if they continue to advocate, this ëill be only a sentimental insistence since these books have refuted these ideologies from their very basis. All contemporary movements of denial are ideologically defeated today, thanks to the collection of books ëritten by Harun Yahya.

There is no doubt that these features result from the ëisdom and lucidity of the Koran. The author certainly does not feel proud of himself; he merely intends to serve as a means in one's search for God's right path. Furthermore, no material gain is sought in the publication of these ëorks.

Considering these facts, those ëho encourage people to read these books, ëhich open the "eyes" of the heart and guide them in becoming more devoted servants of God, render an invaluable service.

Meanëhile, it ëould just be a ëaste of time and energy to propagate other books ëhich create confusion in peoples' minds, lead man into ideological chaos, and ëhich, clearly have no strong and precise effects in removing the doubts in peoples' hearts, as also verified from previous experience. It is apparent that it is impossible for books devised to emphasize the author's literary poëer rather than the noble goal of saving people from loss of faith, to have such a great effect. Those ëho doubt this can readily see that the sole aim of Harun Yahya's books is to overcome disbelief and to disseminate the moral values of the Koran. The success, impact and sincerity this service has attained are manifest in the reader's conviction.

One point needs to be kept in mind:  
The main reason for the continuing cru-



elty and conflict, and all the ordeals the majority of people undergo is the ideological prevalence of disbelief. These things can only come to an end with the ideological defeat of disbelief and by ensuring that everybody knows about the founders of creation and Koranic morality, so that people can live by it. Considering the state of the world today, which forces people into the downward spiral of violence, corruption and conflict, it is clear that this service has to be provided more speedily and effectively. Otherwise, it may be too late.

It is no exaggeration to say that the collection of books by Harun Yahya have assumed this leading role. By the Will of God, these books will be the means through which people in the 21st century will attain the peace and bliss, justice and happiness promised in the Koran.

The works of the author include The New Masonic Order, Judaism and Freemasonry, Global Freemasonry, Islam Denounces Terrorism, The Disasters Darwinism Brought to Humanity, Communism in Ambush, Fascism: The Bloody Ideology of Darwinism, The 'Secret Hand' in Bosnia, Behind the Scenes of The Holocaust, Behind the Scenes of Terrorism, Israel's Kurdish Card, The Oppression Policy of Communist China and Eastern Turkestan, Solution: The Values of the Qur'an, The Enter of Islam and Its Expected Spring, Articles 1-2-3, A Weapon of Satan: Romanticism, Signs from the Chapter of the Cave to the Last Times, Signs of the Last Day, The Last Times and The Beast of the Earth, Truths 1-2, The Eastern World Turns to God, The Evolution Deceit, Precise Answers to Evolutionists, The Blunders of Evolutionists, Confessions of Evolutionists, The Qur'an Denies Darwinism, Perished Nations, For Men of Understanding, The Prophet Moses, The Prophet Joseph, The Prophet Mohammed, The Prophet Solomon, The Golden Age, Allah's Artistry in Colour, Glory is Everywhere, The Importance of the Evidences of Creation, The Truth of the Life of This World, The Nightmare of Disbelief, Knowing the Truth, Eternity Has Already Begun, Timelessness and the Reality of Fate, Matter: Another Name for Illusion, The Little Man in the Tower, Islam and the Philosophy of Karma, The Dark Magic of Darwinism, The Religion of Darwinism, The Collapse of the Theory of Evolution in 20 Questions, Allah is Known Through Reason, The Qur'an Leads the Way to Science, The Real Origin of Life, Consciousness in the Cell, A String of Miracles, The Creation of the Universe, Miracles of the Qur'an, The Design in Nature, Self-Sacrifice and Intelligent Behaviour Models in Animals, The End of Darwinism, Deep Thinking, Never Plead Ignorance, The Green Miracle: Photosynthesis, The Miracle in the Cell, The Miracle in the Eye, The Miracle in the Spider, The Miracle in the Gnat, The Miracle in the Ant, The Miracle of the Immune System, The Miracle of Creation in Plants, The Miracle in the Atom, The Miracle in the Honeybee, The Miracle of Seed, The Miracle of Hormone, The Miracle of the Termite, The Miracle of the Human Body, The Miracle of Man's Creation, The Miracle of Protein, The Miracle of Smell and Taste, The Secrets of DNA.

The author's childrens books are: Founders of Allah's Creation, The World of Animals, The Splendour in the Skies, Wonderful Creatures, Let's Learn Our Religion, The World of Our Little Friends: The Ants, Honeybees That Build Perfect Combs, Skillful Dam Builders: Beavers.

The author's other works on Quranic topics include: The Basic Concepts in the Qur'an, The Moral Values of the Qur'an, Quick Grasp of Faith 1-2-3, Ever Thought About the Truth?, Crude Understanding of Disbelief, Devoted to Allah, Abandoning the Society of Ignorance, The Real Home of Believers: Paradise, Knowledge of the Qur'an, Qur'an Index, Emigrating for the Cause of Allah, The Character of the Hypocrite in the Qur'an, The Secrets of the Hypocrite, The Names of Allah, Communicating the Message and Disputing in the Qur'an, Answers from the Qur'an, Death Resurrection Hell, The Struggle of the Messengers, The Avowed Enemy of Man: Satan, The Greatest Slander: Idolatry, The Religion of the Ignorant, The Arrogance of Satan, Prayer in the Qur'an, The Theory of Evolution, The Importance of Conscience in the Qur'an, The Day of Resurrection, Never Forget, Disregarded Judgements of the Qur'an, Human Characters in the Society of Ignorance, The Importance of Patience in the Qur'an, General Information from the Qur'an, The Mature Faith, Before You Regret, Our Messengers Say, The Mercy of Believers, The Fear of Allah, Jesus Will Return, Beauties Presented by the Qur'an for Life, A Bouquet of the Beauties of Allah 1-2-3-4, The Iniquity Called "Mockery," The Mystery of the Test, The True Evidences According to the Qur'an, The Struggle with the Religion of Irreligion, The School of Yusuf, The Alliance of the Good, Slanders Spread Against Muslims Throughout History, The Importance of Following the Good Word, Why Do You Deceive Yourself?, Islam: The Religion of Ease, Enthusiasm and Excitement in the Qur'an, Seeing Good in Everything, How do the Unwise Interpret the Qur'an?, Some Secrets of the Qur'an, The Courage of Believers, Being Hopeful in the Qur'an, Justice and Tolerance in the Qur'an, Basic Tenets of Islam, Those Who do not Listen to the Qur'an, Taking the Qur'an as a Guide, A Lurking Threat: Heedlessness, Sincerity in the Qur'an.

## PËR LEXUESIN

Arsyeja pse një kapitull i veçantë i është kushtuar teorisë së evolucionit është se kjo teori përmban bazat e të gjitha filozofive anti-shpirtërore (fetare). Pasi që Darwinizmi kundërshtoi faktin e krijimit, dhe me këtë, ekzistencën e Zotit, në këto 140 vitet e fundit ka bërë që shumë njerëz ta braktisin besimin e tyre apo të bien në dyshim. Kështu që, të treguarit se kjo teori është një mashtrim është një detyrë e rëndësishme, e cila është ngushtë e lidhur me religjionin. Është e domosdoshme që ky shërbim i rëndësishëm t'i ofrohet secilit. Disa nga lexuesit tanë mund të kenë shansin që të lexojnë vetëm një nga librat tonë. Kështu që, ne mendojmë se është me vend që një kapitull t'ia kushtojmë kësaj teme.

Të gjitha librat e autorit shpjegojnë në dritën e vargjeve Kur'anore çështje që kanë të bëjnë me besimin dhe njerëzit ftohen që të mësojnë fjalët e Allahut dhe të jetojnë sipas tyre. Të gjitha temat që kanë të bëjnë me vargjet e Allahut janë të sqaruara në atë mënyrë sa që nuk lënë hapësirë për dyshim apo pyetje në mendjen e lexuesit. Stili i qartë dhe i rrjedhshëm bëjnë që lexuesi i çdo moshe dhe nga cilido grup shoqëror t'i kuptoj ato me lehtësi. Ky tregim efektiv dhe i qartë bën të mundur që ato të lexohen shumë shpejt. Edhe ata të cilët ashpërsisht kundërshtojnë natyrën shpirtërore janë të influencuar nga faktet që këto libra dokumentojnë dhe nuk mund të hedhin poshtë vërtetësinë e përmbajtjes së tyre.

Ky dhe të gjithë librat e tjerë të autorit mund të lexohen në mënyrë individuale, apo të diskutohen në grup. Lexuesit e etshëm që të marrin sa më shumë nga librat e shikojnë të dobishëm diskutimin duke ia treguar njëri tjetrit mendimet dhe përvojat.

Përveq kësaj, është në shërbim të madh të religjionit që të kontribohet në prezentimin dhe leximin e këtyre librave, të cilat janë të shkruara vetëm për kënaqësin e Allahut. Të gjithë librat e autorit janë jashtëzakonisht bindës.

Për këtë arsye, ata të cilët dëshirojnë t'ju komunikojnë fenë njerëzve të tjerë, njëra nga metodat më efektive është inkurajimi i tyre që të lexojnë këta libra.

Shpresojmë se lexuesi do të shikojë pasqyrën e librave të tjerë në fund të këtij libri dhe të vlerësojë materialin e pasur në çështjet e lidhura me besimin, të cilat janë të dobishme dhe kënaqësi për t'u lexuar.

Në këta libra, nuk do të gjeni, sikurse në disa libra tjerë, pikëpamje personale të autorit, sqarime të bazuara në burime të dyshimta, stile të zhveshura nga respekti dhe nderimi i duhur i temave të shenjta, e as rrëfrime të pashpresa, dyshim-nxitëse dhe pesimiste që krijojnë dyshime në mendje dhe devijime në zemër.



# PËRMBAJTJA

<b>HYRJE</b> .....	<b>9</b>
<b>FEJA E ALL-LLAHUT ËSHTË ISLAMI</b> .....	<b>11</b>
<b>NJERËZIT NË HALL LUTEN PËR SHPËTIMTAR</b> ....	<b>16</b>
<b>PROFETI ISA (AS), I BIRI I MERJEMES (AS), NË KUR'AN</b> .....	<b>23</b>
<b>KTHIMI I PROFETIT ISA (AS) NË TOKË</b> .....	<b>57</b>
<b>ARDHJA E DYTË NË TOKË E PROFETIT ISA (AS) NË RISALE EN-NUR</b> .....	<b>85</b>
<b>SI MUND TA NJOHIM PROFETIN ISA (AS)?</b> ....	<b>118</b>
<b>PËRFUNDIM</b> .....	<b>132</b>
<b>MASHTRIMI I EVOLUCIONIT</b> .....	<b>134</b>


**[www.harunyahya.org](http://www.harunyahya.org)**  
**[www.harunyahya.tv](http://www.harunyahya.tv)**  
**<http://en.harunyahya.tv>**

# HYRJE

**P**rofeti Isa (as), ashtu si të gjithë profetët e tjerë, është rob i zgjedhur i All-llahut, të cilin All-llahu e caktoi për t'i thirrur njerëzit në rrugën e drejtë. Mirëpo, All-llahu i ka dhuruar Profetit Isa (as) disa veti që e dallojnë atë prej profetëve tjerë, duke qenë ngritja e tij tek All-llahu dhe ardhja e sërishme e tij në tokë ajo më e rëndësishmja prej tyre.

Në kundërshtim me atë që besojnë shumica e njerëzve, Profeti Isa (as) nuk u kryqëzua dhe as nuk u vra dhe as që vdiq për ndonjë arsye tjetër. Kur'ani na tregon se ata as nuk e vranë dhe as nuk e kryqëzuan atë dhe se All-llahu e ngriti atë pranë Tij. Veç kësaj, Kur'ani na njofton me disa ngjarje nga jeta e Profetit Isa (as) të cilat nuk kanë ndodhur ende. Pra, ardhja e tij e dytë në tokë është një parakusht që këto ngjarje të ndodhin. Nuk ka dyshim se ngjarjet e rrëfyera në Kur'an me siguri do të ndodhin.

Përveç kësaj, në një numër shumë të madh të haditheve të besueshme<sup>1</sup> të Profetit Muhammed (saas) mësojmë se Profeti Isa (as) është gjallë në Sytë e All-llahut dhe do të kthehet në tokë dhe se kur të kthehet ai do të sundojë me Kur'an, do të jetë një mjet nëpërmjet të cilit bota e Krishterë do të kthehet në Islam, dhe, së bashku me Hazreti Mehdiun (as)<sup>2</sup>, do të bëjnë që vlerat morale



Islamike të mbizotërojnë në mbarë botën. Dijetarët më të mëdhenj Islamik pajtohen se Profeti Isa (as) nuk ka vdekur dhe se ai do të kthehet në tokë. Megjithatë, pavarësisht nga kjo, ka njerëz që supozojnë se Profeti Isa (as) ka vdekur disa mijëra vjet më parë dhe kështu nuk ka gjasa që ai do të kthehet. Ky është një mendim i gabuar që buron nga mungesa e njohurive rreth Kur'anit dhe haditheve.

Profeti Muhammed (saas) na ka informuar po ashtu se në kohën kur Profeti Isa (as) do të kthehet në tokë, kohë e cila quhet 'fundi i kohës', do të ketë një periudhë në të cilën në tokë do të arrihet një paqe, drejtësi dhe mirëqenie e pashembullt.

'Fundi i Kohës' i referohet periudhës kohore të afërt me fundin e botës. Sipas Islamit, në këtë kohë do të ndodhin sprovat e tmerrshme të dexhhalit (antikrishtit), shumë tërmete dhe shfaqja e Jexhuxhëve dhe Mexhuxhëve (Xhuxhëve dhe Maxhuxhëve), pas të cilave mësimet Kur'anore do të mbizotërojnë dhe njerëzit përgjithësisht do t'iu përmbahen vlerave që ai mëson.


Dëshmitë se Profeti Isa (as) nuk ka vdekur, se ai është ngritur në praninë e All-llahut dhe se do të kthehet përsëri do të shqyrtohen në këtë libër në dritën e ajeteve Kur'anore, haditheve dhe interpretimeve të dijetarëve Islamik. Megjithatë, para se t'ia fillojmë, do të ishte e dobishme t'ia kujtojmë vetes disa të dhëna themelore që lidhen drejtpërdrejt me këtë temë.



# FEJA E ALL-LLAHUT ËSHTË ISLAMI

**G**jatë gjithë historisë, All-llahu ka dërguar të dërguarit e Tij te shumë popuj. Këta të dërguar të All-llahut u bënë thirrje njerëzve për në rrugën e drejtë dhe u komunikuan atyre mësimet e Tij. Megjithatë sot, disa besojnë se të dërguar të ndryshëm u sollën njerëzve fe të ndryshme. Ky është një mendim i gabuar. Fetë që All-llahu u shpalli popujve të veçantë në periudha të ndryshme ishin në të vërtetë një e njëjta fe. Për shembull, edhe pse shpallja që iu zbrit Profetit Isa (as) shfuqizoi disa prej ndalesave të shpalljes së mëparshme, në parim nuk ka dallime të mëdha ndërmjet feve të shpallura nga All-llahu. Ajo që u është shpallur profetëve të mëparshëm, Profetit Musa (Mojsi) (as) dhe Profetit Isa (as), dhe Profetit të fundit Muhammedit (saas), janë në thelb një fe e vetme e vërtetë në Sytë e All-llahut. Ajetet e Kur'anit e vërtetojnë këtë:

**Thuaj (o Muhamed): “Ne besojmë All-llahun, atë që na është shpallur neve, atë që i është shpallur Ibrahimit, Ismailit, Is’hakut, Jakubit, Esbatëve (12 bijve të tij) dhe në atë që i është dhënë Musait, Profeti Isait dhe profetëve nga Zoti i tyre. Ne nuk bëjmë asnjë dallim midis tyre dhe Ne vetëm Atij (All-llahut) i përulemi.”**  
**Kush kërkon tjetër fe përveç Islamit, nuk do t’i**



**pranohet dhe ai në botën tjetër do të jetë i humbur.  
(Surja Al 'Imran: 84-85)**


Këto ajete dëshmojnë se rruga e drejtë që iu shpall njeriut është Islami dhe se të gjithë profetët u bënë thirrje popujve të tyre që ta pasojnë një rrugë të vetme.

Në një varg tjetër All-llahu urdhëron: **"... Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjodha që Islami të jetë feja juaj."** (Surja Ma'ide: 3) All-llahu dërgoi të dërguarit e Tij për ta përcjellë këtë fe, fenë me të cilën Ai është i kënaqur, te popujt e tyre dhe kështu ta paralajmërojnë njerëzimin. Çdo person, të cilit i është përcjellë porosia e All-llahut dhe të cilit në këtë mënyrë i bëhet thirrje në këtë fe është përgjegjës që t'i përmbahet asaj.

Megjithatë, disa shoqëri e kanë pranuar porosinë ndërsa të tjerat e kanë mohuar atë. Në disa shoqëri, në anën tjetër, rruga e drejtë është shtrembëruar në besime të zvetënuara pas vdekjes së të dërguarit të tyre. Kjo rrëfëhet në Kur'an si vijon:

**Feja e vërtetë tek All-llahu është vetëm Islami. Ata që u është dhënë Libri, patën mospajtime nga zilia që kishin midis tyre, vetëm pasi u erdhi dituria. Por kushdo që i mohon udhëzimet e All-llahut, ta dijë se All-llahu është i shpejtë në llogari. (Surja Al 'Imran: 19)**

Njëra prej shoqërive që devijoi pasi që për një kohë jetoi në rrugën e drejtë ishte një pjesë e Bijve të Izraelit (*Beni Israilët*). Siç na mëson Kur'ani, All-llahu u dërgoi shumë të dërguar Bijve të Izraelit dhe i njoftoi ata për rrugën e drejtë. Megjithatë, ata çdo herë ngrinin krye kundër një profeti, ose pas vdekjes së një profeti, shndërrojnë rrugën e drejtë në një grumbull besimesh të zvetënuara. Veç kësaj, nga Kur'ani ne dimë se madje edhe sa




ishte ende gjallë Profeti Musa (as), disa prej Bijve të Izraelit e adhuruan viçin e artë gjatë mungesës së shkurtër të tij (Shih Suren Ta Ha: 83-94). Pas vdekjes së Profetit Musa (as), All-llahu dërgoi shumë të dërguar të tjerë tek Bijtë e Izraelit për t'i paralajmëruar ata dhe i dërguari i fundit prej këtyre profetëve ishte Profeti Isa (as).

Gjatë gjithë jetës së tij, Profeti Isa (as) i bëri thirrje popullit të tij që të jetoj sipas fesë (dinit) të shpallur nga All-llahu dhe i përkujtoi ata që të jenë robër të vërtetë të All-llahut. Ai i udhëzoi ata për urdhrat e Inxhilit – shpalljes që iu zbrit atij, pjesë të së cilës mund të kenë mbijetuar në pjesë të Ungjijve. Inxhili vërtetonte urdhrat e Teuratit – shpalljes që iu zbrit Profetit Musa (as), një pjesë e së cilës mbetet e shkruar në Teurat dhe në Dhiatën e Vjetër – e cila deri atëherë veçse ishte shtrembëruar. Duke kritikuar mësimet e gabuara të rabinëve që ishin përgjegjës për degjenerimin e fesë (dinit) së vërtetë, Profeti Isa (as) shfuqizoi rregullat që u sajuan nga vet rabinët dhe nëpërmjet të cilave ata nxorën përfitime personale. Ai i thirri Bijtë e Izraelit në njësinë e All-llahut, në të vërtetën dhe sjelljen e virtytshme. Kur'ani na tregon:

**Dhe (kam ardhur te ju) për t'ju vërtetuar Teuratin, që është para meje dhe që t'ju lejoj disa gjëra që i keni pasur të ndaluara. Ju kam sjellë një provë nga Zoti juaj, prandaj kijeni frikë All-llahun dhe bindmuni! (Surja Al 'Imran: 50)**

Megjithatë, pasi që Profeti Isa (as) u largua nga toka, disa prej pasuesve të tij më vonë filluan ta shtrembërojnë shpalljen. Nën ndikimin e disa ideve pagane që erdhën nga Grekët, ata zhvilluan një besim të zvetënuar në “trininë” (Ati, Biri dhe Shpirti i Shenjtë) (Pa dyshim All-llahu është i pastër nga ajo që i



përshkruajnë). Në emër të Krishterimit, ata iu bashkëngjitën një feje krejtësisht tjetër. Edhe pse Krishterimi i sotëm përmban ca besime dhe praktika që i takojnë besimit të vërtetë, fesë që iu shpall Profetit Isa (as) e që u degjenerua nga disa individë që erdhën pas tij. Shumë vjet pas ardhjes së parë të Profetit Isa (as), njerëz të panjohur shkruan librat që ne sot i njohim si Dhiata e Re dhe i shkruan ato në gjuhën greke ndonëse gjuha e Profetit Isa (as) dhe e dishepujve të tij ishte gjuha aramike, një gjuhë e afërt me gjuhën arabe. Në kohërat që pasuan, historianët i grumbulluan këto shkrime. Rrjedhimisht, Krishterimi sot ka humbur shumëçka nga mësimet origjinale të Profetit Isa (as).

Pas Profetit Profeti Isa (as), All-llahu dërgoi një të dërguar tjetër nga një fis tjetër në mënyrë që nëpërmjet tij Ai t'ia shpallte fenë burimore botës dhe Ai e pajisi atë me një libër fisnik. Ky i dërguar ishte Profeti Muhammed (saas) dhe ky libër është Kur'ani, e vetmja shpallje e pandryshuar Hyjnore.

Kur'ani i drejtohet gjithë njerëzimit dhe vlen për të gjitha kohërat. Të gjithë njerëzit e të gjitha moshave do të konsiderohen përgjegjës për përmbajtjen e tyre ndaj këtij libri, nëse i janë ekspozuar porosisë së Islamit. Ata do të gjykohen në bazë të Kur'anit në Ditën e Gjykimit. Në ditët tona në veçanti, të gjitha kombet e botës janë bashkuar në një mënyrë dhe pothuajse janë shndërruar në një fis të vetëm, duke iu falënderuar përparimeve teknologjike. Një akademik e quajti botën e sotme "fshat global". Prandaj, ka pak njerëz në botë sot që mund të mos jenë në dijeni të ekzistencës së Kur'anit dhe të cilët janë të painformuar për Islamin. Përkundër kësaj, vetëm një pjesë e njerëzve besojnë në Kur'an.

Në Kur'an jepet lajmi i gëzuar dhe në hadithe përshkruhet





në hollësi se Profeti Isa (as) do të kthehet në tokë dhe do t'iu bëj thirrje njerëzve për në rrugën e drejtë ashtu që gjendja kundërthënëse në të cilën gjenden të krishterët e sotëm do të zgjidhet. Siç do të bëhet fjalë në kapitujt vijues të këtij libri, Profeti Isa (as) u ngrit në Praninë e All-llahut dhe ende nuk ka përjetuar një vdekje fizike. Pas një kohe, ai do të kthehet dhe, siç transmetohet në këtë hadith, do të bëj që Islami të mbizotërojë në botë, së bashku me Hazreti Mehdiun (as). Ashtu siç dinë më së miri, si bota e krishterë ashtu edhe ajo muslimane janë duke u përgatitur për ta takuar këtë vizitor të bekuar dhe për të qenë të denjë për moralin e tij të lartë.




# NJERËZIT NË HALL LUTEN PËR SHPËTIMTAR

**Ç'keni ju që nuk luftoni në udhë të All-llahut dhe për shpëtimin e të shtypurve: për meshkujt e pafuqishëm, gratë dhe fëmijët, të cilët thërrasin: "O Zoti ynë! Nxirrna nga ky qytet, banorët e të cilit janë keqbërës! Na cakto një mbrojtës dhe na dërgo nga ana Jote dikë që të na ndihmojë!" (Surja Nisa:75)**

Nga Kur'ani mësojmë se shpeshherë para ardhjes së një të dërguari në një shoqëri korrupsioni shoqëror dhe moral ishte i përhapur në atë vend. Me ardhjen e një të dërguari në atë shoqëri, ata që e pasuan atë arritën një jetë të lumtur, të qetë dhe të begatshme bile edhe në mes të luftës së tyre të ndershme për të fituar kënaqësinë e All-llahut. Megjithatë, pas kësaj periudhe të bekuar, disa prej atyre që gëzuan të mirat e kësaj periudhe devijuan nga vlerat e tyre shpirtërore, ngritën krye dhe në fund gati sa nuk u kthyen në mosbesim. Në disa raste, ata adhuruan zota tjerë pos All-llahut dhe kështu i bënë padrejtësi vetvetes.

Në Kur'an, All-llahu rrëfen për besnikërinë, sinqeritetin dhe frikën që të dërguarit ndjenë ndaj All-llahut dhe pastaj na njofton për mënyrën se si gjeneratat që erdhën pas tyre humbën




plotësisht besimin e tyre. Ata devijuan për shkak të tekave dhe dëshirave të tyre dhe u privuan prej të gjitha vlerave të tij. Kur'ani na flet për këta njerëz me këto fjalë:

**Këta (të përmendur) ishin që All-llahu i gradoi nga pejgamberët pasardhës të Ademit, prej pasardhësve të atyre që i patëm bartur (në anije) bashkë me Nuhun, prej pasardhësve të Ibrahimit dhe të Jakubit (Israilët), dhe prej atyre që i udhëzuam dhe i bëmë të zgjedhur. Kur u lexoheshin atyre ajetet (shenjat) e të Gjithëmëshirshmit, binin në sexhde dhe qanin. E pas tyre (të mirëve) erdhën pasardhës të këqij, që e lanë namazin e u dhanë pas kënaqësive (trupore), e më vonë do të hidhen në çdo të keqe (ose në Gaja). (Surja Merjem: 58-59)**

Ata njerëz që shpërfillën përgjegjësitë e tyre hyjnore vuajtën zemërimin e All-llahut që u shfaq nëpërmjet fatkeqësive të ndryshme. All-llahu tërhoqi dhuntinë e Tij prej këtyre njerëzve. Në përputhje me ajetin **“E kush ia kthen shpinën udhëzimit Tim, do të ketë jetë të vështirë...”** (Surja Ta Ha: 124), ata vuajtën të këqija të ndryshme si skamja dhe problemet shoqërore dhe ekonomike që buronin nga degjenerimi i tyre moral dhe paqëndrueshmëria politike.

Nën sistemet e pafe, ata njerëz të cilët ishin përbuzës ndaj shpalljes hyjnore iu nënshtruan trysnive dhe padrejtësive të ndryshme. Periudha e Faraonit (*Firaunit*) është një shembull tipik i rrëfyer në Kur'an. I ngazëllyer me begatinë që kishte, Faraoni çoi një jetë të shfrenuar dhe populli i tij vuante nën tiraninë e tij. Kjo gjendje shpjegohet në Kur'an si vijon:

**Me të vërtetë që Faraoni madhështoj në Tokë dhe**



**banorët e saj i kishte përçarë në grupe; disa prej tyre i përndiqte, ua vriste fëmijët meshkuj, ndërsa femrat ua linte gjallë. Ai ka qenë vërtet keqbërës. (Surja Kasas: 4)**


Në rrethana të tilla në të cilat njerëzit përjetojnë probleme shoqërore dhe ekonomike nën tiraninë e udhëheqësve të padrejtë, nevoja për një shpëtimtar ndjehet thellësisht. Ky person është ai i cili largon aspektet jo të favorshme të sistemit të shkaktuara nga mosbesimi (*kufri*) i sunduesit dhe popullit të tij dhe sjell paqen, drejtësinë dhe sigurinë që shkojnë krah për krah me bindjen ndaj All-llahut dhe të Dërguarit të Tij.

Pas Profetit Musa (as), Bijtë e Izraelit u përballën gjithashtu me vështirësi të njëjta nën sundimin e tiranëve. Ata u dëbuan prej shtëpive dhe tokave të tyre dhe vuajtën shumë. Duke kuptuar se as idhujt që ata adhuronin, as pasuria e tyre dhe as paraardhësit e tyre nuk do t'i shpëtonin nga rrethana të tilla të padëshirueshme, ata e lutën All-llahut për një mbret; një shpëtimtar që do t'i shpëtonte ata nga ky sistem mizor.

### **“S’do të gjeni asnjë ndryshim në Ligjin e All-llahut”**

Nga tregimet e rrëfyera në Kur’an, kuptojmë se qytetërimet e kaluara që ngritën krye kundër të dërguarve të tyre pësuan fat pothuajse të njëjtë. Rrethanat nën të cilat jetuan njerëzit, dërgimi i të dërguarve për t’i paralajmëruar ata dhe shkatërrimi i disa prej tyre, të gjitha ndjekin një rrjedhë të njëjtë të ngjarjeve.

Shoqëritë moderne i janë nënshtruar gjithashtu një korrupsioni dhe degjenerimi të shpejtë. Varfëria, mjerimi dhe kaosi shndërrojnë jetët e njerëzve në rrëmuje të plotë dhe bëjnë që ata të dëshirojnë një jetë të qetë në të cilën mbizotëron mirësia.



Është e qartë se drejtësia mund të mbizotëroj vetëm nëse vlerat e Kur'anit mbizotërojnë në mesin e njerëzve. Vetëm njerëzit që posedojnë vlera të vërteta mund të sjellin zgjidhje për të gjitha hallet që përjetojnë njerëzit sot. Me të vërtetë, All-llahu dërgoi profetët dhe të dërguarit tek brezat e mëparshëm, të cilat përjetuan rënie të ngjashme shoqërore dhe Ai herë pas here u dhuroi mirësi të mahnitshme atyre që pasuan të dërguarit. Kjo rrëfëhet në ajetin vijues:

**Sikur banorët e këtyre vendbanimeve të kishin besuar dhe të ishin ruajtur, Ne do t'ju hapnim begati nga qielli e toka, por ata mohuan të vërtetën, andaj Ne i dënuam me shkatërrim për atë që merituan. (Surja A'raf: 96)**

Ky ajet, si edhe shumë ajete tjera që e vërtetojnë këtë, zbulon se rruga e vetme për të arritur lumturinë dhe paqen është aderimi në Islam. Ky parim do të vlejë për brezat e ardhshëm ashtu siç vlejti për brezat e mëparshëm. Në vendet e privuara nga Islami, mbizotërojnë padrejtësia, pasiguria dhe paqëndrueshmëria. Ky është ligji i All-llahut. Se nuk ekziston asnjë ndryshim në ligjin e All-llahut është cekur në Kur'an:

**...Por, kur u erdhi paralajmëruesi, kjo vetëm ua shtoi largimin prej rrugës së drejtë. Ata u sollën me mendjemadhësi në Tokë dhe me dredhi të shëmtuara, të cilat godasin vetëm atë që i bën. Vallë, a presin ata diçka tjetër veç asaj që ka goditur të mëparshmit? Vërtet, Ti nuk mund të gjesh ndryshim ose shndërrim në ligjet e All-llahut. (Surja Fatir: 42-43)**

## **Të jetuarit e Islamit në pajtim me Kur'ani**

Siç u përmend në pjesën e mëparshme, Kur'ani na informon




se All-llahu u dërgon profetët dhe të dërguarit shoqërive për t'i çliruar ato nga mosbesimi dhe padrejtësia. Ky profet apo i dërguar e udhëzon popullin e tij që të besojë (të ketë *iman*) në All-llahun duke mos i përshkruar Atij shokë dhe që t'ia kenë frikën Atij. Nëse ajo shoqëri këmbëngul në mohim, ai i paralajmëron ata për zemërimin e All-llahut. All-llahu thotë në Kur'an se Ai nuk shkatërron asnjë fis para se t'i dërgohet ky paralajmërim:

**Asnjëherë, Ne nuk kemi shkatërruar ndonjë vendbanim, pa i çuar më parë paralajmërues, si këshillë për ata. Ne nuk jemi asnjëherë të padrejtë. (Surja Shu'ara 208-209)**

Në kohën në të cilën jetojmë, njeriu mund të vërejë një degjenerim, si fizik ashtu edhe shpirtëror në tërë shoqërinë, të shoqëruar me një paqëndrueshmëri ekonomike dhe politike. Ekzistojnë dallime të mëdha në mes të pasurve dhe të varfërve dhe korrupsioni shoqëror vazhdon të rritet pandërprerë. Të gjitha këto tregojnë për zhvillimet e rëndësishme që do të ndodhin në të ardhmen e afërt. Pas këtyre periudhave të errëta, me kthimin e Profetit Isa (as) dhe me paraqitjen e Hazreti Mehdiut (as), feja e All-llahut pa dyshim se do të triumfojë në mbarë botën dhe besimi i vërtetë do t'i zëvendësojë të gjitha fetë pagane. Besimtarëve të Tij të vërtetë (muminun), All-llahu u jep këtë lajm të mirë:

**Ata dëshirojnë ta fikin dritën (fenë) e All-llahut me gojën e tyre, por All-llahu ka vendosur vetëm që ta përsosë dritën e Vet, edhe sikur mohuesit ta urrejnë këtë gjë. (All-llahu) Është Ai që e ka dërguar të Dërguarin e Tij me udhërrëfyesin (Kuranin) dhe fenë e së vërtetës, për ta lartësuar atë mbi të gjitha fetë, edhe**



**sikur idhujtarët ta urrejnë këtë gjë. (Surja Teube: 32-33)**


Në Suren Nur, All-llahu njofton besimtarët e Tij të vërtetë që bëjnë “vepra të mira” pa i shoqëruar Atij shokë dhe që kërkojnë vetëm kënaqësinë e Tij, se ata do të fitojnë pushtet ashtu siç ndodhi gjithmonë me besimtarët që u paraprinë atyre:

**All-llahu u ka premtuar atyre prej jush, që besojnë dhe që bëjnë vepra të mira, se do t’i bëjë mëkëmbës në Tokë, ashtu si i ka bërë ata para tyre dhe që do t’ua forcojë fenë e tyre, me të cilën Ai është i kënaqur dhe që frikën do t’ua shndërrojë në siguri. Le të më adhurojnë Mua e të mos Më shoqërojnë asgjë (në adhurim). Sa për ata që, pas kësaj, mohojnë (besimin), pikërisht ata janë të mbrapshtët. (Surja Nur: 55)**

Në ajetet e mësipërme, ne mësojmë se kriter për përhapjen e Islamit është ekzistenca e besimtarëve që janë thjeshtë robër të All-llahut që nuk i shoqërojnë shokë Atij dhe që bëjnë vepra të mira në rrugën e Tij.

Ne kemi parë se në secilën epokë, All-llahu i është përgjigjur thirrjes së robërve të Tij të cilët kishin shumë nevojë për ndihmën e Tij. Kjo gjithashtu vlen për kohën tonë dhe për të ardhmen. Ashtu siç ndodhi edhe në kohërat e mëparshme, All-llahu do t’i shpëtojë gjithashtu njerëzit nga padrejtësia e sistemit të mosbesimit në kohën tonë dhe do t’i njoh ata me bukurinë e Islamit.

Në veçanti, shpëtimi i botës Islamike nga telashet që po e shqetësojnë atë, siç shpallet në këtë hadith, është fare pranë. Pa dyshim, si në çdo kohë, sot njerëzit shpresojnë se një shpëtimtar do të shfaqet. Ky shpëtimtar që do ta nxjerr njerëzimin nga “errësira në dritë,” është feja Islame. Profeti Isa (as) dhe Hazreti Mehdiu (as), të cilët do të jenë mjet nëpërmjet të cilit njerëzit do



të jetojnë sipas këtyre vlerave të larta, do t'i mposhtin në aspektin intelektual të gjitha sistemet që e mohojnë All-llahun dhe do t'i zhvlerësojnë ideologjitë e shtrembëruara.

All-llahu u premtonte ndihmën e Tij robërve të Tij të cilët me sinqeritet i drejtohen atij dhe ndiejnë frikë të madhe ndaj Tij:

**Ata, që janë dëbuar nga vatrat e tyre padrejtësisht, vetëm sepse thanë: "Zoti ynë është All-llahu." Sikur All-llahu të mos u kishte dhënë njerëzve mundësinë për t'u mbrojtur nga njëri-tjetri, do të shkatërroheshin manastiret, kishat, sinagogat dhe xhamitë, në të cilat përmendet shumë emri i All-llahut. Vërtet, All-llahu e ndihmon këdo që e ndihmon Atë. All-llahu është vërtet i Fortë dhe i Plotfuqishëm. (All-llahu i ndihmon edhe) ata, të cilëve, nëse u japim pushtet në tokë, kryejnë faljet, japin zeqatin, urdhërojnë kryerjen e veprave të mira dhe pengojnë atë që është e mbrapshtë. Tek All-llahu është fundi i të gjitha çështjeve. (Surja Haxhxh: 40-41)**






# PROFETI ISA (AS), I BIRI I MERJEMES (AS), NË KUR'AN

**K**jo pjesë e librit analizon hollësitë lidhur me ardhjen e dytë të Profetit Isa (as) që i gjejmë në burimet më të besueshme. I pari prej këtyre burimeve është pa dyshim Kur'ani, Fjala e pandryshuar e All-llahut, siç thuhet në Kur'an: **“Fjalët e Tij askush nuk mund t'i ndryshojë.”** (Surja En'am: 115) dhe burimi i dytë është Sunneti i të Dërguarit të fundit të All-llahut, Profetit Muhammed (saas). Kur'ani na jep informacion të hollësishëm për shumë faza të jetës së Profetit Isa (as) duke përfshirë lindjen e tij, ngritjen e tij në Praninë e All-llahut, ardhjen e tij të dytë dhe vdekjen e tij.

Profeti Isa (as), i cili jetoi rreth dy mijë vjet më parë, është një i dërguar i bekuar i All-llahut. Siç është cekur në Kur'an, ai nderohet lartë si në këtë botë ashtu edhe në Ahiret (Jetën e përtejme). Feja e vërtetë që iu shpall atij vazhdon të jetoj ende sot, megjithëse vetëm në emër. Kjo për arsye se mësimi origjinal i komunikuar nga Profeti Isa (as) është shtrembëruar. Libri të cilin All-llahu ia shpalli Profetit Isa (as), gjithashtu, është shtrembëruar. Burimet e krishtera kanë pësuar një varg ndryshimesh dhe shtrembërimesh. Si pasojë, sot nuk është e mundshme që ne të marrim njohuri të vërtetë lidhur me Profetin Isa (as) nga burimet e krishtera.




Burimet e vetme prej të cilave mund të marrim njohuri të sakta për Profetin Isa (as) janë Kur'an, libri të cilin All-llahu siguron se do ta mbajë të pandryshuar deri në Ditën e Gjykimit dhe Sunneti i të Dërguarit të Tij Profetit Muhammed (saas). Në Kur'an, All-llahu rrëfen për lindjen dhe jetën e Profetit Isa (as), disa ndodhi të cilat ai i përjetoi, njerëzit përreth tij dhe shumë çështje tjera në lidhje me atë. Veç kësaj, ajetet Kur'anore na informojnë edhe për jetën e Merjemes (as) para se ajo të lindte Profetin Isa (as), se si ajo mbet shtatzënë në mënyrë të mrekullueshme dhe reagimet e njerëzve përreth saj lidhur me këtë ngjarje. Për më tepër, disa ajete të Kur'anit bëjnë me dije se Profeti Isa (as) do të vjen në tokë për të dytën herë në fundin e kohës. Kjo pjesë na paraqet disa nga këto të dhëna në Kur'an.

### **Lindja e Merjemes dhe mënyra si u rrit ajo**

Merjemja (as), e cila ishte e zgjedhur për ta sjellë në jetë Profetin Isa (as), ka lindur në një kohë të trazuar. All-llahu zgjodhi posaçërisht Merjemen (as) për këtë detyrë të bekuar dhe e edukoi në përputhje me këtë. Merjemja (as) vinte nga një familje fisnike, familja e 'Imranit. All-llahu e zgjodhi këtë familje mbi gjithë njerëzit.

Pjesëtarët e familjes së Imranit ishin të njohur si njerëz që kishin besim të madh në All-llahun. Ata i drejtoheshin Atij gjatë kryerjes së gjitha punëve të tyre dhe me përpikëri respektonin kufijtë e përcaktuar prej Tij. Kur gruaja e Imranit mësoi se ishte shtatzënë, ajo iu drejtua Krijuesit të saj dhe u lut, dhe ia kushtoi atë që ishte në mitrën e saj në shërbim të All-llahut. All-llahu rrëfen për këtë në Kur'an:

**Kujto kur gruaja e Imranit tha: “Zoti im, unë Ty ta kam kushtuar atë që është në barkun tim, që të shërbejë**




vetëm Ty; andaj, pranoje prej meje! Se Ti, me të vërtetë, dëgjon dhe di çdo gjë.” E kur ajo lindi, tha: “Zoti im! Unë linda femër, - All-llahu e di më mirë se çfarë lindi ajo, - e mashkulli nuk është si femra. Unë ia vura emrin Merjeme dhe i kam lënë atë me pasardhësit e saj nën mbrojtjen Tënde nga djalli i mallkuar”. (Surja Al ‘Imran: 35-36)

Kur lindi Merjemja (as), gruaja e Imranit kërkoi vetëm kënaqësinë e All-llahut. Ajo iu drejtua All-llahut dhe i la Merjemen (as) dhe fëmijët e saj nën mbrojtjen e Tij nga shejtani i mallkuar. Si shpërblim për sinqeritetin dhe lutjen e saj, All-llahu i dhuroi Merjemes (as) virtyte fisnike. Në Kur’an, All-llahu shpjegon se si Merjemja (as) u rrit nën mbrojtjen dhe kujdesin e plotë të Tij. **“Zoti e pranoi atë me ëndje, e bëri që të rritet mirë.”** (Surja Al ‘Imran: 37) Zekerija (as) u bë kujdestar i Merjemes (as) dhe gjatë kohës që ajo kaloi me të, ai e kuptoi se ajo ishte e nderuar me cilësi të jashtëzakonshme. Veç kësaj, All-llahu i dhuroi asaj shumë të mira:

**Sa herë që hynte Zekeria në dhomën (mihrabin) e saj, gjente pranë saj ushqim dhe e pyeste: “O Merjeme! Nga të vjen ky ushqim?” Ajo përgjigjej: “Ky është nga All-llahu, se All-llahu e furnizon kë të dojë pa kufi.”**(Surja Al ‘Imran: 37)

Ashtu siç zgjodhi All-llahu familjen e Imranit, Ai zgjodhi edhe Merjemen (as), një pjesëtare të familjes së Imranit dhe e pajisi atë me një edukatë të jashtëzakonshme. All-llahu e pastroi Merjemen (as) dhe e zgjodhi atë mbi të gjitha gratë tjera. Kjo veti e saj është theksuar në Kur’an:

**(Kujto) kur engjëjt thanë: “O Merjeme! All-llahu të ka zgjedhur, të ka pastruar dhe të ka parapëlqyer ty mbi të**



**gjitha gratë e botës. O Merjeme! Bindju Zotit tënd! Bëj sexhde dhe përkulu në ruku bashkë me ata që përkulen (duke adhuruar All-llahun)!” (Surja Al ‘Imran: 42-43)**

Merjemja (as) u bë e njohur në bashkësinë në të cilën jetoi për besnikërinë dhe sinqeritetin që ajo tregonte ndaj All-llahut. Ajo është shquar sidomos si një femër “e cila ruajti dëlirësinë e saj.” Në Suren Tahrim, gjejmë këtë përshkrim lidhur me këtë:


**Edhe Merjemen, të bijën e Imranit, e cila ruajti virgjërinë e saj; Ne frymë brenda saj nga shpirti Ynë (shpirtin e Isait a.s.). Ajo u besoi fjalëve të Zotit të saj dhe librave të Tij e ishte nga të devotshmit! (Surja Tahrim: 12)**

### **Profeti Isa (as) lindi pa baba**

Njëra prej mrekullive më të mëdha që All-llahu shfaqti në Profetin Isa (as) është mënyra në të cilën Merjemja (as) mbet shtatzënë. Kur’ani jep hollësi të shumta lidhur me këtë çështje. Mënyra se si Xhibrili (Gabrieli) (as) iu shfaq asaj përshkruhet me këto fjalë në Suren Merjem:

**Dhe trego (o Muhamed) në Libër për Merjemen, kur u tërhoq nga familja e saj në një vend në lindje, duke e fshehur veten nga ata. Ne i dërguam Shpirtin Tonë, i cili iu paraqit asaj si një njeri i plotë. (Surja Merjem: 16-17)**

Siç njoftohemi në ajetet e mësipërme, në një nga fazat e jetës së saj, Merjemja (as) u tërhoq nga njerëzit e saj në një vend në lindje dhe kaloi një pjesë të jetës atje. Në këtë kohë, asaj iu shfaq Xhibrili (as) si një qenie e zakonshme njerëzore. Një tjetër çështje me rëndësi që theksohet në këto ajete është sjellja modeste e



Merjemes (as) dhe frika e fuqishme ndaj All-llahut. Fjalët e para që ajo shqiptoi kur e pa Xhibrilin (as) ishin:

**Ajo i tha: “Unë kërkoj që të më mbrojë i Gjithëmëshirshmi prej teje, nëse i frikësohesh All-llahut. (Surja Merjem: 18)**

Megjithatë, Xhibrili (as) u prezantua dhe shpjegoi se ai ishte një i dërguar, i dërguar nga All-llahu për t’ia dhënë asaj lajmin e gëzuar. Ajetet na njoftojnë se përgjigja e Xhibrilit (as) ishte:


**Ai tha: “Në të vërtetë, unë jam vetëm një i dërguar i Zotit tënd, që të dhuroj ty një djalë të pastër.” (Surja Merjem: 19)**

**(Kujto) kur engjëjt thanë: “O Merjeme! All-llahu të jep lajmin e mirë për një (djalë që do të lindë me një) Fjalë prej Tij: emrin do ta ketë Mesih - Isa i biri i Merjemes, do të jetë i nderuar në këtë botë dhe në tjetrën dhe një nga të afërmit e All-llahut. (Surja Al ‘Imran: 45)**

Me të marrë këtë lajm të gëzuar, Merjemja (as) ngriti çështjen se si ajo mund të kishte një djalë kur asnjë njeri nuk e kishte prekur kurrë atë:

**Ajo tha: “Si mund të kem unë djalë, kur asnjë mashkull nuk më ka prekur e nuk jam as e pacipë?!” Iu përgjigj: “Kështu është! Zoti yt ka thënë: ‘Kjo për Mua është e lehtë. Ne do ta bëjmë atë shenjë për njerëzit dhe mëshirë nga ana Jonë’. Dhe kjo është punë e kryer.” Ajo mbeti me barrë e u tërhoq me të në një vend të largët. (Surja Merjem: 20-22)**

**Ajo tha: “Zoti im! Qysh do të kem unë fëmijë, kur nuk më ka prekur askush?!” – “Kështu – tha (engjëlli) - All-llahu krijon ç’të dojë Vetë. Kur vendos diçka, Ai vetëm**



**thotë për të: “Bëhu!” - dhe ajo bëhet.” (Surja Al ‘Imran: 47)**


Siç mund të shihet nga ajetet e mësipërme, Xhibrili (as) i dha Merjemes (as) lajmin e gëzuar se ajo ishte shtatzënë dhe i tha asaj: **“All-llahu vetëm i thotë: ‘Bëhu!’ Ajo menjëherë bëhet.”** Merjemen (as) s’e kishte prekur kurrë asnjë njeri. Me fjalë të tjera, Profeti Isa (as) nuk erdh në jetë në mënyrën e zakonshme në të cilën krijohen fëmijët. Kjo është vetëm një nga mrekullitë që përjetoi Profeti Isa (as) gjatë jetës së tij dhe që do të përjetojë kur të kthehet në tokë për herë të dytë, si mirësi nga All-llahu.

Gjatë kohës kur Merjemja (as) qëndroi në këtë “vend të largët”, All-llahu e ndihmoi atë si fizikisht ashtu edhe materialisht. Ajo ishte nën mbrojtjen dhe kujdesin e Tij të plotë gjatë shtatzënisë së saj. All-llahu në veçanti u përkujdes për të gjitha nevojat e saj. Ndërkohë, duke bërë që ajo të vendosej në një vend të izoluar, All-llahu ndaloi gjithë dëmin që njerëzit të cilëve u mungon aftësia e të kuptuarit të kësaj mrekullie do të mund t’i shkaktonin asaj.

### **Profeti Isa (as) është “Fjalë e All-llahut”**

Në Kur’an All-llahu tërheq vëmendjen tonë për faktin se, që nga lindja e tij e deri në vdekje, Profeti Isa (as) dallonte shumë nga të gjithë njerëzit e tjerë në tokë, sepse Ai kështu deshi. Kur’ani vërteton lindjen e tij të pastër, një formë e krijimit e panjohur për ne. Para se të lindte Profeti Isa (as), All-llahu e njoftoi nënën e tij për shumë tipare të Profetit Isa (as) duke përfshirë faktin se ai u dërgua si Mesih për Beni Israilët. Ai gjithashtu u shpall “Fjalë” e All-llahut:

**...Mesihu - Isai, i biri i Merjemes, është vetëm i Dërguar i All-llahut dhe Fjala e Tij, të cilën ia ka**



**dërguar Merjemes, si dhe shpirt (i krijuar) nga Ai...  
(Surja Nisa: 171)**

**(Kujto) kur engjëjt thanë: “O Merjeme! All-llahu të jep lajmin e mirë për një (djalë që do të lindë me një) Fjalë prej Tij: emrin do ta ketë Mesih - Isa i biri i Merjemes, do të jetë i nderuar në këtë botë dhe në tjetrën dhe një nga të afërmit e All-llahut. (Surja Al ‘Imran: 45)**

All-llahu i dha atij emrin e tij para lindjes së tij, ashtu siç bëri me Jahjanë (Gjonin) (as). All-llahu i dha atij emrin Mesihu, Profeti Isa, biri i Merjemes. Ky është një nga treguesit më të qartë se Profeti Isa (as) u krijua ndryshe nga njerëzit e tjerë.


Me të vërtetë, ashtu si lindja e tij, mrekullitë që ai shfaqti gjatë jetës së tij me mirësinë e All-llahut dhe mënyra se si ai u ngrit në Praninë e All-llahut janë shenja që e dallojnë atë prej njerëzve tjerë.

### **Lindja e Profetit Isa (as)**

Siç dihet, lindja është një proces shumë i vështirë që kërkon përkujdesje të madhe. Lindja e foshnjës pa ndihmën e një personi me përvojë dhe pa përkujdesje të duhur mjekësore është e vështirë. Mirëpo, Merjemja (as), krejtësisht e vetme, arriti ta lind foshnjën, duke iu falënderuar besnikërisë së saj ndaj All-llahut dhe mbështetjes së saj në Të.

Ndërsa ndiente dhimbje të mëdha të lindjes, All-llahu e frymëzoi Merjemen (as) dhe e udhëzoi atë në çdo hap. Në këtë mënyrë, ajo e lindi foshnjën e saj pa ndonjë mund të madh dhe si është më së miri. Kjo ishte një mirësi e madhe që All-llahu tregoi ndaj Merjemes (as):

**Dhembjet e lindjes e detyruan atë që të shkonte te**



trungu i një hurme. Ajo tha: “Ah, sikur të kisha vdekur para kësaj (ngjarjeje) dhe të isha harruar krejt!” Një zë e thirri nga poshtë: “Mos u pikëllo, se Zoti yt të ka bërë një burim uji poshtë teje! Shkunde trungun e palmës, që të bien mbi ty hurma të freskëta! Ha, pi dhe qetësohu. Nëse vëren ndonjë njeri, i thuaj: “Unë jam betuar në të Gjithëmëshirshmin se do të agjëroj, prandaj sot nuk do të flas me askënd.” (Surja Merjem: 23-26)


### **Profeti Isa (as) foli gjersa ishte ende në djep**

(Kujtoje) atë që ruajti virgjërinë e saj! Ne frymë brenda saj nga shpirti Ynë dhe e bëmë atë dhe birin e saj mrekulli për gjithë njerëzit. (Surja Enbija: 91)

Lindja e Profetit Isa (as), e cila ishte një ngjarje e pazakontë për njerëzit, ishte një sprovë si për Merjemen (as) ashtu edhe për popullin e saj. Në të vërtetë, mënyra se si lindi Profeti Isa (as) ishte një mrekulli që All-llahu e përdori për t'i thirrur njerëzit në fenë e vërtetë dhe njëra prej dëshmive më të qarta të ekzistencës së All-llahut. Megjithatë, populli i saj dështoi ta kuptoj këtë dhe shfaqën dyshime. Siç përmendet në Kur'an:

**Dhe u kthye te populli i vet, duke mbajtur fëmijën. Ata i thanë: “O Merjeme, ke bërë diçka të turpshme! O motra e Harunit! Babai yt nuk ka qenë njeri i keq, as nëna jote nuk ka qenë grua e shthurur.” (Surja Merjem: 27-28)**

Siç shpjegohet në ajetet e mësipërme, pas kthimit të Merjemes (as) nga ky vend i largët me Profetin Isa (as), njerëzit e saj nuk e lanë atë të shpjegohej. Ata thjeshtë shpifën për






Merjemen (as) në mënyrë të shëmtuar. Megjithatë, ata që përhapën këto trillime për Merjemen (as) e njihnin atë pothuajse nga dita që ajo u lind dhe ishin të vetëdijshëm për pastërtinë dhe devotshmërinë (takuan) e saj, si anëtarët tjerë të familjes së Imranit.

Vërtet, këto akuza të rrejshme dhe shpifje ishin sprovë për Merjemen (as). Ishte e qartë se një person aq i pastër dhe i devotshëm, nuk do të kalonte kufijtë e All-llahut. Që nga lindja e Merjemes (as), All-llahu e ka ndihmuar gjithmonë atë dhe gjithçka që bënte ajo e shndërronte në mirësi. Merjemja (as), në anën tjetër, e dinte se çdo gjë që ndodhë, ndodhë me Vullnetin e All-llahut dhe vetëm All-llahu mund ta vërtetonte natyrën e pabazë të këtyre shpifjeve.

Me të vërtetë, All-llahu i dhuroi qetësi Merjemes (as) dhe e frymëzoi atë të mbetej e qetë. All-llahu e udhëzoi atë që të mos fliste me njerëzit e saj por të tregonte me gisht nga Profeti Isa (as), nëse ata do t'i afroreshin asaj ndonjëherë dhe do të përpiqeshin ta akuzonin atë. Në këtë mënyrë, Merjemja (as) iu shmang çdo vështirësie që do të mund të krijonte një diskutim i tillë. Ai që do t'iu jepte përgjigjet më të sakta njerëzve ishte Profeti Isa (as). Kur All-llahu përgëzoi Merjemen (as) për lindjen e Profetit Isa (as), Ai gjithashtu e informoi atë se ai do të fliste qartë ndërsa ende ishte në djepin e tij:

**Ai do t'u flasë njerëzve qysh i vogël në djep edhe si njeri i rritur dhe do të jetë nga më të mirët". (Surja Al 'Imran: 46)**

Kështu, All-llahu ia lehtësoi punët Merjemes (as) dhe iu dha njerëzve shpjegimin e vërtetë nëpërmjet fjalëve të Profetit Isa (as). Me një mrekulli të tillë, mosbesimi i njerëzve që e rrethonin Merjemen (as) thjeshtë dështoi. Në Kur'an informohemi si vijon:



Ajo bëri me shenjë nga i biri. Ata thanë: “Si t’i flasim ne fëmijës që është në djep?” Ai (Isai në djep) tha: “Unë jam rob i All-llahut. Ai më ka dhënë Librin (Ungjillin), më ka bërë profet dhe më ka bërë të bekuar kudo që të jem. Ai më ka porositur që të falem e të jap zeqat sa të jem gjallë dhe që të jem i mirë ndaj nënës sime dhe nuk më ka bërë të ashpër dhe të padëgjueshëm. Le të jetë paqja e shpëtimit mbi mua, në ditën që kam lindur, në ditën që do të vdes dhe në ditën që do të ringjallem!” (Surja Merjem: 29-33)


Nuk ka dyshim, një foshnje që flet rrjedhshëm në djep është një mrekulli e madhe. Populli i Merjemes (as) ishin të habitur kur dëgjonin këto fjalë urtësie nga një foshnje dhe kjo rrethanë ua dëshmoi atyre se ishin dëshmitar të një mrekullie nga ana e All-llahut. Të gjitha këto ndodhi të mrekullueshme treguan se foshnja në djep ishte një i dërguar i All-llahut.

Kjo ishte mëshira e All-llahu ndaj Merjemes (as) për shkak të besimit që ajo pat në Të. Me anë të një mrekullie kaq mahnitëse, ajo iu përgjigj shpifjeve të bëra ndaj saj pa pasur nevojë të thotë asnjë fjalë. Megjithatë, All-llahu na informon se një fatkeqësi e rëndë i priste ata që nuk larguan nga mendja e tyre mendimet e këqija për Merjemen (as) përkundër kësaj mrekullie:

**(I mallkuam ata) për shkak të mosbesimit të tyre (ndaj Isait a.s.), për shkak të shpifjeve të mëdha që thanë kundër Merjemes.(Surja Nisa: 156)**

### **Mrekullitë e Profetit Isa (as)**

Profeti Isa (as) bëri shumë mrekulli tjera, me lejen e All-llahut, përveç lindjes së tij të virgjër dhe shpalljes së



pejgamberisë së tij si një foshnje e porsalindur në djep. Në të vërtetë, këto dy mrekulli janë dëshmi se All-llahu e kishte zgjedhur atë. Në fund të fundit, vetëm një mrekulli do të mund ta bënte një foshnje të porsalindur të flas në mënyrë të arsyeshme dhe me besim:

**All-llahu (atë ditë) i thotë: “O Isa, bir i Merjemes, kujtoj të mirat e Mia ndaj teje dhe nënës sate, kur të forcova me shpirtin e shenjtë (Xhibrilin), e ti u fole njerëzve në djep dhe (kur ishe) i pjekur (burrë), kur ta mësova ty Librin dhe Urtësinë... (Surja Ma’ide: 110)**


Në Kur’an, mrekullitë e Profetit Isa (as) të përmbushura me lejen e All-llahut rrëfohen në këtë mënyrë:

**...Dhe do ta caktojë atë të Dërguar te bijtë e Izraelit (të cilëve do t’u thotë): “Ju kam sjellë prova nga Zoti juaj (që vërtetojnë Profecinë time): bëj për ju diçka prej balte në formë shpendi, fryj në të e me urdhrin e All-llahut ajo bëhet shpend i gjallë; shëroj të verbrit e lindur dhe të lebsurit dhe i ngjall të vdekurit me lejen e All-llahut; ju tregoj çfarë hani dhe çfarë ruani në shtëpitë tuaja. Sigurisht që te të gjitha këto ka prova për ju, nëse jeni besimtarë të vërtetë. (Surja Al ‘Imran: 49)**

Pavarësisht nga gjithë këto mrekulli të rrëfyera deri më tani, disa njerëz refuzuan në mënyrë arrogante mrekullitë e Profetit Isa (as) dhe thanë se të gjitha ato ishin magji.

### **Profeti Isa (as) përcolli porosinë dhe disa prej vështirësive me të cilat u ballafaqua**

Në kohën kur u dërgua Profeti Isa (as), populli i Izraelit ishte në një rrëmujë të plotë, si në aspektin politik ashtu edhe në




atë ekonomik. Nga njëra anë, ishin kushtet e vështira që iu imponuan njerëzve dhe nga ana tjetër, besimet kundërthënëse dhe sektet e bënin të vështirë jetën e tyre. Në rrethana të tilla, njerëzit kishin nevojë të gjenin një rrugëdalje nga kjo gjendje e pashpresë.

I dërguari që do ta çlironte këtë shoqëri prej vështirësive të saj ishte Profeti Isa (as). Me vullnetin e All-llahut, Profeti Isa (as) foli që në djep dhe kështu i bëri me dije njerëzit që Mesihu që ata pritnin kishte arritur. Disa prej tyre kuptuan se Profeti Isa (as) ishte një i dërguar që u ishte dërguar atyre dhe besuan në të.

Megjithatë, kishte edhe prej atyre që nuk deshën ta pranonin Profetin Isa (as). Përkrahësit e sistemit të mosbesimit të kohës së tij, në veçanti, e konsideruan atë thjeshtë si një kërcënim ndaj sistemit të tyre të pafe. Për këtë arsye ata bënë plane për ta penguar atë posa dëgjuan për të. Mirëpo, për habinë e tyre, planet e tyre ishin të gjykuara të dështonin që nga fillimi. Prapëseprapë, kjo nuk i ndaloi ata të përpiqen për ta realizuar qëllimin e tyre.

Mirëpo, ata që ishin kundër tij nuk ishin vetëm prej jobesimtarëve. Gjatë kësaj periudhe, për arsye të ndryshme, disa nga rabinët u kthyen kundër Profetit Isa (as) duke pohuar se ai po e shfuqizonte fenë e tyre dhe natyrisht me këtë ata u bënë jobesimtarë për shkak të kundërshtimit të një të Dërguari të All-llahut nga ana e tyre. Ajo që Profeti Isa (as) bëri, në realitet, ishte vetëm se u bëri thirrje njerëzve për në rrugën burimore dhe përjashtoi rregullat e rrejshme të futura në Judaizëm nga disa rabinë vet. Disa njerëz nga populli i Izraelit shtrembëruan fenë e tyre duke ndaluar atë që ishte e lejueshme me shpalljen burimore dhe duke lejuar atë që ishte e ndaluar në të. Në këtë mënyrë, ata ndryshuan rrugën e vërtetë të shpallur nga All-



llahu. Pas kësaj, All-llahu dërgoi Profetin Isa (as) që ta pastronte fenë e vërtetë prej të gjitha risive të futura në të në një fazë të mëvonshme. Profeti Isa (as) i bëri thirrje popullit të vet për në *Inxhil*, i cili vërtetonte *Teuratin* burimor që iu shpall Profetit Musa (as), ashtu siç është cekur në Kur'an:


**Dhe (kam ardhur te ju) për t'ju vërtetuar Teuratin, që është para meje dhe që t'ju lejoj disa gjëra që i keni pasur të ndaluara. Ju kam sjellë një provë nga Zoti juaj, prandaj kijeni frikë All-llahun dhe bindmuni!(Surja Al 'Imran: 50)**

Në një ajet tjetër All-llahu na njofton se Inxhili që iu shpall Profetit Isa (as) ishte udhëzues në rrugën e drejtë për besimtarët dhe për t'i ndihmuar ata që ta dallojnë të mirën prej të keqes. Ai ishte po ashtu një libër që vërtetonte *Teuratin*:

**Pas atyre profetëve, Ne dërguam Isain, të birin e Merjemes, si vërtetues të Teuratit që kishte ardhur para tij. Dhe i dhamë atij Ungjillin, në të cilin ka udhëzim dhe dritë, si përmbushje të asaj që ishte shpallur para tij në Teurat dhe si udhërrëfyes e këshillë për ata që i frikësohen All-llahut. (Surja Ma'ide: 46)**

Disa nga bijtë e Izraelit dyshuan në atë që kishte sjellë Profeti Isa (as), por Profeti Isa (as) u bëri thirrje njerëzve për devotshmëri ndaj All-llahut, heqje dorë nga lukset e kësaj bote, sinqeritet, vëllazëri dhe ndershmëri. Ai u tha atyre që t'iu shmangen besimeve dhe praktikave të rrejshme. Në Kur'an, All-llahu shpjegon për mënyrën se si Profeti Isa (as) ua komunikoi urdhrat e All-llahut:

**E, kur Isai solli prova të qarta, tha: "Ju kam sjellë urtësinë (Profecinë) dhe do t'ju shpjegoj disa gjëra, për të cilat nuk po pajtoheni. Andaj, frikësojuni All-llahut**



dhe bindmuni mua! Pa dyshim, All-llahu është Zoti im dhe Zoti juaj, andaj adhuroni vetëm Atë! Kjo është rruga e drejtë!” E megjithatë, sektet e ndryshme patën kundërshti midis tyre. Mjerë ata që kanë bërë padrejtësi – për dënimin e Ditës së dhembshme! (Surja Zuhruf: 63-65)

Sinqeriteti dhe komunikimi i urtë i Profetit Isa (as) tërhoqi vëmendjen e njerëzve. Numri i pasuesve të tij u rrit vazhdimisht.


### **Disa prej Çifutëve pohojnë ta kenë vranë Profetin Isa (as)**

Supozohet se romakët e kryqëzuan Profetin Isa (as). Sipas këtij supozimi, romakët dhe disa rabinë hebrenj e arrestuan Profetin Isa (as) dhe e kryqëzuan atë. Në të vërtetë, e gjithë bota e krishterë përqafton besimin se Profeti Isa (as) ka vdekur, por pastaj është ringjallur dhe është ngritur në qiell. Mirëpo, Kur’ani na tregon se kjo nuk është e vërtetë dhe se Profeti Isa (as) as nuk vdiq dhe as nuk u vra:

**Dhe për fjalët e tyre: “Ne e vramë Mesihun – Isain, të birin e Merjemes, të dërguarin e All-llahut”. Por, ata as e vranë (ue me kateluhu), as e kryqëzuan (ue me selebuhu), por ashtu u është dukur (shubbiha). Ata që nuk u pajtuan për çështjen e tij, me siguri që gjenden në dyshim për të. Ata nuk kanë ditur kurrgjë për të, por vetëm kanë hamendësuar. Ata, në të vërtetë, nuk e kanë vranë (ue me kateluhu), (Surja Nisa: 157)**

Kur’ani vazhdon duke shpallur se Profeti Isa (as) u ngrit tek All-llahu:

**Por, All-llahu e ka ngritur pranë Vetes. All-llahu është i**



### **Plotfuqishëm dhe i Gjithëdijshëm. (Surja Nisa: 158)**


Kur'ani konstaton faktet në mënyrë shumë të qartë: përpjekjet e romakëve, të nxitura nga disa prej hebrenjve për ta vrarë Profetin Isa (as), u dëshmuan të pasuksesshme. Shprehja e cituar nga ajeti i mësipërm "...po kështu iu duk (u përngjau) atyre" shpjegon natyrën e vërtetë të kësaj ngjarje. Profeti Isa (as) nuk u vra, por u ngrit në praninë e All-llahut. Për më tepër, All-llahu zbulon se ata që e pohojnë këtë nuk dinë asgjë për të vërtetën.

### **All-llahu zbrapsi komplotin e jobesimtarëve**

Plani për ta vrarë Profetin Isa (as) nuk është një ngjarje e izoluar, sepse gjatë historisë jobesimtarët kanë bërë plane të ngjashme kundër profetëve që iu dërguan atyre. Në Kur'an, All-llahu tregon se sa herë që një profet erdhi tek populli i tij mosbesues dhe filloi t'iu bënte thirrje atyre që të jetojnë sipas vlerave morale të fesë së vërtetë, ata që nuk besuan filluan në mënyrë të pashmangshme të përgatitnin kurthe për ta dhe bile u përpoqën që t'i vrisnin ata:

**Ne i dhamë Musait Librin dhe pas tij çuam të dërguarit njërin pas tjetrit. Ne i dhamë Isait, të birit të Merjemes, mrekulli të qarta dhe e mbështetëm atë me Shpirtin e Shenjtërisë (Xhibrilin a.s.). Sa herë që ndonjë i dërguar ju sillte atë që nuk ju pëlqente, ju kapardiseshit, prandaj disa i quajtët gënjeshtarë e disa i vratë. (Surja Bekare: 87)**

Ata të cilët e hodhën Profetin Ibrahim (as) në zjarr, që e ndoqën me ushtritë e tyre Profetin Musa (as), që u përpoqën ta vrisnin Profetin tonë të dashur Muhammedin (saas) natën dhe e lanë Profetin Jusuf (as) në fund të një pusi vetëm sepse gjithë




këta profetë thanë: “All-llahu është Zoti ynë” kanë mendësi saktësisht të njëjtë, edhe pse jetuan në kohë të ndryshme. Ata të gjithë u përpoqën të ngrinin krye kundër All-llahut dhe të dërguarve të Tij, iu kundërvunë vlerave morale të urdhëruara nga All-llahu dhe e shpërfillën faktin se në botën tjetër ata do të duhet të japin përgjegjësi për veprat e tyre. Zemërimi i tyre u shfaq për shkak se profetët ua përkujtuan atyre disa fakte: se ata ishin robër të All-llahut dhe andaj duhej të ishin besnik ndaj Tij, të jepnin lëmoshë dhe të bënin vepra të mira për të fituar kënaqësinë e Tij, se duhej të ishin të drejtë dhe modest dhe se profetët ishin të dërguar të zgjedhur dhe të pastër në praninë e Tij. Si rezultat i kësaj, këta njerëz ngritën kurthe për profetët. Kjo mendësi është përshkruar si vijon:

**Ne u çuam të dërguar. Por, sa herë që u vinte ndonjë i dërguar me porosi që s’ua donte shpirti, ose e mohonin, ose e vrisnin. (Surja Ma’ide:70)**

Një plan i ngjashëm u kurdis nga krerët politeist të Mekës, të cilët shpresuan se mund ta dëbonin Profetin (saas) apo mbase edhe ta vrisnin atë. Zoti ynë e paralajmëroi atë për këtë plan. Por siç zbuluan shpejt jobesimtarët, All-llahu është planifikuesi më i mirë:

**Kujto kur mohuesit komplotonin kundër teje: për të burgosur, vrarë ose dëbuar. Ata bënin kurthe, por edhe All-llahu ngrinte kurthe (kundër tyre). All-llahu është planifikuesi më i mirë. (Surja Enfal: 30)**

Siç e kemi parë, jobesimtarët u përpoqën ta vrisnin Profetin Isa (as). Ata e kurdisën një plan të gjerë dhe menduan se do të kishin sukses po ta kapnin atë. Sipas burimeve historike dhe Islame, disa çifutë politeist përhapën gënjeshttra dhe trillime të shumta për Profetin Isa (as) në mënyrë që t’i nxitnin romakët






kundër tij, sepse ata donin që Roma të ndërmernte masa kundër tij. Plani i tyre është shpallur në Kur'an si vijon:

**Kur Isai vuri re mosbesimin e tyre, tha: “Kush janë ndihmuesit e mi në rrugën e All-llahut?” nxënësit (e tij) u përgjigjën: “Ne jemi ndihmuesit e (fesë së) All-llahut. Ne e besojmë All-llahun e ti (Isa) dëshmo se ne (i) jemi nënshtruar (Atij). Zoti ynë! Ne besojmë atë që na ke shpallur dhe pasojmë të Dërguarin (Isain). Na shkruaj pra, bashkë me dëshmitarët!” Dhe ata i përgatitën një kurth, por edhe All-llahu u përgatiti kurth (dënim), se All-llahu është strategu më i mirë. (Surja Al ‘Imran: 52-54)**

All-llahu ndaloi komplotin e tyre në një mënyrë krejtësisht të papritur. Atyre iu dëftua dhe vranë dikë që i përngjante atij në vend të tij. Zoti ynë e mbrojti robin e Vet të zgjedhur nga jobesimtarët:

Profeti Isa (as) nuk ka vdekur, por është i gjallë në praninë e All-llahut. Fakti që All-llahu ka shpallur se Ai i pengoi kurthet e përgatitura për të është njëra prej dëshmimeve me peshë se Profeti Isa (as) është ende gjallë. Sikur të kishte vdekur vërtetë Profeti Isa (as), siç pohojnë disa (gabimisht), atëherë jobesimtarët do t’ia kishin arritur qëllimit të tyre për ta vranë atë. Megjithatë, “... All-llahu nuk do t’iu jap kurrë rast mohuesve që t’i shkatërrojnë besimtarët.” (Surja Nisa’: 141) All-llahu bëri të ditur se Ai nuk do t’i lejonte jobesimtarët ta vrisnin Profetin Isa (as). Për më tepër, shumë ajete zbulojnë se jobesimtarët kurrë s’do t’ia arrijnë qëllimit të tyre dhe se dështimi i tyre është kërkesë e planit hyjnor të All-llahut. Disa nga këto ajete janë dhënë më poshtë:

**Ata kurdisin dredhitë e tyre, por All-llahu i di dredhitë e tyre. Edhe sikur prej dredhive të tyre të shembeshin**



malet, ata nuk do t'ia dalin mbanë. (Surja Ibrahim: 46)

Kështu ka ndodhur; dhe dijeni se All-llahu i dobëson dredhitë e mohuesve. (Surja Enfal, 18)

Vetëm All-llahut i përket sundimi i qiejve dhe i Tokës dhe tek Ai kthehet çdo gjë. (Surja Tur: 42)

All-llahu, në të vërtetë, i mbron besimtarët. Ai nuk i do tradhtarët mohues. (Surja Haxhxh: 38)


Në të vërtetë, ata ngrenë kurthe, por dhe Unë ua pres me kurth. Prandaj, jepu pak afat jobesimtarëve, lëri të qetë edhe për pak. (Surja Tarik: 15-17)

Edhe popujt që ishin para tyre (paganëve të Mekës), kanë kurdisur dredhi. Por All-llahu ua rrënoi godinën që nga themelet, kështu që kulmi i saj ra mbi ta dhe dënimi u erdhi andej nga nuk e prisnin. (Surja Nahl: 26)

### **Si rrëfohen vdekjet e profetëve në Kur'an?**

Shqyrtimi i tregimeve në Kur'an që përmendin mënyrën se si kanë vdekur profetët, si dhe ajetet që përshkruajnë ngritjen në qiell të Profetit Isa (as) zbulojnë një fakt të rëndësishëm. Në këtë pjesë të librit ne do të shqyrtojmë kuptimin e fjalëve arabe të përdorura në lidhje me historinë e Profetit Isa (as) si edhe të atyre të përdorura për të përshkruar vdekjet e profetëve tjerë dhe do të shohim se në çfarë mënyre janë përdorur ato në ajete.

Ndërsa ne do të shohim në hollësi më vonë, një numër i fjalëve janë përdorur në Kur'an për të përshkruar vdekjet e profetëve, sikurse fjala "kateluhu" (vras), "meata" (vdes), "haleke" (shkatërroj) dhe "selebuhu" (e kryqëzuan atë). Megjithatë, në Kur'an pohohet në mënyrë të qartë se "**Ata as nuk**



e vranë atë (ue me kateluhu) dhe as nuk e kryqëzuan atë (ue me selebuhu),” duke nënkuptuar se Profeti Isa (as) nuk ishte vranë në asnjë mënyrë. Theksohet se, në të vërtetë, dikush që i ngjante Profetit Isa (as) ishte paraqitur për ta parë jobesimtarët dhe se Profeti Isa (as) ishte ngritur në praninë e All-llahut.

Në Suren Al ‘Imran informohemi se All-llahu mori Profetin Isa (as) dhe e ngriti atë pranë Vetes.

**(Kujtoje, o Muhamed) kur All-llahu tha: “O Isa! Unë do të marr (muteueffike), do të ngre pranë Meje (ue rafi’uke) dhe do të shpëtoj ty nga ata që nuk besojnë, si dhe do t’i vendos ata që të ndjekin ty, përmbi ata që të mohojnë, deri në Ditën e Kiametit... (Surja Al ‘Imran: 55)**


Në vazhdim paraqesim mënyrat në të cilat janë përdorur fjalët që i referohen vdekjes në Kur’an.

## **1. TEUEFFE: SHKAKTOJ VDEKJEN, MARR NË GJUMË APO MARR**

Fjala “teueffe” ashtu siç është përdorur në këtë ajet ka kuptime tjera përveç kuptimit të thjeshtë të “vdekjes” në anglisht. Një studim i fjalëve të barasvlershme arabe në këto ajete zbulon faktin se Profeti Isa (as) nuk ka vdekur në kuptimin e pranuar. Ja se si është përshkruar kthimi i tij tek All-llahu në Suren Ma’ide:

Unë nuk u kam thënë asgjë tjetër, përveç asaj që më ke urdhëruar Ti: “Adhuroni All-llahun, Zotin tim dhe Zotin tuaj!” Kam qenë dëshmitar, për sa kohë që kam jetuar midis tyre dhe, qëkurse më more mua (teueffe), vetëm Ti ishe mbikëqyrës i tyre. Ti je Dëshmitar për çdo gjë. (Surja Ma’ide: 117)

Surja Al ‘Imran thotë:




**(Kujtoje, o Muhamed) kur All-llahu tha: “O Isa! Unë do të marr (muteueffike), do të ngre pranë Meje (ue rafi’uke) dhe do të shpëtoj ty nga ata që nuk besojnë, si dhe do t’i vendos ata që të ndjekin ty, përmbi ata që të mohojnë, deri në Ditën e Kiametit... (Surja Al ‘Imran: 55)**

Ky ajet informon besimtarët se All-llahu do ta “marr” Profetin Isa (as), do ta mbrojë atë nga jobesimtarët dhe do ta ngritë atë në praninë e Tij. Shumë dijetarë dhe komentues Islamik e kanë interpretuar këtë ajet të nënkuptoj se Profeti Isa (as) nuk ka vdekur.

Në arabisht fjala e cila është përkthyer në disa përkthime të këtyre vargjeve si “Ke bërë që unë të vdes” është “teueffe” dhe rrjedh nga rrënja uefe – për të plotësuar. Në fakt, në komentet arabe kjo nuk është përdorur në kuptimin e vdekjes. Komenti i Imam Kurtubiut është një shembull i kësaj; ai përdori shprehjen “marrja e shpirtave” për fjalën në fjalë. Nga Kur’ani, përsëri kuptojmë se “marrja e shpirtit” nuk do të thotë domosdo vdekje. Për shembull në një ajet në të cilin është përdorur fjala “teueffe”, nuk nënkupton vdekjen e një qenieje njerëzore por “marrjen e shpirtit të tij në gjumë”:

**Ai jua merr shpirtat (ju vë në gjumë) (jeteueffekum) natën, duke e ditur ç’keni bërë ditën, pastaj ju zgjon (ngjallë) që të plotësoni kohën tuaj të caktuar... (Surja En’am: 60)**

Fjala e përdorur “merr” në këtë ajet është e njëjtë me atë të përdorur në Suren Al ‘Imran: 55. Me fjalë të tjera, në ajetin e mësipërm, fjala *teueffe* është përdorur dhe është e qartë se njeriu nuk vdes në gjumë. Prandaj, çfarë është menduar këtu është,




përsëri, “marrja e shpirtit.”

Fjala e njëjtë është përdorur edhe në ajetin e mëposhtëm: **All-llahu ua merr shpirtrat atyre (teueffe) që u ka ardhur çasti i vdekjes (meutihe) dhe atyre që nuk kanë vdekur, por që janë në gjumë (lem temut). Pastaj Ai ndal shpirtin e atij që i është caktuar vdekja (meut), ndërsa të tjerëve ua lë deri në një kohë të caktuar. Me të vërtetë, këto janë shenja për njerëzit që mendojnë. (Surja Zumer: 42)**

Siç sugjerojnë këto ajete, All-llahu merr shpirtin e atij që është në gjumë, por Ai ua kthen përsëri shpirtrat atyre vdekja e të cilëve nuk është caktuar ende. Në këtë kontekst, njeriu nuk vdes gjatë kohës që është në gjumë, në kuptimin në të cilin ne e perceptojmë vdekjen. Shpirti lëshon trupin vetëm përkohësisht dhe qëndron në një dimension tjetër. Kur zgjohemi, shpirti kthehet në trup.

Një tjetër shembull kur gjumi konsiderohet si lloj i vdekjes, por i cili nuk i referohet vdekjes biologjike, është lutja në vazhdim, të cilën Profeti Muhammed (saas) shpeshherë e përsëriste kur zgjohej nga gjumi: “All-llahut i takon gjithë falënderimi, i Cili na ngjalli pasi na bëri të vdesim (të flemë). (*El-hamdu li All-llah illedhi ahjana ba’da me ametene; ue ilejhi el-nushu*)” (Transmetuar nga Ebu Hudhejfe, Sahih Buhariu).<sup>3</sup> Nuk ka dyshim, ai i përdorte këto fjalë të urta jo për t’iu referuar vdekjes biologjike kur njeriu është në gjumë, por “marrjes” së shpirtit të njeriut kur është në gjumë. Ibn Kethiri, dijetari dhe komentuesi i famshëm Islamik, përdorte këtë hadith, së bashku me shumë dëshmi tjera në komentin e tij mbi Suren Al ‘Imran, për të shpjeguar se teueffe i referohet gjumit. Përveç kësaj, ai tregoi



kuptimin e kësaj fjalë në ajetet e tjera ku ajo paraqitet. Pastaj ai dha mendimin e tij duke e përdorur një hadith të transmetuar nga Ibn Ebi Hatimi:


*Ibn Ebi Hatimi thotë se: “Babai im na ka thënë... nga Hasani se kuptimi i vargut ‘Unë do të marr...’ është ky: Këtu kjo nënkupton ‘Unë do të bëj që ti të vdesësh me vdekjen e gjumit; me fjalë të tjera, Unë do të bëj që ti të flesh.’ Pra All-llahu e ngriti Profetin Isa (as) në qiej ndërsa ai ishte në gjumë... Si një e vërtetë e pakundërshtueshme, All-llahu bëri që Profeti Isa (as) ta përjetojë vdekjen e gjumit dhe pastaj e ngriti atë në qiell, duke e shpëtuar prej hebrenjve, të cilët po i shkaktonin vuajtje atij atëbotë.”<sup>4</sup>*

Imam Muhammed Zahid el-Keutheri, një tjetër dijetar Islamik i cili shqyrtoi kuptimin e fjalës teueffe, deklaroi se ajo nuk do të thotë vdekje dhe tërhoqi vëmendjen për përdorimin e fjalës meut në një ajet të Kur’anit:

*Sikur të kishte vdekur Profeti Isa (as)[gjë që nuk ka ndodhur], atëherë fjala meut e shpallur në ajetin: “All-llahu ua merr shpirtat atyre që u ka ardhur çasti i vdekjes” (39:42), nuk do të ishte shpallur... Kjo për shkak se, siç është pohuar, në qoftë se All-llahu do t’i ishte referuar vdekjes normale [në kuptimin biologjik], atëherë kjo do të ishte deklaruar në mënyrë të qartë. Pasi që All-llahu i referohet faktit se hebrenjtë nuk e kishin vrarë Profetin Isa (as), por se Ai e kishte marr dhe e kishte ngritur atë në qiell, atëherë njeriu duhet të mendojë për një kuptim përtej atij të vdekjes së zakonshme.<sup>5</sup>*

Ebu Mensur Muhammed el-Maturidi, që konsiderohet si njëri prej komentuesve të parë të Kur’anit, deklaroi gjithashtu se ky ajet nuk i referohet vdekjes së Profetit Isa (as) në kuptimin e njohur biologjik:

*Ajo të cilës i referohet ky ajet nuk është kalim në kuptimin e vdekjes,*



*por në kuptimin e marrjes së trupit nga kjo botë.<sup>6</sup>*

Komentuesi dhe dijetari i famshëm, Tabariu, deklaroi se kjo folje është përdorur në kuptimin e “largimit nga toka” dhe e interpretoi ajetin me këto fjalë:

*Sipas mendimit tim, gjëja më e bazuar është që kjo fjalë të merret në kuptimin e “marrjes në pronësi,” “e largimit nga toka.” Në këtë rast, kuptimi i këtij ajeti është: “Do të marr nga toka dhe do të ngris në qiej.” Pjesa tjetër e ajetit thekson fitoren [e besimtarëve] mbi jobesimtarët në Fundin e Kohës, e cila e vërteton idenë e mësipërme.”<sup>7</sup>*

Në komentin e tij, Hamdi Jazir Elmali ka deklaruar se ajeti në fjalë do të thotë:


*Sipas mendimit tim, një përmbledhje e këtij interpretimi dhe besimi është si vijon: Shpirti i Profetit Isa (as), i përshkruar si “fjalë nga All-llahu” dhe i përforcuar me “Shpirtin më të pastër,” ende nuk është marr. Shpirtit të tij nuk i ka ardhur ende çasti i vdekjes. “Fjala” nuk është kthyer ende tek All-llahu. Ai ka ende punë për të bërë në këtë dynja.<sup>8</sup>*

Nga këto burime gjithëpërfshirëse mund të vijmë në përfundim se Profeti Isa (as) është vënë në një gjendje të ngjashme me gjumin dhe pastaj është ngritur në praninë e All-llahut. Profeti Isa (as) nuk ka vdekur, por ai thjeshtë është larguar nga ky dimension me vullnetin e Tij (All-llahu e di të vërtetën).

## **2. KATELE: VRAS**

Fjala që përdoret përgjithësisht në kuptimin “për të vrasë” kur flitet për vdekjen në Kur’an është fjala arabe katele. Si për shembull në Suren Gafir:

**Faraoni tha: “Më lini ta vras Musain e ai le ta thërrasë**



**në ndihmë Zotin e vet. Unë vërtet druhem mos ai do t'jua ndryshojë fenë tuaj ose do të shkaktojë trazira në Tokë". (Surja Gafir: 26)**

Shprehja "më lini ta vras Musain" në këtë ajet paraqitet në formën arabe *aktulu Musa*. Kjo fjalë rrjedh nga folja *katele*. Në një ajet tjetër, e njëjta fjalë është përdorur në këtë mënyrë:

**Kjo ndodhi sepse ata... i vrisnin (*jektulune*) të dërguarit pa asnjë të drejtë...(Surja Bekare: 61)**

Fjalët "ata i vrisnin" në këtë ajet paraqitet si *jektulune* në origjinal në arabisht, e cila përsëri buron nga folja *katele*. Dhe siç bëhet e qartë nga përkthimi, do të thotë "për të vrarë."

Është e qartë se si është përdorur folja *katele* në vargjet në vijim që përshkruajnë vdekjen e profetëve. Të gjitha fjalët, kuptimi i të cilave paraqitet në kllapa rrjedhin nga folja *katele*.


**...Ne do ta shënojmë atë që thanë, si dhe vrasjen (*ue ketlehum*) e profetëve nga ana e tyre pa kurrfarë të drejte...(Surja Al 'Imran: 181)**

**...A nuk u bëtë kryelartë dhe disa prej tyre i quajtët gënjeshtarë e të tjerët i vratë (*tektulune*)?(Surja Bekare: 87)**

**...Thuaju atyre: "Nëse ishit besimtarë, përse i vratë (*tektulune*) profetët e All-llahut atëherë kur ju erdhën?"(Surja Bekare: 91)**

**Lajmëroi ata që mohojnë shpalljet e All-llahut, vrasin (*jektulune*) profetët padrejtësisht dhe vrasin (*jektulune*) edhe ata që urdhërojnë të veprohet me drejtësi...(Surja Al 'Imran: 21)**

**...Pse i vratë ata (*kateltumuhum*) nëse thoni të**





vërtetën?”(Surja Al ‘Imran: 183)

...Ai (që nuk iu pranua) tha: “Unë do të vras (le aktulenneke).” ... (Surja Ma’ide: 27)

Nëse ti ngre dorë të më vrasësh mua (li tektuleni), unë nuk do ta ngre dorën që të të vras (li aktuleke)... (Surja Ma’ide: 28)

Vriteni (uktulu) Jusufin ose braktiseni në ndonjë vend të largët...(Surja Jusuf: 9)

Gruaja e Faraonit i tha atij: “Ky (djale) është gëzim për mua dhe ty, prandaj mos e vrisni (le tektuluhu) atë...” (Surja Kasas: 9)

“O Musa, paria është mbledhur e po bisedon për të të vrarë (li jektuluke)...” (Surja Kasas: 20)


Populli i tij nuk kishte tjetër përgjigje, përveçse tha: “Vriteni (uktuluhu) atë ose digjeni!” (Surja Ankebut: 24)

### 3) HALEKE: VDES

Folja haleke është përdorur në Kur’an në kuptimin “për të vdekur”. Kjo folje është përdorur në vargje në kuptimin “mbaroj, shkatërrohem, vdes”. Një shembull i paraqitjes së saj mund të gjendet në Suren Gafir: 34:

...kur ai (Jusufi) vdiq (haleke), ju thatë: “All-llahu kurrë s’do të dërgoj të dërguar tjetër pas tij...” (Surja Gafir: 34)

Në këtë varg, shprehja e përkthyer në anglisht si “kur ai vdiq” është “idhe haleke” në Arabisht, e përdorur në kuptimin “për të vdekur”.



#### 4) MEATA: VDEKJA

Një fjalë tjetër e përdorur në Kur'an në lidhje me vdekjet e profetëve është *meata*. Fjala *meata* – ai vdiq – dhe fjalët tjera që rrjedhin nga rrënja e njëjtë janë përdorur në disa ajete. Njëra prej tyre ka të bëjë me vdekjen e Profetit Sulejman (Solomon) (as) në Suren Sebe':

**Kur Ne ia caktuam atij vdekjen (*meut*), atyre nuk u dha shenjë askush për vdekjen e tij (*meutih*), pos krimbit që brejti shkopin e tij...(Surja Sebe': 14)**

Një fjalë tjetër që buron nga rrënja e njëjtë është përdorur në lidhje me Profetin Jahja (Gjon) (as):

**Paqja qoftë mbi atë ditën kur ka lindur, ditën kur të vdesë dhe në ditën kur do të ringjallet. (Surja Merjem: 15)**

Fjala e përkthyer këtu si "kur të vdes" është fjala Arabe *jemutu*. E njëjta fjalë paraqitet në vargjet lidhur me vdekjen e Profetit Ja'kub (as). Për shembull, ajo shfaqet në Suren Bekare:


**A ishit ju (Ithtarë të Librit) të pranishëm kur Jakubit iu afrua vdekja (*meut*)?... (Surja Bekare: 133)**

Fjala *meut* në këtë ajet vjen nga rrënja e njëjtë dhe do të thotë vdekje. Në një ajet për Profetin Muhammed (saas) foljet kutile dhe meata janë përdorur në të njëjtin vend dhe në të njëjtën kohë:

**Muhamedi është vetëm i Dërguar, para të cilit ka pasur edhe të dërguar të tjerë. Nëse ai vdes (*meata*) ose vritet (*kutile*), a mos do të ktheheni ju prapa?... (Surja Al 'Imran: 144)**

Fjala *meut* që vjen nga rrënja e njëjtë si fjala *meata* (vdes) shfaqet në vargjet e tjera që kanë të bëjnë me vdekjet e profetëve:

**...Ajo tha: "Ah, sikur të kisha vdekur para kësaj**



(ngjarjeje) dhe të isha harruar krejt!" (Surja Merjem: 23)

Para teje, Ne nuk e kemi bërë asnjë të pavdekshëm (*kuld*). Nëse ti vdes (*mitta*), a do të mbesin ata të përjetshëm?! (Surja Enbija: 34)

"Ai më bën të vdes (*jumituni*), e mandej më ngjallë" (Surja Shu'ara: 81)

### 5) HALID: I PAVDEKSHËM

Një fjalë tjetër që shfaqet në disa ajete e që nuk e ka kuptimin e drejtpërdrejt të "vdes" apo "vras" por që do të thotë "pavdekshmëri" është fjala *halid*. Kuptimi i fjalës *halid* sugjeron diçka të ngjashme me të qenit i përhershëm, për shembull, në Suren Enbija:

Dhe ne nuk i kemi bërë ata (të dërguarit) trupa që nuk hanë ushqim, as nuk kanë qenë të pavdekshëm (*halidine*). (Surja Enbija: 8)


### 6) SELEBE: KRYQËZOJ

Njëra prej fjalëve të përdorura në Kur'an kur flitet për vdekjen e profetëve dhe të tjerëve është folja *selebe* (kryqëzoj). Kjo folje mbart në vete kuptime të tilla si "kryqëzoj, var dhe ekzekutoj." Kjo folje është përdorur në ajetet e mëposhtme:

... Po ata as nuk e mbytën as nuk e gozhduan (kryqëzuan) (*ue me selebuhu*) atë... (Nisa: 157)

... (Jusufi tha:) Njëri prej ju dyve do t'i japë të pijë verë zotërisë të vet, e tjetri do të varet (*juslebu*)... (Jusuf: 41)

... vetëm se të vriten ose gozhdohen (kryqëzohen) (*jusellebu*)... (Surja Ma'ide: 33)



... (Faraoni tha:) “Do t’jua këpus duart dhe këmbët këmbyerazi e pastaj do t’ju kryqëzoj të gjithëve (*le usellibennekum*).” (el-A’raf: 124)

... (Faraoni tha:) “Unë do t’ua pres duart e këmbët tërthorazi e do t’u varë (*ue le usellibennekum*)...” (Ta Ha: 71)


... (Faraoni tha:) “Unë do t’ua shkurtoj (do t’ua pres) duart dhe këmbët tuaja të anës së kundërt dhe që të gjithëve do t’u gozhdoj (*ue le usellibennekum*).” (esh-Shu’ara: 49)

Siç mund të shihet nga gjithë këta shembuj, shumë fjalë të ndryshme janë përdorur në ajetet që kanë të bëjnë me vdekjen e profetëve tjerë. All-llahu ka shpallur në Kur’an se Profeti Isa (as) nuk ishte vrasës, se dikush që i përngjante atij ishte paraqitur në vend të tij dhe se atë e kishin marrë (me fjalë të tjera se shpirti i tij ishte marrë). Ndërsa fjala *teueffe* që ka kuptimin e “marrjes së shpirtit” është përdorur në kontekst me Profetin Isa (as), shprehje të tilla si *kateluhu* dhe *mata*, shprehje të vdekjes së zakonshme, janë përdorur për t’iu referuar vdekjes së profetëve tjerë. Këto fakte tregojnë edhe një herë se pozita e Profetit Isa (as) është e jashtëzakonshme.

### **All-llahu e ngriti Profetin Isa (as) në Praninë e Tij me trup dhe me shpirt**

Dëshmia më e pamohueshme se Profeti Isa (as) nuk vdiq dhe as nuk u vra është fakti se All-llahu ka shpallur se Ai e ngriti Profetin Isa (as) pranë Vetes:

“... Unë do të marr (rafi’uke), do të ngre pranë Meje dhe do të shpëtoj ty nga ata që nuk besojnë, si dhe do



**t'i vendos ata që të ndjekin ty, përmbi ata që të mohojnë, deri në Ditën e Kiametit..." (Surja Al 'Imran: 55)**

**Përkundrazi [bal], All-llahu e ka ngritur pranë Vetes. All-llahu është i Plotfuqishëm dhe i Gjithëdijshëm. (Surja Nisa': 158)**

All-llahu e mbrojti dhe e shpëtoi Profetin Isa (as) duke e ngritur atë pranë Vetes. Fjalët rafiu'ke dhe rafe'ehu që paraqiten në këto ajete vijnë nga rrënja e fjalës arabe rafe'e, e cila do të thotë "ngritem".


Ekziston një konsensus midis dijetarëve Islamik, bazuar në këto ajete, se Profeti Isa (as) nuk kishte vdekur por ishte ngritur në praninë e All-llahut dhe se kjo ngritje ndodhi me trup dhe me shpirt.

Dijetari Islamik, Ebu Musa el-Ash'ari, komentoi Suren Al 'Imran 55 së bashku me Suren Nisa'158 dhe shkroi se: *"Ekziston një konsensus në mesin e bashkësisë së besimtarëve [ixhme'ummet] se Profeti Isa (as) u ngrit në qiej i gjallë."*<sup>9</sup> (Ixmeh'ummet i referohet pajtimit mbi këtë çështje nga ata studiues Islamik të cilët e interpretuan Ligjin Islamik dhe jetuan gjatë shekullit të njëjtë.)

Në komentimin e tij, Hasan Basri Kantaj komentoi rafiu'ke në kuptimin e "ngritjes dhe lartësimit të tij pranë Vetes," dhe shkroi se *"All-llahu e ngriti dhe e lartësoi Profetin Isa (as) me trup dhe me shpirt."*<sup>10</sup>

Imam Ibn Tejmije ishte i mendimit se: Ajeti *"Ai e ngriti atë në praninë e Tij" ... shpjegon se Profeti Isa (as) u ngrit me trup dhe me shpirt.*<sup>11</sup>

Zahid el-Keutheri deklaroi se ngritja është aq e qartë dhe e sigurt sa që nuk lë hapësirë për ndonjë kundërshtim. El-Keutheri përmendi Suren Al 'Imran 55 dhe Suren Nisa'157-158 si dëshmi



dhe tha se kjo ngjarje është jashtë çdo dyshimi. Ai përdor fjalën nass, që do të thotë siguri ose moskundërshtim që buron nga një ajet Kur'anor apo një hadith. Ai vazhdoi duke thënë:

*Kjo është për shkak se kuptimi bazë i fjalës (rafe'e në këto ajete) është bartje nga poshtë lartë. Nuk ekziston asnjë element këtu që do të mund të përdorej për t'i interpretuar këto ajete në mënyrë metaforike. Prandaj, nuk ekziston asnjë fakt për të bërë përpjekje për të sajuar një kuptim në kuptim të ngritjes në shenjë nderimi dhe grade.<sup>12</sup>*

Siç shihet qartë nga ajetet dhe komentet e dijetarëve Islamik, Profeti Isa (as) u ngrit i gjallë, me trupin e tij, në praninë e All-llahut. Kjo është një mrekulli e All-llahut dhe një mrekulli që do të frymëzojë entuziazëm dhe ngazëllim të madh në mesin e të gjithë besimtarëve. Pohimet se vetëm shpirti i tij u ngrit në praninë e Tij apo se ngritja e tij ishte vetëm shpirtërore (në gradë), nuk i pasqyrojnë faktet. Pavlefshmëria e pohimeve të tilla është provuar nga shumë dijetarë Islamik siç u paraqit më lartë.

Një tjetër provë e rëndësishme e kësaj ngjarje është fjala arabe bal, e cila paraqitet në Kur'an: 4:158 dhe përkthimi tekstual i saj është "përkundrazi". Tiparet e kuptimit dhe përdorimit të saj në gjuhësinë arabe tregojnë një fakt shumë të rëndësishëm: në përputhje me rregullat e gjuhësisë Arabe, fjalia që vjen pas saj duhet të ketë një kuptim që është krejtësisht e kundërta e formulimit paraprak. Duke qenë kështu, ka mundësi që ajetet që i referohen Profetit Isa (as) "... Ata nuk e vranë atë," (Surja Nisa'157) "përkundrazi [bal] All-llahu e ngriti atë pranë Vetes..." (Surja Nisa': 158) i referohen gjendjes së qenies gjallë, e jo gjendjes së qenies i vdekur. Sheik al-Islam Mustafa Sabri paraqiti interpretimin në vijim:


*Nëse fjala bal, e cila paraqitet në Suren Nisa'158 dhe që unë e kam*



përkthyer “përkundrazi,” vjen pas një fjalie që shpreh një mohim, atëherë, sipas rregullave të gjuhësisë arabe, fjalia që e pason atë duhet të nënkuptoj të kundërtën e fjalisë që i paraprinë asaj. E kundërta e vdekjes është jeta. Kjo është një kërkesë e rregullave të gjuhësisë. Po të themi se “ngritja këtu është një ngritje shpirtërore” dhe se “Profeti Isa (as) ka vdekur në kuptimin e zakonshëm të vdekjes,” atëherë ne po e shkelim atë rregull. Në këtë rast, ngritja që pason shprehjen “përkundrazi” nuk do të përfaqësojë të kundërtën e foljeve “oras” dhe “kryqëzoj” në fjalinë mohore që i paraprinë asaj. Kjo është për shkak se ka mundësi që një person të vritet dhe që shpirti i tij apo i saj të ngritet në qiej. Përndryshe, ky term do të ishte i pakuptim e në Kur’an nuk ekzistojnë terma të pakuptim... Sipas atyre që e mbështesin tezën se kjo ngritje është vetëm një ngritje shpirtërore, kuptimi i këtij ajeti është ky: “Ata as nuk e vranë dhe as nuk e kryqëzuan atë... përkundrazi, All-llahu e ngriti atë në një gradë më të lartë.” Nuk ekziston ndonjë oratori e veçantë këtu, e lëre më koncizitet... Asnjë njeri i arsyeshem nuk do t’i merrte fjalët “ashensori në banesën time më ngjit mua në katin e katërt çdo ditë,” në kuptimin unë ngjitem vetëm me shpirt në katin e katërt. Prandaj, as Profeti Isa (as) nuk është ngritur vetëm me shpirt.<sup>13</sup>

Said Ramadan el-Buti e ka interpretuar këtë çështje në të njëjtën mënyrë:

Pajtueshmëria e ndërsjellë mes pjesëve paraprijëse dhe pasuese të ajetit detyrimisht zbulojnë një fakt. Për shembull, në qoftë se një arab thotë: “Nuk jam i uritur; përkundrazi, jam shtrirë në krah,” kjo nuk është një fjali e drejtë. Në të njëjtën mënyrë, ekziston një mospërputhje në mes të pjesëve përbërëse të kësaj fjalie: “Halidi nuk ka vdekur; përkundrazi, ai është njeri i mirë.” Ajo që do të ishte e drejtë të thuhej është: “Halidi nuk ka vdekur; përkundrazi, ai është i gjallë.”



*Të thuhet: “Kryetari nuk u vra; ai është një njeri me gradë të lartë në praninë e All-llahut” na çon gjithashtu drejtë një shkëputje të kuptimit në fjali, sepse që ai të ketë një gradë të lartë në Sytë e All-llahut nuk përbën pengesë që ai të jetë vrarë. Termi bal shpreh një kontradiktë midis fjalëve paraprijëse dhe atyre pasuese. Me fjalë të tjera, bal e anulon një thënie të mëparshme.<sup>14</sup>*


Natyrisht, All-llahu i Gjithëfuqishëm i hutoi jobesimtarët duke e ngritur Profetin Isa (as) të gjallë në praninë e Tij. Gjithë këto dëshmi tregojnë se Profeti Isa (as) është ende gjallë dhe do të kthehet në Tokë kur dëshiron All-llahu, e All-llahu e di të vërtetën.

### **Pastrimi (shpëtimi) nga All-llahu i Profetit Isa (as) prej jobesimtarëve**

Një pjesë e informacionit të dhënë në lidhje me ngritjen e Profetit Isa (as) është se All-llahu do ta pastrojë (shpëtojë) atë prej jobesimtarëve. Kjo shpallet në Kur'an:

**... do të ngre [ue raafi'uke] pranë Meje dhe do të pastroj (shpëtoj) [mutehhiruke] ty nga ata që nuk besojnë, si dhe do t'i vendos ata që të ndjekin ty, përmbi ata që të mohojnë, deri në Ditën e Kiametit... (Surja Al 'Imran: 55)**

Rrënja e fjalës *mutehhiruke* është *tahara* që do të thotë “të jesh i pastër.” Dijetarët Islamik e konsiderojnë këtë fjalë si një provë se Profeti Isa (as) është ngritur i gjallë tek All-llahu. Sipas tyre, interpretimi i këtij ajeti është: “Do të marr, do të ngre tek Vetja Ime dhe do të largoj nga ky mjedis i ndotur nga jobesimtarët dhe gjynahqarët.” (Zeki Saritoprak, Islam Inanci Acisindan Nuzul-i Profeti Isa Meselesi [Çështja e ardhjes së dytë të Mesihut nga






perspektiva e besimit Islamik], Izmir: Caglayan Publishings, 1997, f. 63.) Pra, All-llahu e pastroi Profetin Isa (as) nga jobesimtarët, komploti i jobesimtarëve për ta vvarë atë u ndalua dhe ata nuk ia arritën qëllimit të tyre (All-llahu e di të vërtetën).

Veç kësaj, ky ajet tregon po ashtu se Profeti Isa (as) u pastrua përmes ndarjes fizike të tij nga një mjedis me jobesimtarë (All-llahu e di të vërtetën). Kështu, pohimi se Profeti Isa (as) vdiq dhe vetëm shpirti i tij u ngrit tek All-llahu dëshmohet të jetë i rrejshëm. Ngritja vetëm e shpirtit do të nënkuptonte se ai nuk u pastrua.

Që Profeti Isa (as) të pastrohej në mënyrën që shpallet në këtë ajet, ai duhej të largohej nga mjedisi që e rrethonte me trup dhe me shpirt. Për më tepër, një pastrim vetëm shpirtëror nuk mund të vlej për një profet me vlera të larta morale, profet i cili është i nderuar në praninë e All-llahut dhe i cili posedon besim të thellë, siç është Profeti Isa (as). Një ajet tjetër flet për vlerat e larta morale të tij: **“Paqja qoftë mbi mua ditën që u linda, ditën që vdes dhe ditën që do të ringjallem përsëri”** (Surja Merjem: 33). Si një besimtar i devotshëm dhe i dërguar i All-llahut, shpirti i Profetit Isa (as) është i papërlyer. Megjithatë, mjedisi ku ai jetonte nuk ishte i papërlyer, për shkak të sjelljes së pafe të jobesimtarëve dhe parimeve të degjeneruara morale. Vërtet, Zoti ynë shpall se ata ishin të papastër për shkak të degjenerimit moral të tyre:

**O besimtarë! Në të vërtetë, idhujtarët janë të papastër (për shkak të besimit të kotë), prandaj të mos i afrohen më Xhamisë së Shenjtë [Mesxhid el-Haram] pas këtij viti... (Surja Teube: 28)**

Prandaj, pastrimi i Profetit Isa (as) nënkupton largimin fizik të tij prej tyre. Pra, All-llahu e pastroi dhe e mbrojti duke e



ngritur Profetin Isa (as) tek Ai (All-llahu e di të vërtetën).

Dijetari Egjiptian Halil Heras jep shpjegimin vijues lidhur me urtësinë e fjalës “pastrim”:

*Pastrimi i Profetit Isa (as) nga jobesimtarët bëhet realitet me shpëtimin e tij nga kurthet e liga të tyre. Kjo nuk mund të bëhet me vdekjen dhe varrimin e Profetit Isa (as), por vetëm me ngritjen e tij duke qenë i gjallë në qiej, sepse armiqtë e tij do të mund ta mundonin atë, siç bënë me personin që besuan të jetë ai... (Muhammed Khalil Heras, Fasl el-Mekel fi Raf'i `Profeti Isa Hajjan ue Nuzulih ue Ketlihi ed-Dexhhal, f. 66)*

Siç shprehet Hamdi Jazir Elmali në komentin e tij, shpëtimi i Profetit Isa (as) nga jobesimtarët është manifestuar me ngritjen e tij:

*... dhe me këtë ngritje Unë do të pastroj ty nga mohuesit dhe jobesimtarët dhe ti s'do të kesh të bësh më asgjë me ta... (Hamdi Jazir Elmali, Hak Din Kuran Dili [Feja e Vërtetë, Gjuha e Kur'anit], 2:1112-13)*



# KTHIMI I PROFETIT ISA (AS) NË TOKË

**N**ga ajo që u tha deri më tani, është e qartë se Profeti Isa (as) nuk ka vdekur por është ngritur në praninë e All-llahut. Megjithatë, ekziston edhe një çështje që është theksuar në Kur'an: Profeti Isa (as) do të kthehet përsëri në tokë.


Kur'ani shpall në mënyrë të qartë kthimin e Profetit Isa (as) në tokë dhe ekzistojnë disa prova për ta vërtetuar këtë:

## **Dëshmia # 1**

Surja Al 'Imran: 55 është një prej ajeteve që tregojnë se Profeti Isa (as) do të kthehet:

**(Kujtoje, o Muhamed) kur All-llahu tha: “O Isa! Unë do të marr, do të ngre pranë Meje dhe do të shpëtoj ty nga ata që nuk besojnë, si dhe do t’i vendos ata që të ndjekin ty, përmbi ata që të mohojnë, deri në Ditën e Kiametit. Pastaj, të gjithë do të ktheheni tek Unë dhe do të gjykoj midis jush për çështjet që jeni grindur. (Surja Al 'Imran: 55)**

Thënia në këtë ajet: “E ata që të besuan ty, do t’i vendos mbi ata që nuk besuan deri në Ditën e Kiametit (Ringjalljes)” është e




rëndësishme. Këtu bëhet fjalë për një grup njerëzish që me përpikëri pasuan Profetin Isa (as) dhe të cilët do të jenë mbi jobesimtarët deri në Ditën e Gjykimit. Atëherë, kush janë këta pasues? A janë ata dishepujt të cilët jetuan në kohën e Profetit Isa (as) ose a janë ata të Krishterët e sotëm?

Para se ai të ngritej tek All-llahu, pasuesit e Profetit Isa (as) ishin të paktë në numër. Pas ngritjes së tij, thelbi i Krishterimit degjeneroi shpejtë. Veç kësaj, dishepujt u përballën me një shtypje të rëndë gjatë gjithë jetës së tyre. Gjatë dy shekujve pasues, duke mos pasur fuqi politike, ata të Krishterë që kishin besim në Profetin Isa (as) ishin gjithashtu të shtypur. Në këtë rast, nuk është e mundur të thuhet se të Krishterët e hershëm apo pasardhësit e tyre gjatë këtyre periudhave ishin më superior fizikisht se jobesimtarët në botë. Logjikisht mund të mendojmë se ky ajet nuk bën fjalë për ata.

Kur shikojmë të Krishterët e sotëm, nga ana tjetër, vërejmë se thelbi i Krishterimit ka ndryshuar në masë të madhe dhe ndryshon dukshëm nga ajo që Profeti Isa (as) fillimisht u solli njerëzve. Të Krishterët përqaftuan besimin e shtrembëruar sipas të cilit Profeti Isa (as) është djali i Zotit dhe në mënyrë të ngjashme besuan doktrinën e trinisë (Ati, Biri dhe Shpirti i Shenjtë). (Pa dyshim se All-llahu është i pastër nga ajo që i përshkruajnë.) Në këtë rast, është e gabueshme që të Krishterët e sotëm të pranohen si pasues të Profetit Isa (as). Në shumë ajete të Kur'anit All-llahu thotë se besimi në trini është besim i zvetënuar:

Pa dyshim, janë jobesimtarë ata që thonë: "All-llahu është njëri prej Trinisë!" Nuk ka veçse një Zot të Vetëm të vërtetë! Nëse nuk heqin dorë nga ato që thonë, patjetër që jobesimtarët nga mesi i tyre do t'i godasë një dënim i dhembshëm.




**Janë jobesimtarë ata që thonë se Mesihu, bir i Merjemes, është i treti i treve. S'ka në gjithësi tjetër pos një All-llahu.(Surja Ma'ide: 73)**

Në këtë rast, komenti i thënies: “E ata që të besuan ty, do t'i vendos mbi ata që nuk besuan deri në Ditën e Ringjalljes” është si vijon: së pari, mendohet se këta njerëz janë Muslimanët të cilët janë të vetmit pasues të vërtetë të mësimëve të mirëfillta të Profetit Isa (as); së dyti, mendohet se këta njerëz janë të Krishterët, pa marrë parasysh se a u përmbahen besimeve idhujtare apo jo dhe kjo duket se vërtetohet me pozitën dominuese që të Krishterët për nga emri kanë sot në tokë. Megjithatë, të dyja palët do të bashkohen me ardhjen e Profetit Isa (as), ai do ta shfuqizojë xhizjen (taksën për mbrojtje që e paguajnë jomuslimanët që jetojnë nën qeverisjen Muslimane), që nënkupton se ai nuk do të pranojë që të Krishterët apo Çifutët të jetojnë me ndonjë fe tjetër përveç fesë Islame dhe kështu do t'i bashkojë të gjithë besimtarët si Muslimanë.

Profeti dhe i Dërguari i fundit i All-llahut (saas), ka dhënë po ashtu lajmin e gëzuar për kthimin e Profetit Isa (as). Dijetarët e haditheve thonë se hadithet mbi këtë temë, në të cilat i Dërguari i All-llahut (saas) ka thënë se Profeti Isa (as) do të zbres në mesin e njerëzve si udhëheqës para Ditës së Gjykimit kanë arritur shkallën *mutavahir*. Kjo do të thotë se ato janë transmetuar nga aq shumë njerëz nga çdo brez, nga një numër aq i madh i Shokëve (Sahabeve) sa që nuk mund të ketë asnjë dyshim për vërtetësinë e tyre. Për shembull:

*Ebu Hurejra transmeton se i Dërguari i All-llahut (saas), ka thënë: “Pasha Atë në duart e të Cilit është shpirti im, pa dyshim se djali i Merjemes së shpejti do të zbres në mesin tuaj si gjykatës i drejtë dhe*



do ta thyej kryqin [do ta shfuqizojë adhurimin e kryqit], do ta vras derrin [do të njoftojë se ngrënia e mishit të derrit është e ndaluar] dhe do ta shfuqizojë xhizjen dhe pasuria do të jetë aq e bollshme sa që askush s' do ta pranojë atë, ndërsa një sexhde e vetme do të ketë më shumë vlerë se bota dhe gjithçka ka në të." (Sahih Buhariu)

Xhabir ibn 'Abdullah ka thënë: "E kam dëgjuar Profetin (saas) duke thënë: 'Një pjesë e ummetit (popullit) tim kurrë s' do të ndalojë së luftuari për të vërtetën në mënyrë ngadhënjimtare deri në Ditën e Ringjalljes. 'Ai tha: 'Pastaj Profeti Isa ibn Merjem, paqja qoftë mbi të, do të zbres dhe emiri i tyre do të thotë: "Eja dhe na udhëheq në faljen e namazit," por ai do të thotë: "Jo! Disa prej jush janë emirë mbi të tjerët," si nderim që All-llahu i bën këtij ummeti.'" (Sahih Muslimi)

Ebu Hurerja transmeton se: "Profeti (saas) ka thënë: 'Nuk ka asnjë profet mes meje dhe atij, do të thotë Profetit Isa, paqja qoftë mbi të. Ai do të zbres (në tokë). Kur ta shihni atë, njiheni: një burrë me gjatësi mesatare, me lëkurë të bardhë në të kuqe, i veshur me veshje të lehtë dy pjesëshe ngjyrë të verdhë, që duket sikur pika uji po bien nga koka e tij edhe pse nuk do të jetë i lagur. Ai do t'i luftojë njerëzit për çështjen e Islamit. Ai do ta thyej kryqin [do ta shfuqizojë adhurimin e kryqit], do ta vras derrin [do të njoftojë se ngrënia e mishit të derrit është e ndaluar] dhe do ta shfuqizojë xhizjen. All-llahu do të bëj që të gjitha fetë të zhduken përveç Islamit. Ai do ta shkatërrojë dexhaxhalin [do ta bëj atë të pafuqishëm] dhe do të jetojë në tokë për dyzet vjet dhe pastaj do të vdes. Muslimanët do t'ia falin atij namazin.' " (Ebu Davudi)

## Dëshmia # 2

Më parë në këtë pjesë të librit, kemi analizuar ajetet



**157-158 të Sures Nisa. Menjëherë pas këtyre ajeteve All-llahu pohon këtë në Suren Nisa 159:**

**Të gjithë ithtarët e Librit do t'i besojnë Isait para se ai të vdesë dhe, në Ditën e Kiametit, ai do të jetë dëshmitar kundër tyre. (Surja Nisa': 159)**

Deklarata e mësipërme “që do të besojnë në të (Profetin Isa) para vdekjes së tij” është i rëndësishëm. Teksti arab i kësaj fjalie lexon: Ue-in min ehli'l-kitebi ille le juminenne bihi keble meutihi.

Disa dijetarë deklaruan se “në të” në këtë ajet është përdorur për Kur'an dhe si pasojë bënë interpretimin në vijim: Nuk do të mbetet asnjë nga Ithtarët e Librit që nuk do të besojnë Kur'an para se ai (një person prej Ithtarëve të Librit) të vdes.


Megjithatë, në ajetet 157 dhe 158, që janë dy ajetet që i paraprijnë këtij ajeti, e njëjta fjalë “atë” është përdorur padyshim për Profetin Isa (as).

Këto ajete thonë:

**Dhe për fjalët e tyre: “Ne e vramë Mesihun – Isain, të birin e Merjemes, të dërguarin e All-llahut”. Por, ata as e vranë, as e kryqëzuan, por ashtu u është dukur. Ata që nuk u pajtuan për çështjen e tij, me siguri që gjenden në dyshim për të. Ata nuk kanë ditur kurrgjë për të, por vetëm kanë hamendësuar. Ata, në të vërtetë, nuk e kanë vranë, (Surja Nisa': 157)**

**Por, All-llahu e ka ngritur pranë Vetes. All-llahu është i Plotfuqishëm dhe i Gjithëdijshtëm. (Surja Nisa': 158)**

Menjëherë pas këtyre vargjeve në Suren Nisa' 159, nuk ekziston asnjë provë që do të dëshmonte se “në të” është përdorur për të nënkuptuar dikë apo diçka tjetër e jo Profetin Isa (as).




**Të gjithë ithtarët e Librit do t'i besojnë Isait para se ai të vdesë dhe, në Ditën e Kiametit, ai do të jetë dëshmitar kundër tyre. (Surja Nisa': 159)**

Në Kur'an, All-llahu na njofton se në Ditën e Gjykimit, “do të dëshmojnë kundër tyre gjuhët, duart dhe këmbët e tyre për çfarë kanë bërë” (Surja Nur: 24 dhe Surja Ja'sin: 65). Nga Surja Fussilet: 20-23, mësojmë se “të dëgjuarit, të parit dhe lëkura do të dëshmojnë kundër nesh.” Megjithatë në asnjërën prej këtyre ajeteve nuk përmendet Kur'ani si dëshmitar. Në qoftë se ne pranojmë se “atij” apo “në të” në fjalinë e parë i referohet Kur'anit – edhe pse gramatikisht dhe logjikisht nuk kemi kurrfarë dëshmie – atëherë duhet të pranojmë po ashtu se “ai” në fjalinë e dytë i referohet Kur'anit. Mirëpo, për ta pranuar këtë, duhet të ketë një ajet të qartë që do ta vërtetonte këtë pikëpamje.

Përveç kësaj, fjalët “... All-llahu e ka ngritur atë pranë Vetes” në ajetin e mësipërm tregon edhe një herë se nuk është Kur'ani ai për të cilin bëhet fjalë në këtë ajet. Kur'ani ka qenë udhërrëfyes për besimtarët për 1400 vitet e fundit dhe nuk është ngritur tek All-llahu. Është Profeti Isa (as) ai i cili është ngritur tek Ai. Kjo është edhe një dëshmi tjetër se të dëshmuarit që përmendet në këtë ajet është ai i Profetit Isa (as) për Ithtarët e Librit, dhe se përemri “ai” në këtë ajet nuk i referohet Kur'anit. (All-llahu e di të vërtetën.)

Në ajetet tjera, shohim se kur i njëjti përemër vetor përdoret për Kur'anin, përgjithësisht përmendet para ose pas atij ajeti specifik si në rastet e Sures Neml: 77 dhe Sures Shua'ra: 192-196. Ky ajet e përcakton qartë se Ithtarët e Librit do të besojnë në Profetin Isa (as) dhe se ai (Profeti Isa [as]) do të jetë dëshmitar kundër tyre.

Pika e dytë ka të bëjë me interpretimin e shprehjes “para se ai






të vdes.” Disa mendojnë se kjo nënkupton të besuarit në Profetin Isa (as) para vdekjes së tyre. Sipas këtij interpretimi secili nga Ithtarët e Librit patjetër do të besojnë në Profetin Isa (as) para se ata të përballen me vdekjen e tyre. Megjithatë, gjuhëtarët arab tregojnë se ky pohim i tyre nuk është i drejtë. Prapashtesa e shumësit hum është përdorur në të gjitha ato ajete të Kur’anit që u referohen Ithtarëve të Librit (si në Suren Bejjine 1 dhe 6, Suren Hadid 29 dhe Suren Hashr 2). Mirëpo, në këtë ajet është përdorur prapashtesa *hu* e njëjësit. Kjo do të thotë se ky ajet njofton se Ithtarët e Librit do të besojnë në Profetin Isa (as) para vdekjes së tij – me fjalë të tjera, para vdekjes biologjike të tij me rastin e ardhjes së dytë. (All-llahu e di të vërtetën.) Përveç kësaj, në kohën e Profetit Isa (as), hebrenjtë që quhen Ithtarë të Librit jo vetëm që nuk besuan në Profetin Isa (as) por ata u përpoqën edhe ta vrisnin atë. Nga ana tjetër, do të ishte e paarsyeshme të thuhet se Çifutët dhe të Krishterët që jetuan dhe vdiqën pas kohës së Profetit Isa (as) kishin besim – mënyrën e të besuarit që përshkruhet në Kur’an – në të.

Si përfundim, kur bëjmë një vlerësim të kujdesshëm të këtij ajeti, vijmë në përfundimin vijues: Para vdekjes së Profetit Isa (as), të gjithë Ithtarët e Librit do të besojnë në të.<sup>15</sup> Me fjalë të tjera, me rastin e ardhjes së dytë të Profetit Isa (as), të gjithë Ithtarët e Librit do të bëhen Muslimanë si pasues të tij dhe morali Islamik do të mbizotërojë në Tokë.

Përveç kësaj, ky ajet flet për të ardhmen, sepse përmendet vdekja e Profetit Isa (as). Megjithatë, Profeti Isa (as) nuk ka vdekur por është ngritur në praninë e All-llahut. Profeti Isa (as) do të vijë përsëri në tokë, ai do të jetojë për një kohë të caktuar dhe pastaj do të vdes. Gjithashtu, të gjithë Ithtarët e Librit do të besojnë në të. Kjo është një ngjarje e cila nuk ka ndodhur ende,



por që pa dyshim do të ndodhë në të ardhmen.

Rrjedhimisht, shprehja “para se ai të vdes”, i referohet Profetit Isa (as). Ithtarët e Librit do ta shohin atë, do ta njohin atë dhe do t’i binden atij sa është gjallë. Ndërkaq, Profeti Isa (as) do të dëshmojë kundër tyre në Ditën e Fundit e All-llahu e di të vërtetën.

### **Dëshmia # 3**


Se Profeti Isa (as) do të kthehet përsëri në tokë kah fundi i kohës rrëfehët në një ajet tjetër të Kur’anit

**Kur u soll si shembull i biri i Merjemes (Profeti Isa a.s.), populli yt (o Muhamed) menjëherë nisi të qeshë duke thënë: “A janë më të mirë idhujt tanë apo ai?”** Ata ta paraqesin këtë shembull vetëm për shkak se duan të hahen, sepse janë popull grindavec. **Isai ishte vetëm një rob, të cilit Ne i dhuruam (Profeci) dhe e bëmë shembull për bijtë e Izraelit. Sikur të duam, Ne (do t’ju shkatërronim dhe) në vendin tuaj do të bënim engjëj, që do t’ju trashëgonin në Tokë. (Surja Zuhruf: 57-60)**

Menjëherë pas këtyre ajeteve, All-llahu deklaroi se Profeti Isa (as) është shenjë e Ditës së Gjykimit.

**Në të vërtetë, Isai është shenjë e Orës (së Kiametit), në ardhjen e të cilës mos dyshoni kurrësi. Pra, ndiqmëni mua, kjo është rruga e drejtë! (Surja Zuhruf: 61)**

Ky ajet na njofton se Profeti Isa (as) do të kthehet në tokë në fundin e kohës. Kjo për arsye se Profeti Isa (as) jetoi përafërsisht gjashtë shekuj para shpalljes së Kur’anit. Rrjedhimisht, nuk mund ta interpretojmë ardhjen e tij të parë si shenjë të Ditës së Gjykimit. Ajo që ky ajet tregon në të vërtetë është se Profeti Isa




(as) do të kthehet përsëri në tokë kah fundi i kohës dhe kjo do të jetë shenjë për Ditën e Gjykimit.

Ajeti “Ai është parashenjë e orës (momentit, kiametit)” në arabisht është *Innehu le ‘ilmun li’s-sa’ati...* Disa e interpretojnë përemrin hu në këtë ajet si Kur’ani. Mirëpo, ajetet që e paraprijnë tregojnë qartë se Profeti Isa (as) përmendet në këtë ajet: **“Ai (Isai) ishte vetëm një rob, të cilit Ne i dhuruam (Profeci) dhe e bëmë shembull për bijtë e Izraelit.”**<sup>16</sup>

Ata që e përmendin këtë përemër sikur ai t’i referohej Kur’anit vazhdojnë të citojnë pjesën tjetër të ajetit “Mos dyshoni kurrsesi në të. Pra, ndiqmëni mua” si të ashtuquajtur dëshmi. Megjithatë, ajetet që i paraprijnë këtij ajeti i referohen në tërësi Profetit Isa (as). Për këtë arsye, duket se përemri hu është i lidhur me këto ajete paraprake dhe gjithashtu i referohet Profetit Isa (as). Në të vërtetë, dijetarët e mëdhenj Islamik pohojnë se bëhet fjalë për këtë, duke u mbështetur në përdorimin e përemrit si në Kur’an ashtu edhe në hadithe.

Në mesin e dijetarëve bashkëkohor Islamik, Sejid Kutbi tërhoqi vëmendjen ndaj provave të rëndësishme në lidhje me ardhjen e dytë të Profetit Isa (as), në komentin e tij:

*Shumë hadithe kanë të bëjnë me zbritjen e Profetit Isa (as) në tokë para Ditës së Gjykimit. Në të vërtetë, ajeti “Ai është Parashenjë e Orës” e dëshmon këtë po ashtu. Me fjalë të tjera, Profeti Isa (as) do të zbres në tokë në një kohë të afërt me Ditën e Gjykimit. Në një stil tjetër të leximit, ky ajet thotë “ue innehu le ‘ilmun li el-saa’ati.” Me fjalë të tjera, zbritja e tij është një shenjë, shenjë e Ditës së Gjykimit. Të dyja mënyrat e leximit shprehin kuptimin e njëjtë. Zbritja e tij prej qiejve është një lajm nga Bota e Padukshme, i thënë nga Profeti që ka folur të vërtetën dhe i besueshëm (saas) dhe që është treguar në Kur’anin Famëlartë. Përveç informacionit nga këto dy burime, të*



*cilat do të mbeten të pandryshuara deri në Ditën e Gjykimit, askush nuk mund të thotë asgjë tjetër lidhur me këtë temë.*<sup>17</sup>

El-Keutheri deklaroi se madje edhe në tekstet më të vjetra të doktrinës, ky ajet ishte përdorur si dëshmi për kthimin e Profetit Isa (as).<sup>18</sup> Omer Nasuhi Bilmen e interpretoi këtë ajet me këto fjalë:

*Ai sjell lajmin, në mënyrë të padyshimt, se Profeti Isa (as) është shenjë e afrimit të Ditës së Gjykimit dhe se Dita e Gjykimit do të vijë pa dyshim... Paraqitja e tij në tokë konsiderohet si ligj i Ditës së Fundit...<sup>19</sup>*

Në fakt, ky titull është unik për Profetin Isa (as), sepse edhe pse Kur'ani përshkruan jetët e Profetit Muhammed (saas), Ibrahim (as), Nuh (as), Musa (as), Sulejman (as), Jusuf (as), Davud (as), Jakub (as) dhe të një numri të madh të profetëve të tjerë, ky titull nuk është përdorur për asnjërin prej tyre. Ky fakt është edhe një tregues tjetër se Profeti Isa (as) posedon një karakteristikë të veçantë që profetët e tjerë nuk e posedojnë: Ai do të kthehet në Tokë pasi që u ngrit në praninë e All-llahut e All-llahu e di të vërtetën.

#### **Dëshmia # 4**

Ajetet tjera që tregojnë për ardhjen e dytë të Profetit Isa (as) janë si vijon:

**(Kujto) kur engjëjt thanë: “O Merjeme! All-llahu të jep lajmin e mirë për një (djalë që do të lindë me një) Fjalë prej Tij: emrin do ta ketë Mesih - Isa i biri i Merjemes, do të jetë i nderuar në këtë botë dhe në tjetrën dhe një nga të afërmit e All-llahut. Ai do t’u flasë njerëzve qysh i vogël në djep edhe si njeri i rritur dhe do të jetë nga**



më të mirët". Ajo tha: "Zoti im! Qysh do të kem unë fëmijë, kur nuk më ka prekur askush?!" – "Kështu – tha (engjëlli) All-llahu krijon ç'të dojë Vetë. Kur vendos diçka, Ai vetëm thotë për të: "Bëhu!" dhe ajo bëhet." (All-llahu) do t'ia mësojë atij Librin, diturinë, Teuratin dhe Ungjillin (Surja Al 'Imran: 45-48)


Në këtë ajet, kumtohet se All-llahu do t'ia mësojë Profetit Isa (as) *Inxhilin*, Teuratin dhe "Librin." Të njëjtën shprehje e gjejmë edhe në Suren Ma'ide:110:

**All-llahu do të thotë: "O Isa, i biri Merjemes, kujtoje mirësinë Time ndaj teje dhe nënës sate: se si të forcova ty me Shpirtin e Shenjtë (Xhibrilin), kështu që ti u predikoje njerëzve, kur ishe foshnjë në djep dhe i rritur; se si të mësova Librin dhe Urtësinë, Teuratin dhe Ungjillin; se si me vullnetin Tim krijove një figurë shpendi prej balte..." (Surja Ma'ide 110)**

Kur analizojmë "Librin" në të dyja ajetet, shohim se mund të bëhet fjalë për Kur'anin. Në këto ajete shpallet se Kur'ani është libri i fundit hyjnor i dërguar përveç *Teuratit*, *Zeburit* dhe *Inxhilit*. Përveç kësaj, në një ajet tjetër në Kur'an, pranë Teuratit dhe Inxhilit, fjala "Libër" është përdorur për të treguar Kur'anin.

**All-llahu! Nuk ka zot tjetër (që meriton adhurimin) përveç Tij, të Gjallit, të Përjetshmit, Mbajtësit të gjithçkaje. Ai të ka shpallur ty Librin, me të vërtetën e saktë, duke vërtetuar shpalljet e mëparshme. Ai i ka zbritur Teuratin dhe Ungjillin... (Surja Al 'Imran: 2-3)**

Ajetet tjera në të cilat "Libri" i referohet Kur'anit shpallin: Dhe, kur një Libër që vërtetonte Shkrimet e tyre, u erdhi atyre nga All-llahu, ndonëse përpara luteshin për ndihmë kundër jobesimtarëve, pra, kur u erdhi ajo që e



**dinin se është e vërtetë, ata e mohuan atë! Prandaj mallkimi i All-llahut qoftë mbi mohuesit! (Surja Bekare: 89)**


**Po kështu, (për të plotësuar mirësinë Time ndaj jush) ju kam sjellë një të Dërguar, nga mesi juaj, i cili ju lexon shpalljet Tona, ju pastron (nga gjynahet), ju mëson Librin (Kuranin) e Urtësinë (rregullat e fesë) dhe ju mëson ato gjëra që nuk i keni ditur. (Surja Bekare: 151)**

Në këtë rast, është e qartë se libri i tretë që do t'i mësohet Profetit Isa (as) do të jetë Kur'ani dhe se kjo do të jetë e mundur vetëm nëse ai vjen në tokë në fundin e kohës. Profeti Isa (as) ka jetuar përafërsisht 600 vjet para shpalljes së Kur'anit. Përveç kësaj, edhe hadithet e Profetit tonë (saas) janë një dëshmi tjetër që na informon se kur Profeti Isa (as) do të vijë për herë të dytë, ai do të komandojë me Kur'an, jo me Inxhil.

*Ai do të ju udhëheq sipas Librit të Zotit tuaj dhe Sunnetit të Pejgamberit tuaj. (Sahih Muslimi)*

Siç tregon qartë kjo shprehje, kur Profeti Isa (as) të kthehet në tokë, ai do të sundojë me urdhrat e Kur'anit dhe do ta mbajë Sunnetin e Profetit Muhammed (saas), një hadith i cili është në përputhshmëri me ajetet Kur'anore. (Pa dyshim All-llahu e di të vërtetën.)

Një tjetër pjesë e rëndësishme e informacionit është se fjala e shpallur për Profetin Isa (as) nuk u shpall për asnjë profet tjetër. Për shembull, Kur'ani zbulon se Teurati iu dha Profetit Musa (as), Suhufet (Fletushkat) iu dhanë Profetit Ibrahim (as) dhe Libri i Psalmeve iu dha Profetit Davud (as). Po të kishte libra të shpallur para kohës së profetëve, Kur'ani deklaron se ata i dinin ato. Megjithatë, vetëm në rastin e Profetit Isa (as) Kur'ani shpall



se një profet do të mësojë një libër që u shpall pas kohës së tij. Ky është një prej treguesve se ai do të kthehet në tokë dhe se kur të kthehet, ai do të sundojë me librin e shpallur pas kohës së tij: Kur'anin. (All-llahu e di të vërtetën.)

### **Dëshmia # 5**

Përveç asaj që u tha më lart, ajeti “Shembulli i Isait për All-llahun është si shembulli i Ademit.” (Surja Al ‘Imran: 59) gjithashtu mund t’i referohet kthimit të Profetit Isa (as).


Dijetarët Muslimanë të cilët kanë shkruar komentet Kur’anore theksojnë se ky ajet tregon faktin se të dy profetët nuk kishin baba, sepse All-llahu i krijoi ata të dy me urdhrin “Bëhu!” Mirëpo, ky ajet mund të ketë edhe një kuptim tjetër: Ashtu siç u zbrit në Tokë Profeti Adem (as) duke u larguar nga prania e All-llahut, Profeti Isa (as) mund të zbres në Tokë duke u larguar nga prania e All-llahut gjatë Kohës së Fundit. (All-llahu e di të vërtetën.) Siç kemi parë, ajetet e Kur’anit lidhur me kthimin në Tokë të Profetit Isa (as) janë plotësisht të qarta.

### **Dëshmia # 6**

All-llahu tregon për ngritjen e Profetit Isa (as) në Suren Merjem si vijon:

**Le të jetë paqja e shpëtimiti mbi mua, në ditën që kam lindur, në ditën që do të vdes dhe në ditën që do të ringjallem!” (Surja Merjem: 33)**

Kur e marrim parasysh këtë ajet së bashku me Al ‘Imran: 55, ai flet për një të vërtetë shumë të rëndësishme. Në ajetin e Sures Al ‘Imran thuhet se Profeti Isa (as) është ngritur në praninë e All-llahut. Nuk është dhënë asnjë informacion në këtë ajet për vdekje apo vrasje. Megjithatë, në Suren Merjem: 33 është dhënë



informacioni për ditën kur Profeti Isa (as) do të vdes. Ajo vdekje e dytë ka mundësi të ndodhë vetëm nëse Profeti Isa (as) vdes pas kthimit dhe pasi që të jetojë për një kohë në tokë. (All-llahu e di të vërtetën.)

### **Dëshmia # 7**


Një tjetër dëshmi në lidhje me kthimin e Profetit Isa (as) në tokë paraqitet në Suren Ma'ide dhe në Suren Al 'Imran në trajtën e fjalës *kehlen*. Këto ajete thonë:

**All-llahu do të thotë: “O Isa, i biri Merjemes, kujtoje mirësinë Time ndaj teje dhe nënës sate: se si të forcova ty me Shpirtin e Shenjtë (Xhibrilin), kështu që ti u predikojë njerëzve, kur ishe foshnjë në djep dhe i rritur (burrë) (*kehlen*)...” (Surja Ma'ide 110)**

**Ai do t'iu flas njerëzve qysh në djep dhe si i pjekur (burrë) (*kehlen*) dhe do të jetë nga të përsosurit (Surja Al 'Imran: 46)**

Kjo fjalë paraqitet vetëm në dy ajetet e mësipërme në Kur'an dhe vetëm në lidhje me Profetin Isa (as). Kuptimi i fjalës *kehlen*, i përdorur për t'iu referuar kohës së pjekurisë së Profetit Isa (as) përrputhet me moshën në mes 30 dhe 50 vjeçare, me dikë që nuk është më i ri, dikë që ka arritur moshën e përkryer. Dijetarët Islamik pajtohen që kjo fjalë të përkthehet si një fjalë që tregon periudhën pas moshës 35 vjeçare.

Bazuar në një hadith të transmetuar nga Ibn Abbasi që njofton se Profeti Isa (as) u ngrit në qiell në fillim të viteve të tridhjeta të tij, në një moshë të re, dhe do të qëndrojë edhe për dyzet vite të tjera kur të kthehet, dijetarët Islamik thonë se pleqëria e Profetit Isa (as) do të ndodhë pasi që ai të kthehet në tokë.<sup>20</sup>






Kur i analizojmë me kujdes ajetet e Kur'anit, shohim se ky formulim është përdorur vetëm për Profetin Isa (as). Të gjithë profetët u folën njerëzve dhe u bënë thirrje në rrugën e drejtë. Ata të gjithë komunikuan porosinë e tyre në moshë të pjekur. E megjithatë, nuk ekziston asnjë formulim i tillë në Kur'an për cilindo profet tjetër. Ky formulim është përdorur vetëm për t'iu referuar Profetit Isa (as) dhe tregon pozitën e tij të mrekullueshme. Kjo për arsye se fjalët “në djep” dhe “në moshë të pjekur” që pasojnë njëra tjetrën në këto ajete e vënë theksin në dy periudha të mrekullueshme.

Në të vërtetë, në veprën e tij Komenti i Tabariut, Imam Tabariu jep këtë shpjegim lidhur me këto ajete:

*Këto thënie (Surja Ma'ide: 110) tregojnë se për ta plotësuar jetëgjatësinë e tij dhe për t'iu folur njerëzve në moshë të pjekur Profeti Isa (as) do të zbres nga qielli. Kjo për arsye se ai u ngrit në qiell kur ishte ende i ri. Në këtë ajet (Surja Al 'Imran: 46) ka dëshmi se Profeti Isa (as) është i gjallë dhe Ehl el-Sunneti (Populli i Sunnetit) e ndanë këtë pikëpamje. Kjo për arsye se në këtë ajet pohohet se ai do t'iu flas njerëzve në moshë të pjekur. Ai do të mund ta arrijë moshën e pjekur vetëm kur të zbres në tokë nga qielli.<sup>21</sup>*

Megjithatë, disa njerëz e interpretojnë shprehjen “në moshë të pjekur” në një mënyrë shumë të largët nga kuptimi i saj i vërtetë dhe nuk e analizojnë atë në kontekst me logjikën e përgjithshme të Kur'anit. Këta njerëz janë të mendimit se profetët kanë qenë gjithmonë njerëz të pjekur, për ç'arsye shprehja i referohet jetëve të gjithë profetëve. Sigurisht profetët ishin njerëz të pjekur të cilët All-llahu i ka edukuar. Mirëpo, në Suren Ahkaf All-llahu zbulon se moshja e pjekurisë së plotë është dyzet vjet. Në këtë ajet shpallet se:

**Njeriun e kemi porositur të jetë i sjellshëm ndaj**



prindërve të vet. Nëna e mbart atë me mund dhe me mund e lind. Ai mbartet dhe ushqehet me gji për tridhjetë muaj dhe, kur arrin në moshën e burrërisë e i mbush dyzet vjet, ai thotë: “O Zoti im! Më frymëzo që të falënderoj për begatitë që Ti më ke dhënë mua dhe prindërve të mi dhe që të bëj vepra të mira, me të cilat Ti do të jesh i kënaqur! Më dhuro pasardhës të mirë! Tek Ty kthehem i penduar dhe Ty të dorëzohem!” (Surja Ahkaf: 15)

Prandaj, fjala *kehlen* gjithashtu tregon për kthimin e Profetit Isa (as) në tokë ashtu si gjithë informacioni tjetër i dhënë në Kur’an. (All-llahu e di të vërtetën.)

Në Kur’an ekzistojnë shembuj të tjerë të njerëzve të cilët u larguan nga kjo botë dhe pastaj u kthyen pas qindra vitesh

### **Njeriu i cili u ringjall pas një shekulli**

Njëri prej këtyre njerëzve është një burrë i cili qëndroi i vdekur për një shekull. Kjo rrëfëhet në Suren Bekare:

Kur’ani jep shembullin e një njeriu i cili qëndroi i vdekur për një shekull. Kjo rrëfëhet në Suren Bekare:

Po për atë i cili, kur kaloi pranë një qyteti të rrënuar përtokë, tha: “Si mund ta kthejë në jetë All-llahu këtë qytet tani që ai është i vdekur?!” Dhe All-llahu e bëri atë të vdes për njëqind vjet e pastaj e ringjalli dhe e pyeti: “Sa kohë ke ndenjur këtu?” - Ai u përgjigj: “Një ditë ose gjysmë dite”. - “Jo” - i tha All-llahu, “por ke ndenjur njëqind vjet. Shiko ushqimin dhe pijen tënde që nuk janë prishur! Shikoje gomarin tënd (si do ta ringjallim) që të bëjmë ty dëshmi mrekullie për njerëzit; vështroji eshtrat se si i bashkojmë e pastaj i



**veshim me mish!" Kur atij iu bë e qartë, ai tha:  
"Tashmë e di se All-llahu është i Fuqishëm për çdo  
gjë!" (Surja Bekare: 259)**

Në ajetet e paraqitura në faqet e mëparshme, përmendet fakti se Profeti Isa (as) nuk kishte vdekur por është "marr." Në ajetin e mësipërm, ky njeri, megjithatë, vdiq pa dyshim. Rrjedhimisht, madje edhe një person i vdekur mund të ringjallet me vullnetin e All-llahut dhe ajeti i mësipërm e pohon këtë në mënyrë të qartë.


### **Shokët e shpellës u zgjuan pas shumë viteve**

Historia e "Shokëve të Shpellës" është rrëfyer në Suren Kehf. Këta ishin disa të rinj të cilët ishin të shtrënguar të strehohen nga tirania e vrazhdë e sundimtarit të asaj kohe në një shpellë. Rrëfëhet se ata i zuri gjumi dhe u zgjuan pas shumë viteve të kaluara në gjumë:

**Kur disa djelmosha u strehuan në shpellë dhe thanë:  
"O Zoti ynë, na jep mëshirë nga ana Jote dhe përgatitna  
për sjellje të drejtë!" Ne ua mbyllëm veshët atyre (duke  
i lënë të flinin) në shpellë për shumë vjet. (Surja Kehf:  
10-11)**

Dhe (po të kishe qenë atje), do të mendoje se ata ishin të zgjuar, por ata ishin në gjumë. Ne i rrotullonim ata herë në krah të djathtë e herë në të majtë, kurse qeni i tyre rrinte shtrirë me dy këmbët e para në hyrje të shpellës. Sikur t'i kishe parë, ti do të ikje nga ata dhe do të kaplonte frika.

Kështu pra, Ne i zgjuam që të pyesnin njëri-tjetrin. Njëri nga ata tha: "Sa keni ndenjor (në gjumë?)" - U




**përgjigjën: “Kemi qëndruar një ditë a një pjesë të ditës”. Disa thanë: “Zoti juaj e di më mirë se sa keni ndenjur. Dërgoni njërin prej jush në qytet me këtë monedhë argjendi tuajën e le të shikojë se cili ushqim është më i pastër. Le t’ju sjellë diçka prej tij, le të silltet mirë dhe askush të mos marrë vesh për ju. (Surja Kehf: 18-19)**

Kur’ani nuk shpjegon saktësisht sa kohë kaluan në shpellë këta të rinj. Në vend të kësaj, kohëzgjatja e kësaj periudhe përfshihet në shprehjen “për disa vite.” Supozimi i njerëzve të kësaj kohe megjithatë ishte goxha i lartë: treqind e nëntë vjet. All-llahu thotë:

**Ata qëndruan në shpellën e tyre treqind vjet (diellorë), duke shtuar nëntë (për vitet hënore). Thuaj (o Muhamed): “All-llahu e di më mirë sa kanë qëndruar. Atij i përket fshehtësia e qiejve dhe e Tokës. Eh, sa mirë sheh Ai çdo gjë dhe sa mirë që dëgjon! Njerëzit nuk kanë tjetër mbrojtës përveç Atij dhe Ai nuk e ndan me askënd pushtetin e Vet.” (Surja Kehf: 25-26)**

Në kushte normale, njerëzit natyrisht nuk mund të flenë për një kohë kaq të gjatë. Prandaj, ky gjumë nuk mund të jetë i llojit të gjumit të cilin ne e njohim. Ndoshta ata janë marr në një dimension tjetër në të cilin koha dhe hapësira nuk vlejnë dhe më vonë janë kthyer në tokë.

Këta njerëz u kthyen në jetë ashtu siç zgjohen njerëzit nga gjumi. Në mënyrë të ngjashme, Profeti Isa (as) do të kthehet në jetë kur ai të zbres përsëri në tokë dhe, pas përmbushjes së përgjegjësive së ndershme e cila i është ngarkuar prej All-llahut, dhe, si kërkesë e ajetit: Ai tha: **“Aty (në tokë) do të jetoni, aty do të vdisni dhe prej saj do të ringjalleni.”** (Surja A’raf: 25) ai do të



vdes në tokë, si çdo qenie tjetër njerëzore e All-llahu e di të vërtetën.


### **Kthimi i Profetit Isa (as) në Tokë në Hadithe**

Fakti se Profeti Isa (as) është gjallë në Praninë e All-llahut dhe se ai do të kthehet në tokë në fundin e kohës paraqitet deri në një masë në përmbledhjet e haditheve, midis tyre *Tejsir el-Usul ile Xhemi'el-Usul* i el-Shejbanit; *El-Muvette'* i Imam Malikit; *Sahihet* e Ibn Huzejmes dhe Ibn Hibbanit; dhe *Musnedet* e Ibn Hanbelit dhe el-Tejelisit, që konsiderohen si burimet kryesore të shumicës së haditheve të besueshme. Për më tepër, shumë dijetarë Islamik kanë bërë hulumtime dhe studime lidhur me këto fakte dhe kanë shkruar libra dhe libra mësimor për to. Këto janë gjithashtu burime të paçmueshme.

Ai që udhëheq listën e këtyre dijetarëve të mëdhenj Islamik është Ebu Hanifja, themelues i shkollës juridike Hanefi. Në kapitullin e fundit të librit të tij *El-Fikh el-Ekber*, Ebu Hanife thotë:

*Shfaqja e antikrishtit dhe Jexhuxhëve dhe Mexhuxhëve është e vërtetë; lindja e Diellit në perëndim është e vërtetë; zbritja e Profetit Isa (as) nga qiejt është e vërtetë; dhe të gjitha shenjat tjera të Ditës së Ringjalljes, që përfshihen në sunnetin e vërtetë, janë realitete të vërtetuara.<sup>22</sup>*

Hadithet lidhur me ardhjen e dytë të Profetit Isa (as) janë tavatur, një shprehje e posaçme e definuar si “traditë e cila është përcjellë nga një numër i kanaleve të ndryshme të transmetuesve apo autoriteteve, të cilat mund të thuhet se përjashtojnë mundësinë e të qenit të falsifikuara.” Përgjithësisht, hadithe të besueshme janë ato për të cilat shumë ekspertë të haditheve kanë njoftuar se nuk ka hapësirë në to për gabime. Dijetari Islamik Sejjid el-Xhurxhani ka interpretuar këtë mendim si vijon:



Në përgjithësi, transmetime të besueshme janë ato që e arrijnë një nivel të tillë [të pajtueshmërisë] midis shumicës së transmetuesve që, sipas zakonit, [konsiderohet] e pamundshme që një numër aq i madh i raportuesve të pajtohen për pavërtetësinë e tyre. Në atë rast, nëse fjalët dhe kuptimi i transmetimit janë të qëndrueshme, atëherë kjo njihet si “besueshmëri e fjalës.” Nëse ka pajtueshmëri midis të gjithëve sa i përket arsyes dhe kuptimit, por kundërthënie në fjalë, atëherë kjo njihet si “pajtueshmëri konceptuale.” (El-Sejjid el-Sherif, Zafar el-Amani fi Sharh Mukhtasar el-Sejjid el-Sherif el-Xhurxhani fi Mustaleh el-Hadith, f. 46)

Ju paraqesim një përzgjedhje të këtyre haditheve:


*Profeti Isa (as), i biri i Merjemes, pa dyshim se do të zbres si një gjyqtar i drejtë dhe sundimtar i drejtë. (Imam Neveviu, Koment për Sahih Muslim)*

*Dita e fundit nuk do të ndodhë derisa Profeti Isa, i biri i Merjemes, të vijë si një sundimtar i drejtë dhe një imam i drejtë. (Sunan Ibn Maxhah)*

*Pasha Atë në Dorën e të Cilit është shpirti im, djali i Merjemes, (Profeti Isa [as]) së shpejti do të zbres midis jush si sundimtar i drejtë. (Sahih Buhariu)*

*Nuk ka asnjë profet mes tij (Profetit Isa [as]) dhe meje. Ai pa dyshim do të zbres. Kur ta shihni, njiheni. Ai ka gjatësi mesatare, ngjyrë të bardhë në të kuqe. Ai do të ketë të veshur një veshje të lehtë dy pjesëshe ngjyrë të verdhë. Pika uji do të bien nga flokët e tij edhe pse nuk bie shi. Ai do t'ia luftojë njerëzit për Islamin. Ai do ta vras antikrishtin [do ta bëjë të paefektshëm] dhe pastaj do të jetojë në tokë për dyzet vjet saktësisht. Pastaj do të vdes dhe Muslimanët do t'ia falin atij namazin. (Sahih Buhariu dhe Sahih Muslimi)*

*Çfarë do të bëni kur djali i Merjemes të zbres midis jush dhe të*



*udhëheq si njëri prej jush? (Sahih Muslimi)*

*Profeti Isa, i biri i Merjemes (as) do të zbres pastaj dhe udhëheqësi i tyre [Muslimanëve] do ta ftojë atë t'i udhëheq në namaz. Por ai do të thotë: "Jo, disa prej jush janë udhëheqës mbi disa [prej jush.]" (Sahih Muslimi)*

## **Profeti Isa (as) dhe Hazreti Mehdiu (as) do të vijnë në këtë shekull**


Veprat e dijetarëve të mëdhenj dhe të nderuar të Ehl el-Sunneh, duke përfshirë Sunan Ebu-Davudin dhe Mektubet e Imam Rabbanit, qartë pohojnë se All-llahu dërgon një individ në çdo shekull në mënyrë që ta ripërtërij dhe ta pastroj moralin fetar prej çfarëdo risie:

*Sipas rrëfimit të Ebu Hurejres, i Dërguari i All-llahut (saas) ka thënë: Pa dyshim se All-llahu i Plotfuqishëm dhe i Gjithëpushtetshëm do ta dërgojë një individ në fillim të çdo shekulli i cili do ta përtërijë besimin dhe do ta pastrojë atë nga risitë e mëvonshme. (Sunan Ebu Davud, 5/100)*

Një hadith i transmetuar nga Profeti ynë (saas) thotë se Hazreti Mehdiu (as) do të shfaqet në vitin Islamik 1400 me fjalët:

***Njerëzit do të mblidhen rreth Hazreti Mehdiut (as) në vitin 1400. (Risale el-Huruxh el-Mehdi, f. 108)***

Vlerat morale fetare të Islamit do ta sundojnë gjithë botën, si rezultat i një procesi të veçantë, në këtë shekull, ndërsa sistemi i dexhshalit (antikrishtit) që kundërshton këto vlera do të zhduket krejtësisht. Por pas kësaj periudhe të përparimit, e cila do të zgjasë për rreth 100 vjet, bota përsëri do të ndodhet në një fazë degjenerimi, rreth viteve 1500 sipas kalendarit Islamik. Në një hadith të transmetuar nga shumë dijetarë, duke përfshirë



Imam Ahmed Ibn Hanbelin, një dijetar i madh i haditheve të Ehl el-Sunneh dhe jurisprudencës Islamike, Profeti ynë (saas) jep informacion të rëndësishëm për fillimin e historisë njerëzore duke thënë se 5600 vite kanë kaluar deri në kohën e tij:


*Ahmed Ibn Hanbeli transmetoi në 'Ilel-in e tij: PESË MIJË E GJASHTË QIND VITE KANË KALUAR NGA JETA E KËSAJ BOTE. (Al-Burhan fi Alamat al-Mahdi Akhir al-zaman, f. 89)*

Shumë hadithe të tjera përmbajnë referenca të qarta se jetëgjatësia e kësaj bote është 7000 vjet:

*Enes Ibn Maliku rrëfen se i Dërguari i All-llahut (saas) ka thënë: JETËGJATËSIA E KËSAJ BOTE ËSHTË SHTATË DITË SIPAS DITËVE TË JETËS SË PËRTEJME. All-llahu i Plotfuqishëm ka thënë: NJË DITË NË SYTË E ZOTIT TUAJ ËSHTË SI NJË MIJË VITE TUAJA. All-llahu do t'ia MVESHË EKUIVALENTIN E VEPRAVE TË MIRA TË SHTATË MIJË VITEVE TË JETËS SË KËSAJ BOTE atij e cili plotëson nevojën e ndonjërit prej vëllezërve të tij në fe në rrugën e All-llahut sikurse ai t'i kalonte ditët duke agjëruar dhe netët e tij në adhurim. (Al-Burhan fi Alamat al-Mahdi Akhir al-zaman, f. 88)*

*Transmetuar nga Dakkak Ibn Zeid el-Xhuhani: Unë ia tregova të Dërguarit të All-llahut (saas) një ëndërr që kisha parë. Në atë ëndërr i Dërguari i All-llahut ishte në majë të një minberi shtatë-shkallësh. Ai tha: MINBERI SHTATË-SHKALLËSH QË E SHEH ËSHTË MOSHA SHTATË MIJË VJEÇARE E KËSAJ BOTE. (Al-Burhan fi 'Alamat al-Mahdi Akhir az-Zaman, f. 89)*

Said Nursi, përtëritës i viteve 1300 Islamike dhe më i madhi i mijëvjeçarit të fundit, përmendi vitet 1500 Islamike si periudhën e sundimit të vlerave morale Islamike. Ai deklaroi se Muslimanët do ta gëzojnë një kohë të fitores së plotë dhe të





sigurt deri atëherë. Ai tha se në vitet që do të pasojnë, ngritjes së vlerave morale të Islamit do t'i vijë fundi dhe se Dita e Fundit do të gdhijë për jobesimtarët në vitin 1545 Islamik. (All-llahu e di të vërtetën.)

*“Një grup prej ummetit (komunitetit) tim do të mbetet në të vërtetën deri në urdhrin e All-llahut [Ditën e Fundit].”*

*Kalkulimi numerik i fjalisë “Një grup nga ummeti (komuniteti) im...” do të thotë viti 1542 [2117] nënkupton kohën e ekzistencës së tij [ummetit]. Kalkulimi numerik i fjalisë “do të mbetet në të vërtetën” (kur të llogaritet shenja e dyfishimit) jep vitin 1506 [2082]; tregon se deri më atë datë [2082] do të vazhdojë punën e tij të ndriçimit të mendjes në mënyrë të dukshme dhe të qartë dhe mbase ngadhënjimtare; pastaj deri në vitin 1542 [2117] në fshehtësi dhe disfatë. Kalkulimi numerik i fjalisë “deri në urdhrin e All-llahut” (kur llogaritet shenja e dyfishimit) sugjeron se DITA E FUNDIT DO T’IU NDODHË jobesimtarëve në vitin 1545 [2120] (Shtojca Kastamonu, f. 33)*

Dijetari i madh Sunni al-Barzanji pohon se jetëgjatësia e kësaj bote nuk do të arrij vitin 1600 Islamik, me fjalë të tjera, se Dita e Fundit pritet të vijë në vitet 1500 Islamike me lejen e All-llahut (All-llahu e di të vërtetën.)

**JETËGJATËSIA E KËTIJ UMMETI DO TË TEJKALOJË 1,000 VJET, POR DO TË JETË E KUFIZUAR NË 1,500 VJET...**  
(Muhammad ibn `Abd ar-Rasul Barzanji, Al-Isha`ah li Ashrat as-Sa`ah, Shenjat e Fundit të Botës, f. 299)

Deklarata e Sujutit e bërë duke u mbështetur në hadithin e thënë nga Profeti ynë (saas) është si vijon:

**JETËGJATËSIA E UMMETIT TIM NUK DO TË TEJKALOJË 1,500 VJET.** (Suyuti, al-Kasfu an Mujauazati Hazihil Ummah al-




*Alfu, al-hauil lil Fataui. 2/248, Tafsir Ruh-ul Bayan. Bursauil 4/262, Ahmad ibn Hanbal, Kitab al-'Ilal, f. 89)*

Siç shihet qartë nga ky hadith i Profetit (saas) dhe pohimeve të dijetarëve të mëdhenj vitet 1400 Islamike që ne po i jetojmë janë epoka e ardhjes së Hazreti Mehdiut (as). Profeti Isa (as) do të kthehet në Tokë në këtë shekull. Hazreti Mehdiu (as) do të shfaqet dhe vlerat morale të Islamit do ta sundojnë botën.

### **Besimtarët do të jenë të mbrojtur nga Fitneja [Sprova dhe Fatkeqësia] e Dexhxhalit nëpërmjet Profetit Isa (as)**

Koncepti i dexhxhalit (antikrishtit), që do të thotë “gënjeshtar, mashtrues, ai i cili pështjellon të mirën dhe të keqen, të vërtetën dhe të pavërtetën në mendjen dhe zemrat e njerëzve, ai i cili praron një gjë për ta fshehur fytyrën e saj të vërtetë, një qenie e lig dhe e mbrapsht e cila lëviz gjithandej,” është përshkruar si dikush i cili do të shfaqet në Fundin e Kohës, burimi dhe përfaqësuesi i tërë ligësisë dhe fitnes. Dexhxhali mund të jetë në të vërtetë një qenie njerëzore; apo mund të jetë një sistem apo një ideologji që përfaqëson një mënyrë të të menduarit apo praktikës që është kundër vlerave morale. Shumë hadithe përmbajnë informacion të shumtë për dexhxhalin dhe disa ajete u referohen parimeve morale dhe sistemit të dexhxhalit. Paraqitja e dexhxhalit është lajmëruar si njëra prej shenjave të mëdha të Fundit të Kohës:

*Ebu Hurejra ka transmetuar: Ekzistojnë tri gjëra që, kur të shfaqen ato, nuk do t'i bëjnë kurrfarë dobie besimit të një personi i cili nuk ka besuar më parë: antikrishti, Bisha dhe Dielli që lind në perëndim. (Hadithet e el-Tirmidhiut; Muhammad ibn 'Abd al-Rasul Barzanji, Al-Isha'ah li Aashrat al-Sa'ah, f. 209)*




Dijetari dhe imami i madh Islamik, Ebu Hanife, pohon si vijon lidhur me hadithet që e përshkruajnë dexhhalin dhe shenjat tjera të Ditës së Fundit:

*Shfaqja e dexhhalit dhe e Jexhuxhëve dhe Mexhuxhëve është e vërtetë; lindja e Diellit në perëndim është e vërtetë; zbritja e Profetit Isa (as) nga qiejt është e vërtetë; dhe të gjitha shenjat tjera të Ditës së Fundit, që përfshihen në sunnetin e vërtetë, janë të vërteta të vërtetuarra. (Ebu Hanife, Nu'man ibn Sabit (150/767), el-Fikh el-Ekber)*

Hadithet e Profetit tonë (saas) përmbajnë po ashtu informacion të hollësishëm për karakteristikat e dexhhalit. Sipas tij, dexhhalit do t'i largojë njerëzit nga rruga e drejtë; do ta paraqes të mirën si të keqe dhe të keqen si të mirë; do t'i mashtrojë ata të cilët e pasojnë me mirësi të paqena dhe do t'i shtyp dhe do ta përdor forcën kundër atyre që nuk e pasojnë; do të shkaktojë ngatërrësë në botë dhe do të nxis konflikt; do t'iu kundërvihet vlerave morale fetare dhe do të punojë për t'i shmangur njerëzit nga ato vlera. Koha e dexhhalit në Tokë do të jetë një kohë kur besimtarët e sinqertë do të përballen me shumë telashe dhe vështirësi dhe kur shumica e njerëzve do t'ua kthejnë shpinën vlerave morale fetare.

Shfaqja e dexhhalit do të ketë një ndikim të thellë në tërë botën dhe do të jetë burimi i zhvillimeve që do të shkaktojnë shumë katastrofa dhe telashe mbi njerëzimin. Pasi që shënjestra kryesore e tij do të jenë vlerat morale fetare dhe besimtarët e vërtetë, periudha në fjalë mund të jetë veçanërisht e vështirë për besimtarët. Përveç kësaj, shumë njerëz do të besojnë në mashtrimet e tij dhe do ta pasojnë atë. Një gjendje e tillë duhet të kundërshtohet nga të gjithë njerëzit e ndërgjegjshëm dhe besimtarët. Për më tepër, ata do të duhet të nisin një luftë të fuqishme intelektuale kundër kësaj gjendje, në të cilën, me



vullnetin e All-llahut, ata do të ngadhënjëjnë. Megjithatë, Profeti (saas) zbuloi se ligësia e këtij individi do të jetë e një shkalle që nuk është parë kurrë më parë në histori dhe i paralajmëroi besimtarët që t'i shmangen atij. Ky paralajmërim është më se i rëndësishëm:

*Po ua them këto gjëra që të mund ta kuptoni situatën dhe të mos bini në kurthin e tij dhe që të mund t'iu tregoni atyre që do të vijnë pas jush, sepse ligësia e tij është ligësia më e keqe nga të gjitha. (Nu'aym ibn Mas'ud; Ismail Mutlu, Kiyamet Alametleri (Shenjat e Ditës së Fundit), Mutlu Publications, (Stamboll: 1999), 92-93)*

Kjo këshillë, si edhe lutja e tij për mbrojtjen e All-llahut nga fitneja e shkaktuar nga dexhxhali, është një udhërrëfyes për Muslimanët. Muslimanët nga sekte dhe raca të ndryshme e lusin All-llahun gjatë pesë namazeve të tyre ditore që t'i mbrojë ata nga e keqja e dexhxhalit. Siç zbulon ky hadith, lutja që Profeti ynë i dashur (saas) ua mësoj besimtarëve është si vijon:

*Ebu Hurejra ka transmetuar: I Dërguari i All-llahut (saas) ka thënë: Kur çdo njëri prej jush ta thotë teshehudin (në namaz) ai duhet të kërkoj strehim tek All-llahu nga katër (sprova) dhe si rrjedhojë duhet të thotë: "O All-llah! Unë kërkoj strehim tek Ti nga dënimi i Xhehenemit, nga dënimi i varrit, nga sprova e jetës dhe e vdekjes dhe nga e keqja e sprovës së Mesihu dexhxhalit." (Sahih Muslimi, Libri 4, Numër 1217)*

Fakti se Profeti (saas) ua mësoi këtë lutje pasuesve të tij personalisht dhe u rekomandoi që ta thonë gjatë lutjeve ditore tregon se sa e rëndësishme është çështja e dexhxhalit për besimtarët. Ne e dimë se pas lutjeve të tyre ditore, dijetarët Islamik shtuan edhe këto fjalë: "All-llahumme axhirni min fitne el-Messiah el-dexhxhal ue el-Sufjan" (O All-llahu im, na mbrojë nga sprovat e Mesihu dexhxhalit dhe të Sufjanit). Të vetëdijshëm



për peshën e madhe të sprovës së dexhshalit, Muslimanët kërkojnë mbrojtjen e All-llahut me këtë lutje në lutjet e tyre ditore. Kjo tregon se Muslimanët janë të përgatitur shpirtërisht për dexhhalin. Megjithatë, përgatitja më e rëndësishme që duhet bërë kundër dexhshalit është pikërisht ajo që duhet bërë për tu përgatitur për ardhjen e Profetit Isa (as).


Në një aspekt, ardhja e dytë e Profetit Isa (as) do ta provojë faktin se kjo lutje është dëgjuar. Kjo për arsye se hadithet tregojnë se sprova e dexhshalit mund të asgjësohet vetëm me kthimin në Tokë të Profetit Isa (as) dhe se kur dexhxhali ta shoh Profetin Isa (as), “ai do të tretet si kripa që tretet në ujë.” Disa prej haditheve që zbulojnë mënyrën se si Profeti Isa (as) do ta bëj dexhhalin të paefektshëm janë si vijon:

*... Ndërsa dexhxhali përhap të keqen nëpër botë, All-llahu do ta dërgojë Mesihun, Isain (as), të birin e Merjemes, i cili do ta takojë dexhhalin tek porta e Luddit [afër Jerusalemit] dhe do ta bëj atë të paefektshëm. (Sahih Muslimi)*

*... Ndërsa dexhxhali përhap të keqen nëpër botë, All-llahu do ta dërgojë Mesihun, Isain (as), të birin e Merjemes... Profeti Isa (as) do ta takojë dexhhalin tek porta e Luddit [afër Jerusalemit] dhe do ta bëj atë të paefektshëm. (Sahih Muslimi)*

*Kur armiku i All-llahut [dexhxhali] ta shoh atë [Profetin Isa (as)], do të tretet siç shkrinë kripa në ujë dhe edhe po të mos përballej [Profeti Isa (as)] fare me të, madje edhe atëherë ai do të tretej plotësisht. All-llahu do ta bëj atë të paefektshëm nga dora e Profetit Isa (as)... (Sahih Muslimi, 6924)*

*Profeti Isa (as) do të kthehet së shpejti dhe pastaj do ta asgjësojë [shpirtërisht] dexhhalin, të ligun, të mbrapshtin. (Nuzul-i Mesih Risalesi (Debati mbi ardhjen e dytë të Mesihut), Stamboll: Ekmel Publishing, 1998, f. 121)*



Prandaj, është një çështje e një rëndësie të madhe që të gjithë besimtarët dhe ata të cilët dëshirojnë të jenë të mbrojtur nga sprova e dexhxhalit duhet ta mbështesin plotësisht Profetin Isa (as) dhe të përpiqen për të përgatitur mjedisin më të mirë të mundshëm para se ai të kthehet vërtet.

Në njërën anë, Muslimanët duhet të zbulojnë ligësinë dhe mashtrimet e dexhxhalit dhe të fillojnë një luftë intelektuale kundër atyre elementeve që përbëjnë themelet ideologjike të sistemit të dexhxhalit. Nga ana tjetër, ata duhet të përgatitin themelin për luftën e madhe intelektuale që Profeti Isa (as) do ta fillojë pas kthimit të tij dhe duhet të përgatiten për ta mbështetur atë. Informacioni i dhënë në Kur'an dhe zhvillimet e përshkruara në hadithe tregojnë se një nga periudhat më të rëndësishme të historisë po afron.


Ata të cilët do ta kenë nderin të jetojnë në një periudhë të tillë historike duhet të ndiejnë një gëzim të madh për këtë të ardhme dhe duhet të jenë të vetëdijshëm për shkallën e përgjegjësisë së tyre. Një nga gjërat e para që këta njerëz duhet të bëjnë është që të përgatiten dhe t'i përgatitin njerëzit rreth tyre për kthimin e Profetit Isa (as).



# ARDHJA E DYTË NË TOKË E PROFETIT ISA (AS) NË RISALE EN-NUR

**N**ë përmbledhjen e tij Risale en-Nur, dijetari i madh Islamik, i cili konsiderohet si *muxheddid* (përtëritës) i shekullit të 13-të Islamik, Bediuzzaman Said Nursi bëri deklarata të rëndësishme për ardhjen e dytë në Tokë të Profetit Isa (as). Ai përshkroi, në dritën e ajeteve dhe haditheve, mënyrën se si do të kthehet në Tokë Profeti Isa (as) në Fundin e Kohës, se si do t’iu bëjë thirrje të krishterëve që t’iu përmbahen vlerave të besimit të vërtetë duke u liruar nga besimet dhe praktikat paragjykuese, se si të krishterët e vërtetë të cilët e pasojnë Profetin Isa (as) dhe Muslimanët do të bashkohen dhe se si, së bashku me Hazreti Mehdiun (as), Profeti Isa (as) do të jetë mjet që vlerat morale të Islamit ta sundojnë botën.


Megjithatë, këto deklarata të Bediuzamanit janë keqkuptuar dhe keqinterpretuar ndonjëherë. Në veçanti, gabimisht janë nxjerrë përfundime nga referencat e Bediuzamanit për “personalitetet kolektive” të Profetit Isa (as) dhe Hazreti Mehdiut (as) se personi i bekuar i Profetit Isa (as) nuk do të vijë fare. Por deklaratat e Bediuzamanit nuk nënkuptojnë një gjë të tillë. Siç është bërë e qartë në disa vende në Risale en-Nur, Bediuzamani ka thënë se Profeti Isa (as) do të kthehet personalisht në Tokë në Fundin e Kohës.



Me të vërtetë, një përkufizim i Profetit Isa (as) dhe Hazreti Mehdiut (as) si forca të padukshme, të tilla si subjekte shpirtërore, shpirtra apo kuptime, do të ishte në kundërshtim të plotë me ligjin e All-llahut të shpallur në ajetet e Kur'anit. Nuk ka ndodhur asnjëherë që të vijë ndonjë i dërguar apo profet në formën e një personaliteti kolektiv.

Në Kur'an ofrohet informacion i hollësishëm lidhur me jetët, luftërat dhe porositë e të dërguarve të dërguar në komunitete të ndryshme. Deri në fund të jetës së tyre ata u kanë bërë thirrje njerëzve tek të cilët u dërguan për në besimin e vërtetë, i kanë paralajmëruar ata për ndëshkimin e All-llahut dhe u kanë dhënë lajmin e mirë të Xhennetit besimtarëve. Ata reagues ndaj shtypjes, kurtheve dhe luftës kundër besimit të vërtetë nga ana e mohuesve në komunitetet e tyre me guxim dhe besim në All-llahun dhe u bënë thirrje atyre të jetojnë në një mënyrë që do të ishte e kënaqshme për Të. E gjithë kjo tregon se asnjë i dërguar nuk është dërguar asnjëherë si personalitet shpirtëror, por si individ.

Ky ligj i All-llahut që është zbatuar për qindra vjet vlen edhe për Profetin Isa (as) dhe Hazreti Mehdiun (as), siç ka vlejtur edhe për pjesën tjetër të historisë islame. Megjithatë, si të gjithë profetët dhe të dërguarit e tjerë, Profeti Isa (as) dhe Hazreti Mehdiu (as) do të kenë po ashtu personalitetet kolektive të tyre. Në Kur'an mësojmë se gjithmonë kanë ekzistuar komunitete të besimtarëve të bashkuara rreth të gjithë profetëve dhe të dërguarve dhe se ato kanë ndjekur rrugën e vërtetë që ata u kanë treguar. Të gjithë njerëzit të cilët kanë besuar në të dërguarit dhe të gjitha veprimet e kryera së bashku me të dërguarit përbëjnë personalitetet kolektive të këtyre të dërguarve.





Kjo mund të shihet qartë në historitë e profetëve në Kur'an. Për shembull, populli i Profetit tonë (saas) përfaqësonte personalitetin e tij kolektiv. Por ky u formua duke u bazuar në kushtin e ekzistencës së Profetit (saas). Kjo nuk do të ndryshojë në Fundin e Kohës. Siç ka thënë Bediuzamani, Profeti Isa (as) dhe Hazreti Mehdiu (as) do të ekzistojnë personalisht si udhëheqës të udhëzimit në krye të bashkësive të besimtarëve që i shoqërojnë ata.


Prandaj, duke e përdorur termin “personalitet kolektiv,” Bediuzaman Said Nursi e përdori atë në përputhje me ligjin e All-llahut të shpallur në Kur'an. Në të vërtetë, duke iu referuar studentëve dhe veprave të tij si një personalitet kolektiv, Bediuzaman Said Nursi ishte personalisht në krye të tij.

Personaliteti kolektiv i Risale en-Nur përfshin ata nxënës që e pasojnë atë si edhe veprat, por Bediuzamani, kreu i lëvizjes Nur, nuk mund të konsiderohet si i veçuar prej tij.

Kjo do të jetë më e kuptueshme me një shqyrtim të komenteve në Risale en-Nur lidhur me ardhjen e dytë të Profetit Isa (as):

**1. MUND TË JETË VETËM NJË PERSON I MREKULLUESHËM ME FUQINË E MREKULLIVE** i cili do të mund ta neutralizojë dhe ndryshojë rrugën e **DEXHXHALIT TË TMERRSHËM, I CILI DO TË MBROHET PËRMES MREKULLIVE QË ALL-LLAHU IA KA DHËNË PËR TA HUMBUR ATË, TË TILLA SI MAGJIA, FUQITË HIPNOTIZUESE DHE SPIRITUALIZMI DHE DO TA MAGJEPS ÇDO NJERI, DHE AI PERSON DO TË JETË PROFETI ISA (AS), i cili është profeti i shumicës së njerëzve... (Rrezet, “Rrezja e pestë”)**

Bediuzamani përshkruan mënyrën se si dexhxhali i cili do të shfaqet në Fundin e Kohës do të përpiqet t'i mashtrojë njerëzit duke përdorur fuqi të ndryshme të mbinatyrshme, por se ky



degjenerim do të eliminohet plotësisht me ardhjen e dytë të Profetit Isa (as):

*Dexhxhali i tmerrshëm, i cili do të mbrohet përmes mrekullive që All-llahu i ka dhënë për ta humbur atë, të tilla si magjia, fuqitë hipnotizuese dhe spiritualizmi dhe do ta magjeps çdo njeri:*


Bediuzamani shkruan, në dritën e haditheve të Profetit tonë (saas), se dexhxhali do të posedojë fuqi të ndryshme të mbinatyrshme.

Disa prej haditheve që tregojnë se dexhxhali do të bëj mrekulli të rrejshme janë si vijon:

*Një nga degjenerimet e tij është: Ai do t'i thotë një Beduini: "Më thuaj! A do të besosh se unë jam Zoti yt **NËSE DO T'I RINGJALL NËNËN DHE BABANË TËND?"** Beduini do të thotë: "Po." Në këtë **DY SHEJTANË DO TË SHFAQEN NË FORMËN E NËNËS DHE BABAIT TË TIJ...** (Sunan Ibn Maxhah, 4077)*

*Një nga degjenerimet e tij është: Ai do ta thërras një person të vetëm, **VRITENI DHE PRITENI ME SHARRË.** Trupi i atij personi do të ndahet në dy pjesë. Atëherë dexhxhali do t'iu thotë atyre përreth: "Shikoni këtë rob që e kam vrarë. **TANI UNË DO TA SJELLË ATË PËRSËRI NË JETË.**" ... (Sunan Ibn Maxhah, 4077)*

Ky hadith na tregon se dexhxhali do të përdor mrekulli të rrejshme që njerëzit ta pranojnë degjenerimin e tij. (All-llahu e di të vërtetën.) Njerëzit më pak të zgjuar mund të mendojnë se këto janë vërtetë "mrekulli." Megjithatë, e vërteta është se një mrekulli është bekim nga All-llahu për robërit e Tij të shenjtë. Dukuritë e jashtëzakonshme të shfaqura nga dexhxhali janë magji e qartë, me fjalë të tjera, janë mrekulli të rrejshme të krijuara nga All-llahu për t'i vënë njerëzit në sprovë dhe që të vërehen tek jobesimtarët.




Siç pohohet nga Bediuzamani, dexhxhali do të mashtrojë shumicën e njerëzve duke përdorur këto teknika mashtruese. Mrekullitë e rrejshme dhe mashtrimet e kryera nga ana e dexhxhalit, në një kohë kur e gjitha bota e Krishterë është duke e pritur kthimin në Tokë të Profetit Isa (as) dhe çifutët po e presin Hazreti Mesihun (as), mund të shkaktojë mashtrimin e shumë njerëzve nga dexhxhali. Në këtë fragment, Bediuzamani e vë në pah këtë veti të dexhxhalit dhe gjithashtu lë të kuptohet se ai nuk është një personalitet kolektiv. Bediuzamani e bën këtë plotësisht të qartë duke iu referuar mënyrës se si dexhxhali i mashtron njerëzit duke përdorur teknika të tilla mashtruese si hipnoza dhe shfaqjet e magjisë.

Nuk ka dyshim se do të ishte një gjë e gabuar që një njeri, i cili pranon se dexhxhali është një individ nën dritën e këtyre pohimeve të Bediuzamanit, të pohojë se Profeti Isa (as) dhe Hazreti Mehdiu (as) mund të jenë personalitete kolektive përkundër të gjitha provave dhe hollësive që jep Bediuzamani lidhur me këtë temë.

Nuk ka dyshim se në të gjitha pohimet e tij Bediuzamani, i cili kishte një nivel shumë të lartë të njohurive, shpалosi të vërtetën në mënyrën më të mirë për Muslimanët dhe ai tha, në një mënyrë që nuk lë hapësirë për dyshim, se “si dexhxhali, Profeti Isa (as) dhe Hazreti Mehdiu (as) të dy janë **INDIVIDË**.”

*Mund të jetë vetëm një person i mrekullueshëm me fuqinë e mrekullive... i cili është Profeti i shumicës së njerëzve*

Bediuzamani thotë se personi i cili do ta eliminojë degjenerimin e dexhxhalit do të jetë një “INDIVID” i bekuar i cili, nga mëshira e All-llahut, do të punojë mrekulli dhe të cilin e pasojnë shumica e madhe e njerëzve. Në pjesën tjetër të këtij fragmenti ai e identifikon këtë person si Profetin Isa (as). Kjo



është e shprehur në mënyrë aq të qartë sa nuk lë vend për asnjë interpretim tjetër.

*Bediuzamani pohon në mënyrë të qartë se “Profeti Isa (as) është NJË INDIVID.” Ky pohim i qartë hedh poshtë plotësisht çdo mendim se ai mund të jetë një personalitet kolektiv.*


Përveç kësaj, duke iu referuar **“NJË PERSONI TË MREKULLUESHËM ME FUQINË E MREKULLIVE... I CILI ËSHTË PROFETI I SHUMICËS SË NJERËZVE,”** Bediuzamani vë në pah disa karakteristika të rëndësishme që tregojnë se Profeti Isa (as) është një individ. Bediuzamani pohon se “Profeti Isa (as) është **NJË PERSON** i cili bën gjëra të mrekullueshme dhe të habitshme.” Përveç kësaj, ai sjell ndër mend se “Profeti Isa (as) është **NJË PERSON** në të cilin besojnë shumica e njerëzve.”

Bediuzamani, me diturinë e tij të lartë, e dinte shumë mirë se është e pamundshme që një personalitet kolektiv të bëjë mrekulli. Ai gjithashtu e dinte se një personalitet kolektiv nuk mund të jetë “një person në të cilin besojnë shumica e njerëzve.” Duke i përdorur këto veti që e përshkruajnë Profetin Isa (as) në një mënyrë shumë të qëllimshme, ai u jep të gjithë Muslimanëve lajmin e gëzuar se ai do të kthehet në Tokë si **“NJË PERSON.”**

### **Ai Person do të jetë Profeti Isa (as):**

Bediuzamani zbulon, siç na tregon Profeti (saas) në hadith, se Profeti Isa (as) do ta zhdukë fitnen (sprovën dhe fatkeqësinë) e dexhxhalit:

*Kur armiku i All-llahut [dexhxhali] do ta shoh atë [Profetin Isa (as)], DO TË ZHDUKET SIÇ SHKRINË KRIPA NË UJË dhe edhe po të mos përballej [Profeti Isa (as)] fare me të, madje edhe atëherë do të tretej plotësisht, por ALL-LLAHU DO TA BËJ ATË TË PAEFEK-TSHËM NGA DORA E TIJ [PROFETIT ISA (AS)]. (Sahih Mus-*



limi, Libri 41, Numër 6924)


**...NDËRSA DEXHXHALI PËRHAP DEGJENERIM, ALL-LAHU DO TA DËRGOJË MESIHUN, ISAIN (AS) BIRIN E MERJEMES...** Çdo jobesimtar i cili do ta ndiej erën e tij do të vdes dhe fryma e tij do të arrijë aq sa mund të shoh syri. Ai [Profeti Isa (as)] pastaj do ta kërkojë atë [dexhxhalin] derisa ta arrijë atë tek porta e Luddit dhe **DO TA BËJ TË PAEFEKTSHËM.** (Sahih Muslimi, Libri 41, Numër 7015)

...Pas kësaj, **PROFETI ISA (AS) DO TA NDJEKË DEXHXHALIN** dhe do ta zërë atë tek porta e Luddit afër Beit-ul-Makdisit, **DHE DO TA BËJ ATË TË PAEFEKTSHËM.** (Sahih Muslimi, vëll. 4/2251-2255; Imam Sharani)

Shprehja **“ATË PERSON”** e përdorur nga Bediuzamani e bën të qartë se Profeti Isa (as) është **“NJË INDIVID.”** Bediuzamani nuk u referohet **“dy apo tre individëve.”** Përkundrazi, ai i referohet gjithnjë Profetit Isa (as) në **“NJËJËS”** dhe si **“NJË INDIVID TË VETËM.”** Me këto pohime, Bediuzamani e ka bërë mjaft të qartë se Profeti Isa (as) nuk është një personalitet kolektiv, por **“NJË INDIVID I BEKUAR.”**

2. Në fakt, edhe **ZBRITJA E PROFETIT ISA (AS) dhe SE AI VET ËSHTË PROFETI ISA (AS), MUND TË DIHET VETËM PËRMES DRITËS SË BESIMIT; KËTË NUK DO TA DIJË ÇDO NJERI. Ngjashëm, FIGURAT E FRIKSHME SI DEXHXHALI DHE SUFJANI NUK E NJOHIN VETEN SI TË TILLË...** (Rrezet, Rrezja e Pestë)

Bediuzamani njofton se Profeti Isa (as) do të kthehet në Tokë në Fundin e Kohës, por se jo çdonjëri do ta njoh këtë personalitet të bekuar kur të vijë:



### **Zbritja e Profetit Isa (as):**

Duke iu referuar **“ZBRITJES SË PROFETIT ISA (AS)”** Bediuzamani përshkruan mënyrën se si Profeti Isa (as) do të kthehet në Tokë në formë njerëzore në Fundin e Kohës, si një mrekulli nga All-llahu. Përmes këtij informacioni, Bediuzamani qartë shpjegon se Profeti Isa (as) do të jetë **“NJË PERSON,”** jo një kuptim apo personalitet kolektiv, që do ta udhëheq bashkësinë e Krishterë drejt udhëzimit të vërtetë.


### **Se Ai Vet është Profeti Isa (as):**

Me këto fjalë, Bediuzamani thotë se kur Profeti Isa (as) kthehet së pari në Tokë ai nuk do ta dijë menjëherë se ai është Profeti Isa (as), por se këtë do ta kuptojë më vonë. Është e qartë se **“nuk mund të bëhet fjalë që një personalitet kolektiv të ketë ndërgjegje apo vetëdije të tillë.”** Konceptet e **“DITURISË”** dhe **“TË KUPTUARIT”** mund të vlejné vetëm për një **“QENIE NJERËZORE.”** Vetëm një person **“mund ta kuptojë se kush është,”** dhe ta kuptojë situatën në të cilën ndodhet. Si dikush që është shumë i vetëdijshëm për këtë, Bediuzamani përdor këto fjalë për të pohuar në mënyrë të qartë se Profeti Isa (as) nuk është një personalitet kolektiv.

Një nga elementet me të cilin Bediuzamani vërteton atë është fjala **“AI VETË.”** Kjo fjalë përsëri shpreh konceptin e **“INDIVIDIT”** dhe në këtë mënyrë, Bediuzamani deklaron sërish se **“Profeti Isa (as) do të vijë në formë fizike, si një INDIVID.”**

### **Ai mund të njihet vetëm përmes Dritës së Besimit; Këtë nuk do ta dijë çdo njeri:**

Bediuzamani tha se njerëzit përreth tij do ta njohin Profetin




Isa (as) të shumëpritur vetëm “PËRMES DRITËS SË BESIMIT.” Kjo përsëri tregon se Bediuzamani nuk është duke iu referuar Profetit Isa (as) si një personaliteti kolektiv. Bediuzamani i referohet qartë njohjes së tyre të “NJË INDIVIDU QË ATA JANË DUKE E PRITUR,” jo një personaliteti kolektiv. Bediuzamani thotë gjithashtu se “KËTË NUK DO TA DIJË ÇDO NJERI,” se Profetin Isa (as) nuk do ta njoh çdo njeri.

Siç thotë Bediuzamani, kur Profeti Isa (as) të kthehet në Tokë, besimtarët e vërtetë do ta njohin menjëherë këtë individ të bekuar përmes dritës së besimit të tyre dhe me lejen e All-llahut dhe do të jenë ndihmuesit dhe përkrahësit e tij.

### **Figurat e frikshme si dexhxhali dhe sufjani nuk kanë dijeni se janë të tillë:**

Me këto fjalë, Bediuzamani është duke thënë se individët e Fundit të Kohës, si dexhxhali dhe sufjani, të cilët do të nisin një fushatë të bazuar në mohim kundër Profetit Isa (as) dhe Hazreti Mehdiut (as) përsëri nuk do të njihen nga të gjithë. Bediuzamani përdori fjalën “FIGURA” në shprehjen “FIGURAT E FRIKSHME” për t’iu referuar dexhxhalit dhe sufjanit si “INDIVIDË.”

Në veprat e tij, Bediuzamani përdor fjalë të ngjashme që nënkuptojnë po ashtu “një person, individ” për t’iu referuar Profetit Isa (as) dhe Hazreti Mehdiut (as). Do të ishte një gjendje shumë kundërthënëse e gjërave që njeriu të pranonte se dexhxhali dhe sufjani do të paraqiten si individë por të mendonte se Profeti Isa (as) dhe Hazreti Mehdiu (as) do të jenë vetëm personalitete kolektive. Siç thotë Bediuzamani, ashtu si dexhxhali sufjan dhe mesihu dexhxhal që do të shfaqen si individë, Profeti Isa (as) dhe Hazreti Mehdiu (as) të cilët do t’i



asgjësojnë gjithë sprovat e tyre do të shfaqen po ashtu, me lejen e All-llahut, si individë të bekuar në Fundin e Kohës.

3. **“PROFETI ISA (AS) DO TË VIJË DHE DO TA FAL NAMAZIN E OBLIGUAR PAS HAZRETI MEHDIUT (AS) DHE DO TA PASOJË ATË,”** aludon në **KËTË BASHKIM DHE NË SOVRANITETIN E KUR’ANIT DHE PASIMIN E TIJ.** (Rrezet / Rrezja e pestë – Ndalesa e dytë – f. 109)

Profeti ynë (saas) zbulon në një hadith se si Profeti Isa (as) do të falet pas Hazreti Mehdiut (as):

*Kur Hazreti Mehdiu (as) është duke e falur namazin e sabahut me besimtarët në Beit el-Makdis, ai do ta njoh Profetin Isa (as) i cili është shfaqur dhe Profeti Isa (as) do t’i vendos duart e tij në shpatullën e tij dhe do të thotë: “Thirrja për këtë namaz është bërë për ty, prandaj ti duhet ta udhëheqësh atë”... (Al-Qaul Al-Mukhtasar Fi alamat Al-Mahdi Al-Muntazar, f. 25)*

Bediuzamani përmend këtë hadith të Profetit tonë (saas) dhe rikujton se si kjo ngjarje është një nga shenjat më të mëdha të ardhjes së Profetit Isa (as) dhe Hazreti Mehdiut (as).

Bediuzamani thekson gjithashtu se, me lejen e All-llahut, morali islamik do ta sundojë gjithë botën në kohën e Profetit Isa (as) dhe të Hazreti Mehdiut (as). Lufta e madhe intelektuale që do të zhvillohet nga Profeti Isa (as) dhe Hazreti Mehdiu (as) në aleancë do të jetë në dobi të kësaj, thotë ai.

**Profeti Isa (as) do të vijë dhe do ta fal namazin e obliguar pas Hazreti Mehdiut (as) dhe do ta pasojë atë:**

Në këtë fragment, Bediuzamani thotë, në dritën e haditheve





të vërteta të Profetit tonë (saas), se “PROFETI ISA (AS) DO TË FALET SË BASHKU ME HAZRETI MEHDIUN (AS).” Zoti ynë ka bërë faljen një obligim fetar. Është e pamundur për personalitetet kolektive të falen së bashku apo të shërbejnë si imam. Bediuzamani ishte padyshim i vetëdijshëm për këtë dhe thotë, nëpërmjet fjalëve të tij, se Profeti Isa (as) dhe Hazreti Mehdiu (as) do të shfaqen si “INDIVIDË.”

Kur të paraqitet Profeti Isa (as), me lejen e All-llahut, ai do të vazhdojë të fal namazin ashtu siç kishte vepruar edhe gjatë ardhjes së tij të parë. Kjo është shpallur si vijon në Kur’an:

**Ai (Isai në djep) tha: “Unë jam rob i Allahut. Ai më ka dhënë Librin (Ungjillin), më ka bërë profet dhe më ka bërë të bekuar kudo që të jem. AI MË KA POROSITUR QË TË FALEM E TË JAP ZEQAT SA TË JEM GJALLË.”**  
(Surja Merjem: 30-31)

Profeti Isa (as) dhe Hazreti Mehdiu (as) do të shfaqen si individë të bekuar në Fundin e Kohës. Profeti Isa (as) do të falet pas Hazreti Mehdiut (as) dhe vlerat morale Islamike do të sundojnë në botë si rezultat i luftës së madhe intelektuale që këto dy personalitete të bekuara do ta zhvillojnë.

Bediuzamani rikujton këtë çështje, e cila shfaqet në një numër shumë të madh të haditheve të vërteta dhe vazhdon dhe thotë se Profeti Isa (as) dhe Hazreti Mehdiu (as) do të kenë një bashkëbisedim të ndërsjellë kur të vijnë. Për këtë arsye, është thelbësore që këta dy individë të bekuar të shfaqen në të njëjtën kohë dhe të bashkohen. E gjithë bota islamike është duke pritur që Profeti Isa (as) të vijë dhe të fal namazin së bashku me Hazreti Mehdiun (as).

**4. Është një aludim dhe shenjë se PËR NGA NUMRI BASHKËSIA SHPIRTËRORE E ATYRE QË LUFTOJNË NË RRUGËN E**



**ALL-LLAHUT QË DO TA NJOH PROFETIN ISA (AS) NËPËRMJET DRITËS SË BESIMIT DHE DO TA PASOJË ATË DO TË JETË SHUMË E PAKËT NË NUMËR** *krahasuar me ushtritë shkencore, fizike të dexhahalit. (Rrezet / Rrezja e pestë – Ndalesa e dytë – f. 111)*

Në këtë fragment, Bediuzamani përshkruan tiparet e bashkësisë që do ta njoh dhe do ta përkrah Profetin Isa (as) kur ai të kthehet:


### **Kush do ta njoh Profetin Isa (as) përmes Dritës së Besimit:**

Në këtë fragment Bediuzamani i referohet përsëri njohjes së Profetit Isa (as) “PËRMES DRITËS SË BESIMIT” nga bashkësia që e mbështet atë dhe e bën të qartë se Profeti Isa (as) është “NJË INDIVID.” Folja “NJOH” sugjeron se “ekziston dikush që duhet njohur” dhe përsëri tregon se Bediuzamani është duke iu referuar Profetit Isa (as) si një individ, e jo një personaliteti kolektiv.

Përveç kësaj, me këto fjalë Bediuzamani e bën të qartë po ashtu se Profeti Isa (as) dhe personaliteti i tij kolektiv janë koncepte të ndryshme. Kjo për arsye se ai flet për një “komunitet që e njeh Profetin Isa (as)” dhe për “Profetin Isa (as) që njihet nga ai komunitet.” Nuk bëhet fare fjalë këtu për një personalitet kolektiv që njeh një tjetër personalitet kolektiv apo për të qenit i njohur nga një i tillë.

### **Dhe (kush) e pason atë:**

Bediuzamani i referohet këtu ekzistencës së një komuniteti që e “PASON” Profetin Isa (as). Natyrisht se është e pamundur



për një personalitet kolektiv ta pasojë një personalitet tjetër kolektiv, sepse vetëm një individ mund të pasohet, e jo një personalitet kolektiv. Bediuzamani e shpreh këtë realitet këtu dhe na rikujton se Profeti Isa (as) do të jetë “NJË INDIVID” në krye të një komuniteti që e pason atë dhe mënyra se si ai u tregon atyre, me fjalë të tjera, personalitetin kolektiv të tij.


Është një nder i madh i dëshiruar nga të gjithë Muslimanët të jetojnë në të njëjtën kohë si edhe Profeti Isa (as), ta pasojnë këtë individ të bekuar dhe të jenë ndihmësit e tij në rrugën e All-llahut, ashtu si dishepujt e tij. Siç thuhet në hadith dhe nga Bediuzamani, All-llahu do t’ia lejojë Hazreti Mehdiut (as) dhe njerëzve rreth tij të qëndrojnë në radhët e njëjta gjatë luftës intelektuale si edhe Profeti Isa (as) dhe ata pak besimtarë që e pasojnë atë.

Në veprat e tij, Bediuzamani thotë se kjo luftë intelektuale për të vërtetën do të ndodhë menjëherë pas kohës së tij, pra ardhja e Profetit Isa (as) dhe Hazreti Mehdiut (as) nuk ka ndodhur akoma në kohën e tij.

### **Bashkësia shpirtërore e atyre që luftojnë në Rrugën e All-llahut:**

Në këtë fragment, Bediuzamani i referohet një bashkësie të përbërë nga njerëz të cilët e mbështesin dhe besojnë Profetin Isa (as) dhe të cilët e pasojnë rrugën të cilën ai ua tregon.

Kjo bashkësi përfaqëson personalitetin kolektiv të Profetit Isa (as). Por ajo gjithashtu do ta ketë Profetin Isa (as) personalisht si udhëheqësin e saj, një individ i cili e përfaqëson këtë personalitet kolektiv. Bediuzamani thekson këtu se personi i Profetit Isa (as) dhe personaliteti kolektiv i tij janë dy koncepte të ndryshme.



Të kuptuarit e natyrës së lartë shpirtërore të Profetit Isa (as) është diçka që do t'iu dhurohet vetëm atyre të cilët posedojnë natyrë shpirtërore për ta dalluar këtë individ të bekuar. Bediuzamani e përshkruan këtë komunitet si “bashkësia shpirtërore e atyre që luftojnë në rrugën e All-llahut.” Siç thotë Bediuzamani gjithashtu, ky komunitet do të gëzojë një nivel të lartë shpirtëror dhe do të luftojë dhe do të zhvillojë një luftë të vazhdueshme intelektuale në rrugën e All-llahut.


### **Për nga numri... shumë të pakët në numër:**

Bediuzamani njofton se komuniteti i kryesuar nga Profeti Isa (as) do të jetë shumë i paktë në numër dhe i vogël në krahasim me shoqërinë e mohuesve të All-llahut. All-llahu i Plotfuqishëm ka shpallur në Kur'an: “... **Sa herë, me ndihmën e All-llahut, një ushtri e vogël ka ngadhënjyer mbi një ushtri të madhe.**” (Surja Bekare: 249)

Besimtarët e vërtetë të cilët, megjithëse të paktë në numër, që janë besnik ndaj Profetit Isa (sa) dhe Hazreti Mehdiut (as) në Fundin e Kohës do të jenë ngadhënjimtarë, me lejen e All-llahut, dhe do ta zhdukin krejtësisht *fitnen* e dexhshalit. Me këto fjalë, Bediuzamani i referohet edhe një herë komunitetit të përfaqësuar nga Profeti Isa (as) personalisht dhe përshkruan karakteristikat e saj.

Megjithatë, siç u sqarua më lart, është personi i Profetit Isa (as) që do ta udhëheq këtë komunitet. Bediuzamani në këtë mënyrë e bën të qartë se Profeti Isa (as) është “**NJË INDIVID**” në krye të personalitetit kolektiv që ai përfaqëson, jo një personalitet kolektiv vetë.

5. Tregohet se “ai do të jetë aq i fuqishëm dhe jetëgjatë sa që **VETËM**



*ISAI (AS) DO TË MUND TA SHKATËRROJË ATË; ASKUSH TJETËR NUK MUND TA BËJË KËTË.*” *Domethënë, DO TË JETË VETËM NJË FE HYJNORE, E LARTËSUAR, E PASTËR QË DO TË MUND TA PËRMBYS RRUGËN DHE REGJIMIN E TIJ TË PANGOPUR DHE T’I ELIMINOJË ATO. NJË FE E TILLË DO TË SHFAQET NË MESIN E PASUESVE TË VËRTETË TË PROFETIT ISA (AS) DHE DO TA PASOJË TË VËRTETËN E KUR’ANIT DHE DO TË BASHKOHET ME TË. ME ZBRITJEN E PROFETIT ISA (AS), PUSHTIMI I PAFE [I DEXHXHALIT] DO TË ZHDUKET DHE DO TË MARR FUND ... (Rrezet / Rrezja e pestë - f.102)*


Në këtë fragment Bediuzamani i referohet një hadithi që vë në dukje se vetëm Profeti Isa (as) do të jetë në gjendje që ta neutralizoj fitnen e dexhxhalit.

Ai thotë se njerëzit që do ta eliminojnë rendin e dexhxhalit të bazuar në mohim dhe regjimin e tij dhe misionin e tij agresiv, i përshkruar si “përhapje e mosbesimit dhe dëmtim i çështjeve të shenjta,” do të jetë Profeti Isa (sa) dhe të Krishterët e sinqertë që e pasojnë atë. Me ardhjen e tij të dytë, Profeti Isa (as) do ta eliminojë dhe neutralizojë këtë mision të pafe të dexhxhalit:

### **Vetëm Profeti Isa (as) do të mund ta shkatërroj atë; Askush tjetër nuk mund ta bëj këtë:**

Këtu Bediuzamani thotë, në dritën e haditheve të Profetit tonë (saas), se vetëm Profeti Isa (as) mund ta neutralizoj në rrafshin intelektual dexhxhalin dhe ta lirojë botën nga sprova e tij.

Përdorimi i fjalës “ATË” këtu nga ana e Bediuzamanit do të thotë se dexhxhali është “NJË INDIVID.” Sipas mendimit të




Bediuzamanit, është “INDIVID I PROFETIT ISA (AS)” i cili do t’iu japë fund përpjekjeve të këtij individ për të përhapur mohimin. Fjalët e Bediuzamanit janë mjaft të qarta dhe për të miratuar idenë e dexhxhalit si një individ por të Profetit Isa (sa) si një entitet kolektiv pa dyshim se bie në kundërshtim me informacionin e dhënë nga Bediuzamani. Bediuzamani ka deklaruar qartë se Profeti Isa (as) është i vetmi individ i aftë për ta neutralizuar dexhxhalin dhe u ka dhënë të gjithë besimtarëve lajmin e gëzuar të kthimit në Tokë të këtij individ të denjë.

**Që do të jetë në gjendje të përmbys rrugën e tij dhe regjimin e pangopur të tij dhe t’i asgjësojë ato:**

Bediuzamani vëren se prova e dexhxhalit do të çojë drejt një korrupsioni të tmerrshëm në mbarë botën. Ai njofton gjithashtu se kjo *sprovë* do të eliminohet tërësisht me anë të Profetit Isa (as).

Bediuzamani thotë se misioni i dexhxhalit është për të përhapur mosbesim në mbarë botën dhe për të shkaktuar fatkeqësi që burojnë nga mosbesimi. Ai gjithashtu sjellë lajmin e gëzuar se kur Profeti Isa (as) të kthehet në tokë, ai do t’i ndalojë fatkeqësitë dhe të këqijat e shkaktuara nga dexhxhali, do ta neutralizojë misionin e tij dhe do të bëjë që vlerat morale të Islamit të mbizotërojnë mbarë botën.

Në këtë ekstrakt Bediuzamani përsërit se Profeti Isa (as) do të kthehet si “NJË QENIE NJERËZORE” në ekzistencë fizike. Përdorimi i fjalës “TIJ” edhe një herë thekson se dexhxhali është po ashtu një individ, dhe se ky individ do të neutralizohet nga Profeti Isa (as), një tjetër “INDIVID.”



**Një fe hyjnore, e lartësuar, e pastër... do të shfaqet në mesin e pasuesve të vërtetë të Profetit Isa (as) dhe do ta pasojë të vërtetën e Kur'anit dhe do të bëhet një me të:**


Profeti Isa (as) është një i dërguar i bekuar i All-llahut. Ashtu si të gjithë profetët, ai u bëri thirrje njerëzve për të besuar në All-llahun, Një dhe të Vetëm, dhe për të jetuar sipas moralit fetar të urdhëruar nga All-llahu.

Megjithatë, pas pranimit të Profetit Isa (as) në praninë e All-llahut, besimi i Krishterë u shtrembërua dhe të Krishterët ia kthyen shpinën besimit të vërtetë të predikuar nga Profeti Isa (as). Kur të kthehet Profeti Isa (as) do ta pastrojë Krishterimin prej atyre elementeve që janë korruptuar dhe do ta kthejë atë në formën e tij të një besimi të vërtetë. Bediuzamani gjithashtu vë në dukje këtë fakt me fjalët "NJË FE E PASTËR ... DO TË SHFAQET NË MESIN E PASUESVE TË VËRTETË TË PROFETIT ISA (AS)."

Bediuzamani thekson se Krishterimi do të bashkohet me Islamit në pasimin e Kur'anit dhe na kujton se të gjitha këto zhvillime janë shenjat e ardhjes së dytë të Profetit Isa (as). Këto zhvillime të përshkruara nga Bediuzamani nuk kanë ndodhur ende. Bediuzamani ka përmendur këtë në kohën në të cilën ka jetuar dhe ka sjellë lajmin e mirë të ardhjes së Profetit Isa (as) në një datë të mëvonshme, duke theksuar se as ardhja e Profetit Isa (sa), dhe as ajo e Hazreti Mehdiut (as), i cili do të jetë i bashkëkohës i tij, nuk kishin ndodhur ende në kohën e tij.

**Me zbritjen e Profetit Isa (as), pushtimi i pafe [i dexhhalit] do të zhduket dhe do të marr fund:**

Bazuar në informatat e dhëna në ajetet e Kur'anit dhe në



hadithe, Bediuzamani deklaroi se Profeti Isa (as) do të vijë në Tokë për herë të dytë. Përdorimi nga Bediuzamani i fjalës që ka kuptimin e “ZBRITJES” do të thotë se ai është duke iu referuar Profetit Isa (sa) si “NJË INDIVID” i cili do të kthehet në Tokë për herë të dytë në formë e tij trupore njerëzore si një mrekulli e All-llahut, dhe jo si “NJË KUPTIM, FRYMË APO ENTITET PËRFAQËSUES.”

Bediuzamani është duke thënë se përpjekjeve të bazuara në mohim të dëxhxhalit do t’u vijë fundi pas “ZBRITJES”, apo thënë ndryshe **“ARDHJES NË TOKË TË PROFETIT ISA (AS), SI NJË INDIVID.”**


*6. Po, në fjalët e hadithit, ZBRITJA E PROFETIT ISA (AS) PREJ QIEJVE ËSHTË E SIGURT. Përveç fakteve të tjera që përcjellë me kuptimin e saj dëshmuës, ajo gjithashtu e dëshmon këtë fakt në mënyrë të mrekullueshme. (Shtojca Kastamonu, f. 50)*

Bediuzamani thotë se është e sigurt se Profeti Isa (as) do të kthehet në Tokë në Fundin e Kohës:

### **Zbritja e Profetit Isa (as) prej qiejve është e sigurt:**

Kthimi në Tokë në Fundin e Kohës i Profetit Isa (as) është një fakt që është shpallur në Kur’an dhe në hadithe. Bediuzamani thekson gjithashtu këtë fakt, duke thënë se hadithet i referohen qartë ardhjes së dytë të Profetit Isa (as). Këto janë lajme shumë të vlefshme për besimtarët e vërtetë. Me lejen e All-llahut, besimtarët që jetojnë në Fundin e Kohës do të jenë dëshmitarë të kësaj mrekullie dhe do ta shohin kthimin në Tokë të Profetit Isa (as), pas një periudhe prej 2000 vjetësh.

Bediuzamani përdor fjalën **“E SIGURT,”** dhe thotë se ardhja e dytë e Profetit Isa (as) është **“E SIGURT.”** Ky njoftim, të





cilin e jap Bediuzamani bazuar në hadithet e Profetit tonë (saas), i zhvlerëson të gjitha idetë tjera të kundërta.

**7. ... DUKE E PËRFAQËSUAR PERSONALITETIN KOLEKTIV TË KRISHTERIMIT, PROFETI ISA (AS) DO TA ELIMINOJË DEXHXHALIN, I CILI PËRFAQËSON PERSONALITETIN KOLEKTIV TË MOSBESIMIT ... (Letrat / Letra e Parë - f.23)**


Në këtë fragment Bediuzamani thotë se Profeti Isa (as) do të kthehet në Tokë dhe intelektualisht do ta neutralizojë fitnen e dexhxhalit:

### **Duke përfaqësuar personalitetin kolektiv të Krishterimit, Profeti Isa (as):**

Bediuzaman këtu thotë se Profeti Isa (as) “PËRFAQËSON PERSONALITETIN KOLEKTIV TË KRISHTËRIMIT.” Bediuzamani deklaron se, si të gjithë profetët dhe të dërguarit që kanë ekzistuar ndonjëherë, Profeti Isa (as) do të ketë një personalitet kolektiv të përbërë nga njerëz të cilët e mbështesin, besojnë në të dhe e pasojnë atë.

Megjithatë, duke iu referuar “PËRFAQËSIMIT TË PERSONALITETIT KOLEKTIV TË KRISHTËRIMIT,” Bediuzamani është duke thënë se, në pajtim me ligjin e Allahut, “PROFETI ISA (AS) DO TË JETË PERSONALISHT I PRANISHËM SI UDHËHEQËS DREJT UDHËZIMIT NË KRYE TË KËTIJ PERSONALITETI KOLEKTIV. “

Është e pamundur për një personalitet kolektiv që ta përfaqësojë një tjetër personalitet kolektiv. Për të pasur një personalitet kolektiv duhet të ekzistojë “NJË PERSON” në krye të tij. Duke theksuar këtë fakt, Bediuzamani deklaron se Profeti Isa (as) nuk është një personalitet kolektiv, por se ai personalisht do të jetë në krye të tij dhe do ta udhëheq personalitetin e tij



kolektiv.

Këto fakte të raportuara nga Bediuzamani mund të kuptohen më qartë kur bëjmë një apo dy pyetje:

1 - Një person përfaqëson personalitetin kolektiv të Krishterimit. Kush është ai person? Profeti Isa (as).

2 - Kë përfaqëson Profeti Isa (as)?

Personalitetin kolektiv të Krishterimit.


Përgjigjet në këto pyetje tregojnë në mënyrë të qartë se Bediuzamani i referohet Profetit Isa (as) dhe personalitetit të tij kolektiv, si dy koncepte të ndara.

### **Dexhkhali, i cili përfaqëson personalitetin kolektiv të mosbesimit:**

Bediuzamani thotë se, sikurse Profeti Isa (as), dexhkhali do të ketë një personalitet kolektiv. Megjithatë, me fjalët “DEXHXHALI, I CILI PËRFAQËSON PERSONALITETIN KOLEKTIV TË MOSBESIMIT,” Bediuzaman është duke thënë se dexhkhali po ashtu do të “**JETË PERSONALISHT NË KRYE TË KËTIJ PERSONALITETI KOLEKTIV SI NJË INDIVID.**”

Në veprat e tij, Bediuzamani thotë se, mbështetur në prova të ndryshme, që të gjithë emrat që përmenden nga Profeti ynë (saas) se do të vijnë në Fundin e Kohës janë individë. Dexhkhali është një nga këta individë të Fundit të Kohës. Bediuzaman ka dhënë po aq hollësi në lidhje me Profetin Isa (as) dhe Hazreti Mehdiun (as) për qenien e tyre individë sa ka dhënë për dexhkhalin që po ashtu është njëri prej tyre.

Me siguri do të ishte gabim që të keqkuptohen disa prej këtyre deklaratave të Bediuzamanit në mënyrë të tillë për të ardhur në përfundim se ndërsa dexhkhali është një individ, Profeti Isa (as) dhe Hazreti Mehdiu (as) janë personalitete



kolektive. Kjo për arsye se Bediuzamani ka përsëritur vazhdimisht se, si dexhxhali, “Profeti Isa (as) dhe Hazreti Mehdiu (as) do të vijnë SI INDIVIDË” dhe ka dhënë prova për ta konfirmuar këtë.


8. ...Megjithëse të mundur përballë rrymës së pafe ndërsa janë të ndarë, Krishterimi dhe Islami do të kenë aftësinë për ta mposhtur dhe shpartalluar atë si rezultat i bashkimit të tyre. Pastaj **PERSONI I PROFETIT ISA (AS), I CILI ËSHTË I PRANISHËM ME TRUPIN E TIJ NJERËZOR NË BOTËN E QIEJVE, DO TË VIJË PËR TA UDHËHEQUR RRYMËN E FESË SË VËRTETË**, siç ka premtuar Ai që ka Pushtet Mbi Çdo Gjë, Sjellësi i Lajmeve të Sigurta. Pasi që Ai e ka thënë këtë, ajo është e vërtetë, dhe pasi që **AI QË KA PUSHTET MBI ÇDO GJË E KA PREMTUAR ATË, AI PA DYSHIM DO TA BËJË KËTË REALITET...** (Letrat / Letra e pesëmbëdhjetë - f.80)

Bediuzamani thotë se si rezultat i kthimit të Krishterëve kah Kur’ani dhe pasimit të Islamit, dhe shkrirjes së dy besimeve, ata do të bëhen më të fortë dhe më të fuqishëm për t’i eliminuar filozofitë e pafe.

Gjatë kësaj kohe, Profeti Isa (as) do të kthehet në Tokë dhe do ta marrë udhëheqjen e kësaj force. Bediuzamani thotë se Profeti (saas) ka dhënë këtë informacion bazuar në premtimin e All-llahut, dhe na kujton se All-llahu patjetër që e mban fjalën e Tij:

### **Kush është i pranishëm me trupin e tij njerëzor në Botën e Qiejve:**

Në këtë fragment, Bediuzamani thotë se Krishterimi së shpejti do të restaurohet në formën e vet origjinale, duke qenë i



lirë nga besime të ndryshme dhe praktikat që iu kanë shtuar më pas dhe do të pasojë Kur'anin. Të Krishterët që u kthyen në Islam pastaj do t'i bashkojnë forcat me Muslimanët dhe do të zhvillojnë një luftë të përbashkët intelektuale kundër mosbesimit.

Me fjalët **“I PRANISHËM ME TRUPIN E TIJ NJERËZOR NË BOTËN E QIEJVE”** Bediuzamani thotë se Profeti Isa (as), i cili është në qiej në trupin e tij njerëzor, do të kthehet në Tokë dhe do ta marr udhëheqjen e kësaj lufte. Bediuzamani është duke thënë se Profeti Isa (as) do të kthehet në formën njerëzore, si një person i bekuar, **“NJË INDIVID.”**


Bediuzamani përdor fjalën **“NJERËZOR,”** duke deklaruar kështu në mënyrë eksplicite se Profeti Isa (as) nuk është një personalitet kolektiv, por **“një individ me ekzistencë materiale.”**

### **Personi i Profetit Isa (as):**

Termi **“PERSONI I PROFETIT ISA (AS)”** i përdorur këtu nga Bediuzamani i referohet Profetit Isa (as) si një individ. Prandaj është e qartë nga fjalët e Bediuzamanit se Profeti Isa (as) **“nuk është një personalitet kolektiv.”**

Profeti Isa (as) do të kthehet në Tokë në Fundin e Kohës si një individ, do ta eliminojë fitnen e dexhxhalit dhe do të punojë së bashku me Hazreti Mehdiun (as). Profeti Isa (as) dhe Hazreti Mehdiu (as) do të jenë mjet që vlerat morale Islamike të mbizotërojnë në botë.

Këto lajme madhështore të Fundit të Kohës ende nuk janë bërë realitet, dhe bota Islamike është duke pritur që të ndodhin këto zhvillime të bekuara. Terminologjia e Bediuzamanit e zbulon gabimin në pretendimin se Hazreti Mehdiu (as) ishte shfaqur në një periudhë të mëhershme. Kjo për arsye se ardhja e



Profetit Isa (as) dhe aleanca e tij me Hazreti Mehdiun (as) nuk kanë ndodhur ende, dhe *fitneja* e dexhxhalit nuk është eliminuar plotësisht.


Nuk ka dyshim se zhvillime të tilla gjithëpërfshirëse do të jenë e dukshme për sytë e tërë botës. Ky ndryshim i madh, për të cilin të gjithë do të jenë të vetëdijshëm dhe do ta përjetojnë duke iu falënderuar mjeteve të informimit, nuk ka ndodhur kurrë në kohën e Bediuzamanit apo çfarëdo kohe tjetër.

### **Do të vijë për ta udhëhequr rrymën e fesë së vërtetë:**

Fjalët e Bediuzamanit “AI DO TË VIJË PËR TA UDHËHEQUR RRYMËN E FESË SË VËRTETË,” tregojnë se Profeti Isa (as) do të jetë udhëheqësi i të Krishterëve të vërtetë, kur të kthehet në Tokë. Me ardhjen e tij, Krishterimi do të pastrohet nga bindjet dhe shpalljet e tij të rrejshme dhe do ta pasojnë Kur’anin.

Të gjitha këto zhvillime në lidhje me Profetin Isa (as) të numëruara nga Bediuzamani do të ndodhin në të njëjtën kohë që do të paraqitet Hazreti Mehdiu (as). Megjithatë, as ardhja e dytë të Profetit Isa (as) dhe marrja nga ana e tij e udhëheqjes së gjithë të Krishterëve, e as pastrimi i besimit të tyre prej të gjitha besimeve dhe praktikave të rrejshme nga të Krishterët nuk kanë ndodhur ende.

Ende nuk ka ndodhur as aleanca e Profetit Isa (as) dhe Hazreti Mehdiut (as). Prandaj, me gjithë këtë informacion Bediuzamani e kumton në mënyrë të qartë lajmin e mirëpritur që Hazreti Mehdiu (as) nuk kishte ardhur në një periudhë të mëhershme dhe se të gjitha këto zhvillime të pritura ishin shenja të qarta të shfaqjes së tij.



**Ai që ka pushtet mbi çdo gjë e ka premtuar këtë, Ai pa dyshim do ta bëjë këtë realitet:**

Bediuzamani shkruan se ndodhja e këtyre dukurive të bekuara është një premtim i bërë nga All-llahu I Gjithëfuqishëm. Në Kur'an, All-llahu u tregon të gjithë besimtarëve për dominimin e moralit Islamik në mbarë botën.

Ky premtim i All-llahut është shpallur si më poshtë në një ajet:

**Allahu u ka premtuar atyre prej jush, që besojnë dhe që bëjnë vepra të mira, se do t'i bëjë mëkëmbës në Tokë<sup>224</sup>, ashtu si i ka bërë ata para tyre dhe që do t'ua forcojë fenë e tyre, me të cilën Ai është i kënaqur dhe që frikën do t'ua shndërrojë në siguri. Le të më adhurojnë Mua e të mos Më shoqërojnë asgjë (në adhurim). Sa për ata që, pas kësaj, mohojnë (besimin), pikërisht ata janë të mbrapshtët.**(Surja Nur: 55)


Fakti se All-llahu me siguri do ta vë në vend premtimin e Tij është shpallur si vijon në Kur'an:

**(Ky është) premtimi i Allahut, e Allahu nuk e thyen premtimin e vet, por shumica e njerëzve nuk e dinë. (Surja Rum: 6)**

**O Zoti ynë! Ti do t'i mbledhësh njerëzit në një Ditë për të cilën nuk ka dyshim. Me të vërtetë, Allahu nuk e shkel premtimin". (Surja Al 'Imran: 9)**

**...Nuk ka dyshim se Allahu e kryen premtimin e Tij. (Surja Rra'd: 31)**

Këto premtime të gëzueshme të bëra nga All-llahu në ajetet e Kur'anit do të mbahen, insha'All-llah. Bediuzamani përdor një term shumë të sigurt, bazuar në këtë informacion të Kur'anit dhe




na kujton se, me lejen e All-llahut, këto dukuri “pa dyshim do të ndodhin” në Fundin e Kohës.

Zhvillimet e përshkruara në hadithet e Profetit tonë (saas) dhe në këto fragmente nga Bediuzamani deri tani nuk kanë ndodhur. Në të vërtetë, Bediuzamani thotë: “**AI DO TË**” dhe kështu është duke iu referuar një ngjarje në të ardhmen, dhe jo një ngjarje “që ka ndodhë apo është duke ndodhur.”

Profeti Isa (as) ende nuk ka ardhur në Tokë për herë të dytë. E gjithë bota Muslimane dhe e Krishterë janë duke e pritur ardhjen e dytë të këtij individ të bekuar. As aleanca e tij me Hazreti Mehdiun (as) ende nuk ka ndodhur. Bediuzamani e përkujton këtë fakt në këto fragmente, dhe thotë se Profeti Isa (as) dhe Hazreti Mehdiu (as) do të vijnë “**NË NJË KOHË TË MËVONSHME**” se ajo e tij.

**9. Në të vërtetë, NUK ËSHTË LARG URTËSISË SË NJË TË URTIT LAVDILOTIT I CILI GJATË GJITHË KOHËS DËR-GON ENGJËJT PREJ QIEJVE NË TOKË, nganjëherë në formën e njeriut (si Xhibrilin (as) që paraqitet në formën e Dihjas), dhe dërgon qenie shpirtërore nga Bota Shpirtërore duke bërë që ato të shfaqen në formë të njeriut, dhe madje dërgon shpirtrat e shumicës së shenjtorëve të vdekur në botë me ngjashmëri me trupat e tyre, TË VESHË PROFETIN ISA (AS) NË TRUPIN E TIJ DHE TA DËRGOJ ATË NË BOTË, NË MËNYRË QË TË SJELLË FENË E PROFETIT ISA (AS) NË NJË PËRFUNDIM TË MIRË, PËR NJË PËRFUNDIM AQ TË RËNDËSISHËM, - MADJE EDHE PO TË MOS ISHTE AI I GJALLË DHE I PRANISHËM ME TRUP NË BOTËN QIELLORE, EDHE PO TË KISHTE VDEKUR ME TË VËRTETË DHE TË ISHTE LARGUAR PËR NË CEPIN MË TË LARGËT TË JETËS SË PËRTEJME. Me të vërtetë AI E KA PREMTUAR KËTË, sepse urtësia e Tij kërkoi të jetë kështu,**



*dhe PASI QË AI E KA BËRË KËTË PREMTIM, AI PATJETËR DO TA DËRGOJË ATË. (Letrat / Letra e pesëmbëdhjetë - f.80)*

Bediuzzaman edhe një herë thekson se ardhja e dytë të Jezusit Profeti (as) është një fakt i caktuar, dhe ndriçon këtë çështje duke iu referuar engjëjve:

### **I Cili i dërgon gjatë gjithë kohës engjëjt prej qiejve në Tokë:**


Kthimi në Tokë në Fundin e Kohës i Profetit Isa (as) është një nga mrekullitë e All-llahut. Bediuzamani i referohet kësaj të vërtete të qartë të shpallur në Kur'an dhe hadithe, dhe e përshkruan ardhjen e dytë të Profetit Isa (as) si, me lejen e All-llahut, një gjë absolutisht të sigurt.

Bediuzamani thotë se engjëjt vijnë po ashtu në Tokë, me lejen e All-llahut, kur është e nevojshme, dhe se Profeti Isa (as) do të vijë për herë të dytë, në kohën e caktuar nga All-llahu, dhe se ai do t'iu bëjë thirrje njerëzve që t'i përvetësojnë vlerat e vërteta morale fetare si i dërguar i All-llahut.

Engjëjt jetojnë në një dimension që ndryshon nga ai i hapësirës dhe kohës i njohur për qeniet njerëzore. Ajetet e mëposhtme tregojnë se dimensionin e banuar nga engjëjt është përtej atyre koncepteve që janë të njohura për ne:

**[Ky dënim është] nga Allahu, Zoti i Rrugëve të Ngjitjes. Tek Ai ngjiten engjëjt dhe Shpirti (Xhebraili), në një ditë që zgjat sa pesëdhjetë mijë vjet. (Surja Me'arixh: 3-4)**

Referenca në këtë ajet për "një ditë kohëzgjatja e së cilës është pesëdhjetë mijë vjet", tregon se engjëjt nuk janë të lidhur me konceptin e kohës me të cilin ne jemi të lidhur. Përveç kësaj,





kjo është një nga provat që ka një jetë tjetër përtej konceptit të kohës të njohur për qeniet njerëzore dhe se kjo jetë nuk është e varur nga një koncept i kohës dhe hapësirës i ngjashëm me ato të kësaj bote. Është e mundur që Profeti Isa (as) është duke jetuar në një dimension të tillë. (All-llahu e di të vërtetën.)


Fakti që engjëjt vijnë në Tokë për të bërë gjëra të urdhëruara nga All-llahun dhe në kohë të caktuara nga Ai tregon se është e mundur, me lejen e Zotit tonë, për të kaluar nga dimensionet tjera në atë tonin. Në Kur'an shpallet se melaiKET zbresin në Tokë ndonjëherë për të komunikuar shpalljen e All-llahut, dhe ndonjëherë, me lejen e All-llahut, për t'i ndihmuar dhe mbështetur besimtarët:

**Atëherë ti (Muhamed) u thoshe besimtarëve: "A nuk ju mjafton ndihma e Zotit tuaj me tre mijë engjëjt të dërguar?" (Surja Al 'Imran: 124)**

**Me vullnetin e Tij, Ai ia dërgon engjëjt (Xhibrilin) me Shpallje kujt të dojë prej robërve të Tij (duke u thënë): "Paralajmëroni se s'ka zot tjetër të vërtetë përveç Meje, prandaj të më kini frikë Mua!" (Surja Nahl: 2)**

Në Kur'an shpallet po ashtu se engjëjt erdhën si të dërguar te Profetët Ibrahim (as) dhe Luti (as) dhe i njoftuan ata për vuajtjet që do të pësonin popujt e tyre; se ata erdhën tek Profeti Zekerija (as) dhe e njoftuan atë se do të kishte një fëmijë, dhe se ata i erdhën Hazreti Merjemes (as) dhe e njoftuan atë se ajo ishte zgjedhur dhe për lindje e Profetit Isa (as). Ne njoftohemi gjithashtu me shpalljen e Kur'anit Profetit tonë (saas) në të njëjtën mënyrë për engjëllin Xhibril (as), dhe se Profeti (saas) e kishte parë Xhibrilin (as).

Duke iu referuar engjëjve, Bediuzamani tregon se ardhja e dytë e Profetit Isa (as) në formë njerëzore në Fundin e Kohës do



të jetë në përputhje me ligjin e All-llahut, dhe se premtimi i All-llahut do të plotësohet.

**Për ta sjellë kështu fenë e Profetit Isa (as) në një përfundim të mirë, në një përfundim të tillë të rëndësishëm:**

Me këto fjalë, Bediuzamani është duke thënë se Zoti ynë do ta dërgojë Profetin Isa (as) në Tokë për herë të dytë për “NJË PËRFUNDIM TË MIRË, TË RËNDËSISHËM.” Me kthimin në Tokë të Profetit Isa (as), Krishterimi do të pastrohet prej të gjitha besimeve dhe praktikave të rrejshme dhe do të kthehet në Islam.


Nga kjo do të thotë, Krishterimi do të restaurohen në formën e vërtetë të shpallur nga Profeti Isa (as), do të ketë një aleancë mes Muslimanëve dhe të krishterëve të vërtetë dhe kjo aleancë e bashkuar rreth të vërtetës do të sjellë paqe në botë.

**[Profeti Isa (as) i cili është] i gjallë dhe i pranishëm me trupin e tij në Botën Qiellore:**

Këtu, Bediuzaman është duke deklaruar se, ashtu si engjëjt, Profeti Isa (as) është i gjallë në praninë e All-llahut dhe se ai do të kthehet në Tokë në kohën e caktuar nga All-llahu.

Melaiket zbresin në Tokë dhe pastaj kthehen në praninë e All-llahut në kohë të ndryshme të caktuara nga Ai. Megjithatë, fakti se ato ngriten në praninë e All-llahut nuk do të thotë se ato zhduken siç ne e kuptojnë këtë koncept në këtë botë. Ato thjeshtë kalojnë në një dimension tjetër dhe vazhdojnë të jetojnë, por përtej perceptimit tonë.

Në mënyrë të ngjashme, fakti se Profeti Isa (as) është marr në praninë e All-llahut nuk do të thotë se ai ka vdekur. Në të




vërtetë, disa ajete e bëjnë shumë të qartë se Profeti Isa (as) nuk ka vdekur, dhe kjo është konfirmuar edhe në hadithe. Profeti Isa (as) është i gjallë në një dimension që ne nuk mund ta kuptojmë. Përveç kësaj, fakti se engjëjt mund të lëvizin në mes të dy dimensioneve, me lejen e All-llahut, tregon se kjo është një çështje e lehtë në qoftë se Zoti ynë e urdhëron këtë.

Kur koha e caktuar nga All-llahu vjen, Profeti Isa (as) do të kthehet në Tokë dhe ai do t'iu bëjë thirrje njerëzve për vlerat e vërteta morale fetare si i dërguari i Zotit tonë. Bediuzamani gjithashtu shpreh këtë fakt me këto fjalë.

Me fjalët **“[PROFETI ISA (AS) I CILI ËSHTË] I GJALLË DHE I PRANISHËM ME TRUPIN E TIJ NË BOTËN QIELLORE,”** Bediuzamani na thotë se Profeti Isa (as) nuk ka vdekur, se ai është ende gjallë dhe do të kthehet në Tokë në formë njerëzore. Bediuzamani kështu tregon se Profeti Isa (as) nuk është një personalitet kolektiv dhe na kumton lajmin e mirë se ky profet i bekuar do të kthehet në Tokë, si një mrekulli nga All-llahu **“SI NJË INDIVID NË FORMË NJERËZORE.”**

*Nuk është larg urtësisë së Një Të Urtit Lavdiplotit ... ta veshë Profetin Isa (as) në trupin e tij dhe ta dërgojë atë në botë ... për një përfundim të tillë aq të rëndësishëm, madje edhe nëse ai ... do të kishte vdekur me të vërtetë dhe të kishte shkuar në cepin më të largët të Ahiretit:*

Me këto fjalë, Bediuzamani na kujton se fuqia e Zotit tonë është e pafund dhe se Ai ka fuqi të bëjë çdo gjë që Ai dëshiron dhe thotë se ardhja e dytë e Profetit Isa (as) do të ndodhë, me lejen e All-llahut, patjetër. Përmendja e fuqisë së pafund të Zotit tonë nga Bediuzamani në përshkrimin e tij të ardhjes së Profetit Isa (as) është padyshim një nga treguesit më të qartë të sigurisë absolute të tij mbi këtë temë.



Bediuzamani jep një shembull këtu dhe thotë se “NUK ËSHTË LARG URTËSISË SË NJË TË URTIT LAVDIPLLOTIT ... TA VESHË ATË NË TRUPIN E TIJ DHE TA DËRGOJË NË BOTË ... për një përfundim të tillë aq të rëndësishëm, MADJE EDHE NËSE AI ... DO TË KISHTE VDEKUR ME TË VËRTETË.” Me këto fjalë, Bediuzamani në mënyrë eksplicite i referohet një “QENIE NJERËZORE” dhe tregon se Profeti Isa (as) nuk është një personalitet kolektiv.


Ai edhe një herë na kumton lajmin e gëzuar se, me lejen e Zotit tonë, Profeti Isa (as) do të kthehet në Tokë si “NJË PERSON” në Fundin e Kohës.

### **Pasi që Ai e ka premtuar këtë, Ai padyshim do ta dërgojë atë:**

All-llahu ka shpallur se Profeti Isa (as) do të kthehet në Tokë. Ai patjetër do ta mbajë këtë premtim.

Gjithë këto dëshmi janë argument se ata njerëz që përpiqen ta mohojnë se Profeti Isa (as) nuk ka vdekur dhe faktin se ai do të kthehet në Tokë, nga paaftësia për ta vlerësuar siç duhet fuqinë dhe madhësinë e All-llahut, janë duke e bërë një gabim të rëndë.

Nuk duhet harruar se All-llahu është I Gjithëfuqishmi, dhe ka fuqi të bëjë çdo gjë. Ai krijon çfarë të dojë, në formën që Ai dëshiron. Dituria e Tij është e pafund. Kur koha e caktuar nga All-llahu vjen një mrekulli e madhe do të ndodhë dhe Profeti Isa (as) do të kthehet në Tokë. Ky fakt kumtohet në ajete dhe hadithe dhe është një mrekulli për të cilën duhet të reflektojnë të gjithë besimtarët. Bediuzamani gjithashtu shprehu këtë premtim të bërë nga All-llahu dhe, duke na kujtuar ne, ashtu siç është shpallur në Kur'an, se Zoti ynë është Ai I Cili nuk i thyen



premtimet e Tij, na jep lajmin e gëzuar se kthimi në Tokë, në formë njerëzore, e Profetit Isa (as) është një **“E VËRTETË E SIGURT.”**


**10. ... KUR PROFETI ISA (AS) TË VIJË,** nuk do të thotë se të gjithë duhet ta dinë **SE AI ËSHTË ISAI I VËRTETË. TË ZGJEDHURIT E TIJ DHE ATA QË JANË TË AFËRT ME TË DO TA NJOHIN ATË** nëpërmjet dritës së besimit. Nuk do të jetë e qartë vetvetiu, prandaj **JO TË GJITHË DO TA NJOHIN ATË ...** (Letrat / Letra e pesëmbëdhjetë - f.80)

Bediuzamani thotë se në vitet e hershme të kthimit në Tokë të Profetit Isa (as) numri i atyre që e dinë se kush është ai do të jetë shumë i vogël. Pasuesit dhe nxënësit e afërt me të dhe me besim të thellë do të jenë në gjendje ta njohin atë nëpërmjet dritës së besimit, por shoqëria në përgjithësi nuk do ta dijë se ai është Profeti Isa (as):

### **Kur Profeti Isa (as) të vijë:**

Me fjalët **“KUR PROFETI ISA (AS) TË VIJË”** Bediuzamani hedh dritë mbi një numër çështjesh të rëndësishme. Me fjalët **“KUR [AI] ... TË VIJË”** Bediuzamani është duke e kumtuar lajmin se Profeti Isa (as) do të **“VIJË PADYSHIM.”** Bediuzamani përdor foljen **“VIJË”** për ta bërë të qartë se Profeti Isa (as) është **“NJË INDIVID,”** e jo një **“entitet shpirtëror.”**

Një personalitet kolektiv nuk mund të **“vijë”** askund. Një personalitet kolektiv vetëm mund të **“formohet.”** **“ARDHJA”** është një veprim specifik për qeniet njerëzore. Me këto fjalë Bediuzamani e thekson këtë dallim të madh duke e bërë të sigurt se Profeti Isa (as) do të kthehet si një qenie njerëzore.



### **Ai të jetë Isai i vërtetë:**


Me këto fjalë Bediuzamani e thekson përsëri se Profeti Isa (as) është “NJË QENIE NJERËZORE” dhe jo një entitet shpirtëror. Duke iu referuar “ISAIT TË VËRTETË” Bediuzamani i referohet përsëri “NJË PERSONI”, ndryshimi midis Profetit Isa (as) dhe njerëzve të tjerë të përcaktuar me përdorimin e fjalës “I VËRTETË.” Bediuzamani përdor edhe përemrin “AI” për të përsëritur sërish faktin se Profeti Isa (as) është “NJË QËNIE NJERËZORE.” Përveç kësaj, përdorimi i fjalëve “ISAI I VËRTETË” nga Bediuzamani vë në pah se kur ai të kthehet ai do të jetë i ndryshëm nga “Mesihët e rrejshëm,” të cilët gjithashtu janë të gjithë qenie njerëzore, dhe se ky individ i bekuar do të jetë “ISAI I VËRTETË.”

Kur Profeti Isa (as) të kthehet, së bashku me të gjitha ato karakteristika që përputhen me përshkrimet e dhëna në Kur’an dhe në hadithe, ai do të dallojë nga të gjithë mesihët e rrejshëm dhe, siç thekson Bediuzamani, do të jetë “ISAI I VËRTETË.”

### **Të zgjedhurit e tij dhe ata afër tij:**

Bediuzamani përdor fjalët “TË ZGJEDHURIT E TIJ DHE ATA AFËR TIJ” për të treguar se Profeti Isa (as) do të ketë “PASUES TË AFËRT TË PAJISUR ME BESIM TË THELLË.” Është e pamundur për një personalitet kolektiv të ketë “pasues” apo “njerëz të afërt me të.” Vetëm një person mund të ketë pasues.

Bediuzamani ishte padyshim shumë i vetëdijshëm për këtë. Duke iu referuar pasuesve të Profetit Isa (as) ai u thotë Muslimanëve se Profeti Isa (as) nuk është një personalitet kolektiv dhe se ky individ i bekuar do të jetë personalisht në krye të pasuesve të tij.



### **Do ta njohin atë:**

Me përdorimin nga ai të fjalës “ATË” Bediuzamani sërish deklaroi se Profeti Isa (as) do të vijë si “NJË PERSON.” Përdorimin i fjalës “TA NJOHIN” nga Bediuzamani vë këtë çështje përtej çdo dyshimi. Vetëm një “PERSON”, një “INDIVID” mund të njihet. Natyrisht është e pamundur për “pasuesit e tij të afërt që ta njohin një personalitet kolektiv.”

Megjithatë, Bediuzamani thotë se pasuesit e Profetit Isa (as) të pajisur me besim të thellë dhe të afërt me të do ta njohin atë nëpërmjet dritës së besimit. Bediuzamani është natyrisht shumë i vetëdijshëm për këtë ndërsa e përcjellë këtë informacion. Bediuzamani i bën këto deklarata në një mënyrë shumë të vetëdijshme dhe në këtë mënyrë dëshmon se Profeti Isa (as) është “NJË INDIVID” i cili do të njihet nga besimtarët.

### **Jo të gjithë do ta njohin atë:**

Duke thënë se “JO TË GJITHË DO TA NJOHIN ATË” Bediuzamani e bën të qartë se në ditët e para të ardhjes së tij jo të gjithë do ta dinë se kush është ai, me fjalë të tjera, shoqëria si tërësi nuk do ta njoh atë. Bediuzamani përdor këto fjalë për ta tërhequr vëmendjen tonë sërish ndaj karakteristikës së foljes “TA NJOHIN” e cila është përshkruar më lart dhe që është unike për qeniet njerëzore. Nëse Bediuzamani do të mendonte se Profeti Isa (as) ishte një personalitet kolektiv ai nuk do ta kishte bërë një deklaratë të tillë apo t’i referohej njohjes së Profetit Isa (as). Por, duke përdorur fjalën “ATË” Bediuzamani deklaroi se Profeti Isa (as) është “NJË PERSON” dhe shpjegon se cilët nuk do të jenë në gjendje ta njohin atë, duke e theksuar edhe një herë këtë çështje.



# SI MUND TA NJOHIM PROFETIN ISA (AS)?


## **Kush do të jetë në gjendje ta njoh Profetin Isa (as)?**

Është vërtetuar në dritën e Kur'anit, haditheve dhe interpretimeve të dijetarëve Islamik se Profeti Isa (as) nuk kishte vdekur dhe ishte ngritur në praninë e All-llahut dhe se ai me të vërtetë do të kthehet në tokë. Megjithatë, mbetet një çështje e hapur: “Si do ta njohim ne Profetin Isa (as) kur ai të kthehet sërish në këtë botë dhe cilat prej veçorive të tij do ta bëjnë atë të njohur?”

Kur'ani, ose në ajete ose në tregime të veçanta, na jep informacion të hollësishëm në lidhje me jetët dhe moralin e lartë të profetëve. Shumë prej veçorive të përbashkëta të profetëve dhe të besimtarëve të vërtetë përmenden në Kur'an. Prandaj, besimtarët e sinqertë mund t'i njohin këto veti të larta dhe në këtë mënyrë ta njohin Profetin Isa (as).

Mirëpo, shumë pak njerëz do ta njohin Profetin Isa (as) kur ai të kthehet, siç pohohet nga Bediuzaman Said Nursi:

*Kur Profeti Isa (paqja qoftë mbi të) do të vijë, nuk do të thotë se të gjithë duhet ta dinë që ai është Profeti Isa (as) i vërtetë. Të zgjedhurit e tij dhe ata afër tij do ta njohin atë nëpërmjet dritës së besimit. Nuk do të jetë e qartë vetvetiu që të gjithë ta njohin atë.<sup>23</sup>*






Siç thotë Bediuzamani, gjatë viteve të para të ardhjes së tij të dytë, numri i njerëzve që do ta njohin Profetin Isa (as) do të jetë i kufizuar në një grup të vogël të njerëzve që janë të afërt me të. Veç kësaj, kjo do të jetë e mundshme vetëm përmes “dritës së besimit”. “Drita e besimit” është të kuptuarit e dhuruar nga All-llahu atyre që besojnë në ekzistencën dhe njësinë e All-llahut, zbatojnë urdhrat e Kur’anit dhe jetojnë sipas Sunnetit të të Dërguarit të All-llahut, Profetit Muhammed (saas). Me një të kuptuar të tillë, besimtarët mund të vlerësojnë situatat në mënyrë të saktë dhe të kuptojnë hollësitë e ngjarjeve pa vështirësi. Siç shpallet në Kur’an, besimtarët janë ata njerëz të cilët mendojnë mbi gjithçka që i rrethon dhe kështu kurrë nuk iu ikin hollësitë apo aspektet suptile të gjërave. Me të vërtetë, All-llahu e njofton njeriun se Ai do t’ua dhurojë aftësinë e të dalluarit (për të gjykuar në mes të së drejtës dhe të gabuarës) atyre që mendojnë për të gjitha çështjet në përpjekje për ta kuptuar madhështinë dhe fuqinë e All-llahut dhe atyre që ia kanë frikën (takuan) Atij:

**O besimtarë! Nëse i frikësoheni All-llahut, Ai do t’ju japë aftësinë e të gjykuarit drejt, do t’ju lirojë nga gjynahet tuaja dhe do t’ju falë. All-llahu zotëron mirësi të madhe. (Surja Enfal: 29)**

Pra, ata që do ta njohin Profetin Isa (as) gjatë ardhjes së tij të dytë dhe që do t’i bashkëngjiten porosisë së tij do të jenë në të vërtetë besimtarët e drejtë të cilët besojnë në All-llahun dhe Kur’anin dhe në të Dërguarin e All-llahut (saas), dhe mendojnë thellë mbi gjërat. Bediuzaman Said Nursi, gjithashtu, tërheqë vëmendjen për këtë çështje si vijon:

*Në të vërtetë, madje edhe zbritja e Profetit Isa (as) dhe se ai vet është Profeti Isa (as), mund të dihet vetëm nëpërmjet dritës së besimit; këtë nuk do ta dijë çdokush.<sup>24</sup>*



## **Cilat veti të Profetit Isa (as) e bëjnë atë të njohur?**

Për t'iu përgjigjur kësaj pyetje, ne së pari i referohemi Kur'anit në kërkim të atyre vetive që janë të përbashkëta për të gjithë profetët për të cilët flitet në Kur'an dhe kjo vlen njëllor edhe për Profetin Isa (as). Në fakt, ka veti të shumta të profetëve por në këtë pjesë ne do të theksojmë ato më të dukshmet të cilat bien në sy menjëherë.

### **1. Ai ndryshon prej njerëzve tjerë për vlerat e tij të jashtëzakonshme morale**

Ashtu si të gjithë profetët e tjerë që All-llahu i ka zgjedhur për t'ia shpallur porosinë e Tij njerëzimit, Profeti Isa (as) është i njohur për vlerat e tij të shkëlqyera morale. Vetia më e dallueshme e Profetit Isa (as) është personaliteti i tij shembullor, menjëherë i dallueshëm në shoqërinë në të cilën ai jeton. Ai, me të vërtetë ka një karakter shembullor, të pashembullt në natyrë dhe që i bie në sy gjithkujt në shikim të parë. Një person shumë i përkushtuar, guximtar dhe i fortë, një shprehje e besimit që ai ka në All-llahun dhe e besimit të pastër të tij në Të. Me tipare të tilla, ai ka një ndikim të thellë në të gjithë. Kjo epërsi, një veti që e ndajnë të gjithë profetët, rrëfehët në këto ajete:

**Ky është argumenti Ynë, të cilin Ne ia dhamë Ibrahimit kundër popullit të tij. Ne ngremë kë të duam në shkallë të lartë. Vërtet, Zoti yt është i Urtë e i Gjithëdijshëm. 84. Ne i dhuruam atij Isakun dhe Jakubin. Që të dy këta i udhëzuam në rrugë të drejtë, ashtu siç patëm udhëzuar më parë Nuhun. Ndër pasardhësit e tij Ne udhëzuam Davudin, Sulejmanin, Ejubin, Jusufin, Musain dhe Harunin. Kështu i shpërblejmë punëmirët. Ne**



udhëzuam edhe Zekerijan, Jahjain, Isain, Iljazin - të gjithë këta kanë qenë nga njerëzit e mirë. Po ashtu, udhëzuam edhe Ismailin, Eljesain, Junusin dhe Lutin - secilin prej tyre e ngritëm mbi të gjithë njerëzit. Ne zgjodhëm dhe udhëzuam në rrugë të drejtë edhe disa nga paraardhësit, pasardhësit dhe vëllezërit e tyre. Ky është udhëzimi i Allahut, të cilin Ai ia jep kujt të dojë nga robërit e Vet. Por, nëse ata adhurojnë zota të tjerë, do t'u humbë çdo gjë nga ajo që kanë bërë. (Surja En'am 83-88)

Se All-llahu iu dhuroi veti të larta profetëve, kjo shprehet në mënyrë të qartë në vargjet e mësipërme. Ka shumë shembuj të tjerë të rrëfyer në Kur'an dhe ajetet e mëposhtme na informojnë për tiparet e larta të dhuruara profetëve të ndryshëm:

**Vërtetë, Ibrahim i ka qenë shëmbëlltyrë e të mirave, adhurues i All-llahut, besimtar i drejtë dhe nuk ka qenë nga idhujtarët.**(Surja Nahl: 120)


**Përkujto robërit tanë Ibrahimin, Is-hakun, Jakubin që ishin të fortë në zbatimin e detyrave dhe largpamës në fe.**(Surja Sad: 45)

**S'ka dyshim se ata ishin te Ne prej të zgjedhurve më të mirë.**(Surja Sad: 47)

**Ne i patëm dhënë Davudit dhe Sulejmanit dituri, e ata të dy thanë: "I falënderohemi vetëm All-llahut që na dalloi (me të mira) mbi shumë robër të Tij besimtarë..."**(Surja Neml: 15)

Profeti Isa (as) është gjithashtu njëri prej profetëve të zgjedhur të All-llahut. All-llahu thotë për të si vijon:

**Nga këta të dërguar, disa syresh i ngritëm mbi të tjerët.**




**Disave All-llahu u foli drejtpërdrejt, kurse të tjerë i ngriti në shkallë të larta. Ne i dhamë Isait, birit të Merjemes, prova (mrekulli) të qarta dhe e ndihmuam me Shpirtin e Shenjtërisë (Xhibrilin a.s.). (Surja Bekare: 253)**

### **Ai do të njihet nga shprehja e fytyrës së tij që vërehet vetëm tek Profetët**

All-llahu na njofton në Kur'an se superioriteti i atyre që Ai ka zgjedhur mund të jetë në aspektin e diturisë së tyre si edhe në aspektin e fuqisë së tyre fizike:

**... Ai u përgjigj: "All-llahu e ka zgjedhur atë për mbretin tuaj dhe e ka pajisur me dijeni të gjerë dhe me fuqi trupore. All-llahu ia jep pushtetin e Vet kujt të dojë; All-llahu është Mirëbërës i madh dhe i Gjithëdijshëm." (Surja Bekare: 247)**

I pajisur me urtësi, fuqi fizike, dituri dhe përsosmëri të karakterit, Profeti Isa (as) do të ketë një pamje të veçantë që mund të vërehet vetëm tek profetët. Frika e tij e fuqishme ndaj All-llahut dhe drita e besimit të tij të palëkundur do të jenë plotësisht të dukshme në fytyrën e tij. Kjo shprehje në fytyrën e tij në të njëjtën kohë do ta dalloj atë prej të tjerëve dhe njerëzit që do ta shohin atë menjëherë do të hetojnë se po takojnë dikë mjaft superior. Megjithatë, jo të gjithë do të jenë në gjendje për ta parë këtë të vërtetë të dukshme. Nga zemërimi dhe krenaria, është e mundshme që disa njerëz nuk do ta përfillin këtë superioritet dhe pavarësisht nga ajo që do të ndjejnë thellë në veten e tyre, ata mund të shtiren si të paditur. Vetëm ata që kanë besim të sinqertë do të kuptojnë këtë superioritet dhe do ta vlerësojnë atë.




All-llahu na informon se Profeti Isa (as) është **“I famshëm në dynja (në këtë botë) dhe në ahiret (në jetën e përjetshme) dhe njëri prej të afërmve të All-llahut...”** (Surja Ali Imran: 45) Pra, Profeti Isa (as) do të jetë i njohur për ata njerëz që e rrethojnë atë për nderin dhe përsosmërinë që mund të vërehet vetëm tek ata që janë të zgjedhur nga All-llahu.

### **3. Ai ka mençuri të jashtëzakonshme dhe të folur bindës**

**Këta janë ata që u kemi dhënë Librin, Urtësinë dhe Profecinë... (Surja En'am: 89)**

Gjatë gjithë historisë, All-llahu ka komunikuar porositë dhe shpalljet e Tij përmes të dërguarve të Tij. Ai gjithashtu iu dhuroi urtësi këtyre të dërguarve: një mënyrë bindëse dhe tejet të qëlluar të të folurit, sjellje shembullore në urdhërimin e veprave të drejta dhe në ndalimin nga e keqja, janë të gjitha veti të përbashkëta të profetëve. Në Kur'an, All-llahu gjithashtu tërheq vëmendjen ndaj urtësisë që i është dhuruar secilit profet. Për shembull, për profetin Davud (as), All-llahu thotë: “...Ne i dhamë mençuri e dijeni për të gjykuar.” (Surja Sad: 20) Në mënyrë të ngjashme për profetin Jahja (as): “O Jahja, ... Dhe Ne, kur ende ishte fëmijë, i dhamë mençuri.” (Surja Merjem: 12) Për Musain (as), All-llahu na njofton: Dhe kur ai (Musai) arriti moshën madhore dhe pjekurinë e duhur, Ne i dhamë atij urtësi e dituri. (Surja Kasas: 14) Një varg tjetër në lidhje me këtë pason: “Ne i dhamë Lukmanit urtësinë (duke i thënë): “Falënderoje All-llahun!” (Surja Lukman: 12). Ngjashëm me këtë, All-llahu rrëfen: “Ne u dhamë pasardhësve të Ibrahimit Librin e urtësinë...” (Surja Nisa: 54)

Kështu një veti tjetër e profetëve është atyre u është dhuruar



urtësi e jashtëzakonshme dhe kjo gjithashtu vlen edhe për Profetin Isa (as) siç mësojmë nga Kur'ani:


**All-llahu do të thotë: “O Isa, i biri Merjemes, kujtoje mirësinë Time ndaj teje dhe nënës sate: se si të forcova ty me Shpirtin e Shenjtë (Xhibrilin), kështu që ti u predikoje njerëzve, kur ishe foshnjë në djep dhe i rritur (burrë); se si të mësova Librin dhe Urtësinë, Teuratin dhe Ungjillin. (Surja Ma’ide 110)**

**E, kur Isai solli prova të qarta, tha: “Ju kam sjellë urtësinë (Profecinë) dhe do t’ju shpjegoj disa gjëra, për të cilat nuk po pajtoheni. Andaj, frikësojuni All-llahut dhe bindmuni mua! (Surja Zuhruf: 63)**

Këto ajete tregojnë se Profeti Isa (as) do të jetë i njohur nga mënyra e tij bindëse, tejet e qëlluar dhe e mahnitëse e të folurit. Si në të gjitha çështjet tjera, një mënyrë bindëse e të folurit është një veti e përbashkët për profetët. Besimtarët që i përmbahen Kur’anit si udhëzues në të vërtetën kuptojnë se të folurit e Profetit Isa (as) ka urtësinë e cila është e veçantë për të dërguarit e zgjedhur prej All-llahut. Mençuria që ai shfaqë, parashikimet e përsosura që ai bën, zgjedhjet e mençura që ai sjellë do të jenë shenja të qarta të një dhuntie të veçantë që All-llahu i ka dhuruar atij. Kështu, superioriteti i tij do të jetë edhe më i qartë.

#### **4. Ai do të jetë shumë i besueshëm**

Çdo i dërguar e prezantoi veten tek komuniteti tek i cili u dërgua duke thënë: **“Unë jam një i dërguar i besuar për ju”** (Surja Shu’ara: 107) Kjo besnikëri e të dërguarve është rezultat i përmbajtjes së tyre të rreptë ndaj Librit dhe fesë së All-llahut dhe detyrimeve të përcaktuara nga Ai. Ata me përpikëri




respektojnë kufijtë e All-llahut dhe kurrë nuk devijojnë nga rruga e Tij e drejtë. Duke pasur për qëllim vetëm të arrijnë kënaqësinë e All-llahut, ata nuk i nënshtrohen dëshirave të askujt. Në Kur'an informohemi se të gjithë profetët pa dallim u identifikuan nga popujt e tyre përmes kësaj karakteristike të tyre. Për shembull, në Kur'an, Musai (as) e prezantoi veten tek komuniteti në mesin e të cilit ka jetuar, si vijon:

**Përpara tyre Ne vumë në sprovë popullin e Faraonit, kur u pat ardhur i Dërguari fisnik, (i cili u tha): “Më sillni robërit e All-llahut, sepse Unë jam për ju një i dërguar i besuar! (Surja Duhan: 17-18)**

Nuk ka dyshim, bashkësitë në përgjithësi dështuan në vlerësimin e kësaj vetie të rëndësishme të të dërguarve. Për më tepër, duke refuzuar të largohen nga mënyra injorante e jetesës në të cilën u zhytën ata dhe duke refuzuar të jetojnë sipas fesë së vërtetë në të cilën të dërguarit i thirrën, ata zakonisht u treguan jotolerant ndaj tyre. Vetëm pas një kohe të caktuar ata e kuptonin se të dërguarit ishin njerëz të besueshëm. Profeti Jusuf (as) është një shembull i mirë. Ai u sprovua me vështirësi për një periudhë të gjatë; së pari ai u shit si skllav dhe më pas u burgos për një numër vitesh. Megjithatë, me vullnetin e All-llahut, kur arriti koha e duhur, ai u njoh si një person i besueshëm nga njerëzit dhe mbreti e vendosi në krye të thesarit të shtetit:

**Mbreti tha: “Ma sillni atë, do ta marr pranë vetes.” Pasi bisedoi me të, i tha: “Qysh sot, ti ke pozitë të lartë dhe je i besuar.” (Surja Jusuf: 54)**

Këto veti të profetëve të përmendura në Kur'an gjithashtu do të jenë të dallueshme tek Profeti Isa (as). Në ardhjen e tij të dytë në tokë, si një ligj i pandryshueshëm i All-llahut, ai do të njihet për besueshmërinë e tij. All-llahu do ta ndihmojë atë, ashtu



si i ndihmoi të gjithë profetët tjerë dhe besueshmëria e tij do të jetë e qartë në kohën e duhur.


### **5. Ai do të jetë nën mbrojtjen e All-llahut**

**Shumë kohë më parë Ne u premtuam robërve Tanë të dërguar se ata do të ndihmohen (prej Nesh) dhe se ushtritë tona do të jenë me siguri fitimtare! (Surja Saffat: 171-173)**

All-llahu iu dhuroi mbrojtje të dërguarve të Tij mbi njerëzit e tjerë. Ai iu dha atyre fuqinë për të mposhtur armiqtë e tyre dhe i mbrojti ata kundër të gjitha kompleteve të tyre. Qoftë në fazën e marrjes së një vendimi apo të realizimit të një plani, All-llahu gjithmonë i mbështeti ata.

Një tjetër shenjë për besimtarët që janë duke e pritur ardhjen e Profetit Isa (as), të Dërguarit të All-llahut, është dhuntia e tij që gjithçka që bën të ketë sukses. Vlerësimet e tij, p.sh., apo metodat që ai përdorë, të gjitha sjellin rezultate të mrekullueshme për të si edhe për njerëzit rreth tij. Me të vërtetë, disa ngjarje që duken të jenë kundër të mirës së njerëzve shpejti do të dëshmojnë se vlerësimet e tij do të jenë të qëlluara. Kjo për arsye se All-llahu i siguroi të Dërguarit e Tij se ata gjithmonë do të triumfojnë. Pra, kjo ardhje e dytë e Profetit Isa (as) do të jetë shumë më e ndryshme nga ajo e para, duke qenë se kjo e dyta do të jetë nën flamurin ngadhënjimtar të Islamit. Ky premtim siguron suksesin e plotë që Profeti Isa (as) do të arrijë në misionin e tij.

Me të vërtetë, kjo do të jetë aq e qartë sa që në mënyrë të pashmangshme do të tërheqë vëmendjen e besimtarëve që do ta pasojnë atë. Ndërkohë, armiqtë e tij do të vënë re gjithashtu






natyrën e jashtëzakonshme të kësaj situatë. Megjithatë, ata do të dështojnë të pranojnë se ky është udhëzim i qartë i All-llahut. Kjo është thjeshtë për shkak se qëllimi i tyre kryesor në jetë është të mposhtin këtë person të shquar të cilin ata e shohin si “një qenie të zakonshme njerëzore si ata vet.” Megjithatë, si theksohet në ajetin: **“Pastaj, Ne do t’i shpëtojmë të dërguarit Tanë dhe ata që kanë besuar. Kështu, është detyra Jonë që t’i shpëtojmë besimtarët.”** (Surja Junus: 103) All-llahu do t’i bëjë të padobishme të gjitha përpjekjet e tyre dhe do ta ndihmojë të dërguarit e Tij. Komplotet apo luftërat e bëra kundër tij kurrë nuk do të kenë sukses.

### **6. Ai nuk do të kërkojë ndonjë shpërblim për shërbimet e tij**

Të gjithë profetët e përmendur në Kur’an shërbyen në rrugën e All-llahut duke mos kërkuar ndonjë shpërblim për këtë. I vetmi përfitim që ata kërkuan ishte kënaqësia e All-llahut. Kurrfarë përfitimi të dynjasë, kurrfarë përfitimi nuk kërkuan ata prej askujt. Një prej ajeteve që e lartëson këtë virtyt të të dërguarve është si vijon:

**O populli im! Unë nuk kërkoj nga ju shpërblim për këtë. Mua më shpërblen vetëm Ai që më ka krijuar! A nuk kuptoni?! (Surja Hud: 51)**

Ky virtyt i përbashkët për të gjithë të dërguarit do të jetë i dukshëm edhe tek Profeti Isa (as). Në ardhjen e tij të dytë, ai do t’i thërras njerëzit nga mbarë bota në fenë e vërtetë të All-llahut. Megjithatë, ai nuk do të synojë përfitime të dynjasë për këtë. Ashtu si të gjithë të dërguarit e tjerë të përmendur në Kur’an, ai do të ndjekë kënaqësinë e All-llahut duke dëshiruar që të




shpërblehet nga Ai. Kjo veçori e tij do të bëj që ai të fitoj emër në shoqëri. Megjithatë, duhet gjithashtu të kemi parasysh se, si në të gjitha aspektet tjera, vetëm besimtarët do ta njohin dhe çmojnë këtë tipar të tij. Për më tepër, edhe pse armiqtë e tij do ta njohin atë, është plotësisht e mundshme që ata të mund të përhapin shpifje për të, ashtu si ato që përjetuan profetët tjerë në të kaluarën. Megjithatë, All-llahu do të provojë natyrën e pabazë të këtyre shpifjeve dhe do t'i ndihmojë atij, po në të njëjtën mënyrë në të cilën Ai e udhëzon atë në gjitha veprat e tij.

### **7. Ai do të jetë i butë dhe plot mëshirë ndaj besimtarëve**

Një veti tjetër e veçantë për të dërguarit është natyra e tyre “e mëshirshme dhe e butë” ndaj besimtarëve. Duke qenë i butë dhe i mëshirshëm për besimtarët që i pasojnë ata, të gjithë të dërguarit u përpoqën ta përmirësojnë karakterin e besimtarëve për mirëqenien e tyre si në këtë botë ashtu edhe në botën tjetër. Vetia më e dallueshme e Profetit Isa (as) do të jetë mëshira e tij ndaj besimtarëve. All-llahu na rrëfen për këtë virtyt me shembullin e të Dërguarit të Fundit Muhammedit (saas), por i cili është e përbashkët për të gjithë besimtarët, si vijon:

**Tashmë ju ka ardhur një i Dërguar nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë për gjynahet që bëni ju, jua dëshiron të mirën me gjithë zemër që ju të shkoni rrugës së drejtë dhe është i butë e i mëshirshëm me besimtarët. (Surja Teube: 128)**

Profeti Isa (as) do të jetë gjithashtu “thellësisht i brengosur” për besimtarët që e rrethojnë atë. Ky sinqeritet i jashtëzakonshëm i rrënjosur në qenien e tij do të jetë një prej dëshmive konkrete se ai është Profeti Isa (as) i vërtetë.




## **Paraqitja e Mesihëve të rrejshëm paralajmëron ardhjen e Profetit Isa (as)**

Besimtarët e vërtetë do ta njohin Profetin Isa (as) nga shenjat. Çdo veprim i tij do të jetë i mençur dhe i paimitueshëm; këto shenja do ta veçojnë atë prej njerëzve të tjerë dhe ai do të njihet menjëherë pa pasur nevojë për ndonjë dëshmi. Pikërisht përpjekjet e mesihëve të rrejshëm që të dëshmojnë se ata janë Profeti Isa (as) është treguesi më i mirë se ata janë, në të vërtetë, mashtrues. Veprimet e Profetit Isa (as) do të përbëjnë dëshminë e identitetit të tij. Ai do t'u shkaktojë një humbje të tmerrshme lëvizjeve dhe sistemeve ateiste që përpiqen të përhapin mohimin e All-llahut dhe të përhapin imoralitetin. Do të jetë lehtë për të që të ndalojë komplotet e mohuesve me frymëzimin e All-llahut, të përhap fenë e All-llahut midis njerëzve dhe të mohojë përpjekjet e të pafeve. Me anë të mrekullive të tij ai do të dëshmojë se feja e All-llahut është rruga e drejtë dhe se besimtarët do të fitojnë pushtet në mënyrë të pashmangshme. Në Kur'an All-llahu iu jep lajmin e gëzuar besimtarëve:

**Ata dëshirojnë ta shuajnë dritën e All-llahut me gojën e tyre, por All-llahu e përsos dritën e Vet, edhe nëse (këtë gjë) e urrejnë jobesimtarët. All-llahu është Ai që e ka çuar të Dërguarin e Vet me udhërrëfimin dhe fenë e së Vërtetës, për ta ngritur atë më lart se të gjitha fetë, edhe nëse nuk e pëlqejnë idhujtarët. (Surja Saff: 8-9)**

## **Ai nuk do të ketë të afërm, familje apo të njohur në tokë**

Profeti Isa (as) do të mund të njihet për nga vetitë e përmendura në Kur'an. Megjithatë, do të ketë edhe faktorë të




tjerë që do ta zbulojnë identitetin e tij. Njëri prej tyre do të jetë fakti se ai nuk do të ketë të afërm, familje apo të njohur në tokë. Nuk do të ekzistojë asnjë njeri që i di tiparet e tij fizike, fytyrën e tij apo tonin e zërit të tij. Me të vërtetë, askush nuk do ta njoh atë kur ai vjen në tokë për herë të dytë, thjeshtë sepse njerëzit që e njihnin atë jetuan dhe vdiqën dy mijë vjet më parë. Nëna e tij Merjemja (as), Profeti Zekerija (as), dishepujt që kaluan vite të tëra pranë tij, hebrenjtë e shquar të asaj kohe dhe madje edhe ata të cilët dëgjuan për shpalljet e Profetit Isa (as) janë të gjithë të vdekur për kohë të gjatë. Kështu, me ardhjen e tij të dytë në tokë askush s'do të ketë qenë dëshmitar i lindjes së tij, fëmijërisë, rinisë apo moshës së rritur. Askush nuk do të dijë asgjë për të. Siç u shpjegua në pjesët e mëparshme të librit, Profeti Isa (as) erdh në jetë me urdhrin e All-llahut, urdhrin "Bëhu!" Pas dy mijëvjeçarëve, është shumë e natyrshme që ai të mos ketë të afërm në tokë. All-llahu tërheqë një analogji në mes të gjendjes së tij dhe të Ademit (as) kur thotë:

**Rasti i Isait për All-llahun është si rasti i Ademit që e krijoi prej baltës e pastaj i tha: "Bëhu!" - dhe ai u bë.  
(Surja Al 'Imran: 59)**

Siç përmendet në këtë ajet, All-llahu i dha urdhër "Bëhu!" Ademit (as) dhe kështu ai u krijua. Mënyra se si Profeti Isa (as) u krijua për herë të parë ndodhi gjithashtu në të njëjtën mënyrë edhe pse ai kishte një nënë. Ademi (as) nuk kishte prindër dhe as Profeti Isa (as) nuk do të ketë me ardhjen e tij të dytë. Qindra vjet më vonë, ai do të jetë në tokë pa asnjë të afërm të njohur.

Një prej tipareve/veçorive më të rëndësishme që e dallojnë Profetin Isa (as) prej mesihëve të rrejshëm është se ai nuk do të ketë as nënë, as baba, as të afërm, as shokë apo të njohur në tokë. Kjo eliminon rrezikun e 'Mesihut të rrejshëm' që shfaqet kohë



pas kohe. Kur Profeti Isa (as) të kthehet në tokë nuk do të ketë kurrfarë dyshimi në lidhje me identitetin e tij të vërtetë. Askush s'do të ketë ndonjë arsye të thotë: "Ky person nuk mund të jetë Profeti Isa (as)." Kjo për arsye se Profeti Isa (as) do të jetë menjëherë i njohshëm me këtë veti të vetme, që mund ta bëj atë të dalloj nga çdo njeri në tokë, madje edhe nëse në të vërtetë asnjë njeri nuk do ta njoh besimin e tij. Gënjeshttrat e atyre që pretendojnë rrejshëm të jenë mesihu do të kuptohen me lehtësi. Është krejtësisht e palogjikshme për dikë që ka kaluar tërë fëmijërinë midis njerëzve, për fëmijërinë e të cilëve shumëçka është ende e gjallë dhe për të cilët një numër i madh i njerëzve kanë ditur të pretendojnë të jenë Profeti Isa (as) prej se kanë qenë të ri fare.




# PËRFUNDIM

**S**e Profeti Isa (as) do të kthehet në tokë për herë të dytë nga All-llahu është pa dyshim lajm i gëzuar Hyjnor për gjithë njerëzimin. Vlerat morale Islamike do të mbizotërojë me ardhjen e tij të dytë. Ai do të jetë një shpëtimtar i bekuar i dërguar për gjithë njerëzimin. Vërtetë, në kohëra kur dhuna dhe rrëmuja përjetoheshin gjithnjë e më shumë në botë, qeniet njerëzore luteshin për ndihmë nga All-llahu. Prandaj, All-llah iu përgjigj lutjes së tyre:

**Ç'keni ju që nuk luftoni në udhë të Allahut dhe për shpëtimin e të shtypurve: për meshkujt e pafuqishëm, gratë dhe fëmijët, të cilët thërrasin: "O Zoti ynë! Nxirrna nga ky qytet, banorët e të cilit janë keqbërës! Na cakto një mbrojtës dhe na dërgo nga ana Jote dikë që të na ndihmojë!" (Surja Nisa': 75)**

Siç u përmend më herët, shpëtimtari në kohën tonë është depërtimi i vlerave Kur'anore në shpirtat tanë dhe në shoqëri. Me ardhjen e tij të dytë, Profeti Isa (as) do t'i komunikojnë me gjithë zemër këto vlera të shpallura të pëlqyera nga All-llahu dhe do të përpiqet thjesht për t'i përhapur ato tek njerëzit në mbarë botën.

Dituria për ngjarjet e fshehta dhe të ardhme është diçka e njohur vetëm për All-llahun. Megjithatë, është e sigurt se ata që e



presin këtë periudhë të bekuar dhe këtë person duhet të marrin përsipër në atë kohë detyrime të rëndësishme. Ashtu siç do t'i mbrojnë dhe udhëzojnë të gjithë besimtarët Profeti Isa (as), besimtarët duhet t'i japin mbështetjen e tyre të përzemërt Profetit Isa (sa) dhe ta ndihmojnë atë në shërbimet që ai bën për hir të All-llahut.

Çdo përtaci në lidhje me pritjen e përzemërt të një mysafiri të tillë të rëndësishëm natyrisht se do të jetë moralisht e papranueshme. Askush, i cili ka besim në ajetet e All-llahut, dhe është në dijeni të zhvillimeve botërore dhe shenjave të fundit të kohës, nuk mund të vendosë të mos përgatitet për këtë vizitor të bekuar. Ata që i pasojnë të dërguarit e All-llahut, të cilët u ofrojnë atyre mbështetje të sinqertë dhe i pranojnë vlerat e shpallura nga ana e tyre mund të shpresojnë të fitojnë kënaqësinë, mëshirën dhe parajsën e përjetshme të All-llahut. Ky është një premtim i caktuar dhe myzhde e dhënë nga All-llahu:


**... Allahu ju ka dërguar udhërrëfyesin: një të Dërguar, i cili ju lexon shpalljet e Allahut me shpjegime të qarta, për t'i nxjerrë ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, nga errësira në dritë. Atë që beson Allahun dhe bën vepra të mira, Ai do ta shpjerë në kopshtet e Xhenetit, nëpër të cilët rrjedhin lumenj dhe ku do të qëndrojnë përgjithmonë. Pa dyshim, Allahu ka përgatitur për atë risk të mrekullueshëm. (Surja Talak: 10-11)**



# MASHTRIMI I EVOLUCIONIT

**D**arvinizmi, me fjalë të tjera teoria e evolucionit, u prezantua me qëllim të mohimit të faktit të Krijimit, por që në të vërtetë nuk është asgjë përveç një marrëzi e dështuar joshkencore. Kjo teori, e cila pretendon se jeta lindi rastësisht nga materia e pajetë, u zhvlerësua nga faktet shkencore të rregullit të mrekullueshëm në gjithësi dhe në gjallesa, si edhe me anë të zbulimit të rreth 300 milion fosileve që zbulojnë se evolucionit nuk ka ndodhur kurrë. Në këtë mënyrë, shkenca vërtetoi faktin se All-llahu krijoi gjithësinë dhe gjallesat në të. Propaganda që zhvillohet sot për të mbajtur në jetë teorinë e evolucionit mbështetet kryekëput në shtrembërimin e fakteve shkencore, interpretimin e paragjykuar dhe gënjeshttrat dhe pavërtetësitë e maskuara si shkencë.

Mirëpo kjo propagandë nuk mund ta fsheh të vërtetën. Fakti se **teoria e evolucionit është mashtrimi më i madh në historinë e shkencës** ka ardhur në shprehje shumë e më shumë në botën shkencore gjatë 20-30 viteve të fundit. Hulumtimet e bëra pas viteve të 80-ta në veçanti kanë zbuluar se pohimet e Darwinizmit janë krejtësisht të pabaza, gjë që është thënë nga një numër i madh i shkencëtarëve. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në veçanti, shumë shkencëtarë prej fushave të ndryshme si biologjia, biokimia dhe paleontologjia pranojnë gjymtinë e Darwinizmit dhe e përdorin faktin e krijimit për ta shpjeguar zanafillën e jetës.





Ne kemi ekzaminuar rënien e teorisë së evolucionit dhe provat e krijimit në mënyrë shumë të hollësishme shkencore në shumë prej punimeve tona dhe vazhdojmë ta bëjmë këtë. Duke pasur parasysh rëndësinë e madhe të kësaj çështjeje, do të jetë shumë e dobishme që ta bëjmë një përmbledhje të saj këtu.

### **Dështimi shkencor i Darwinizmit**

Teoria e evolucionit, edhe pse është një doktrinë që i ka fillimet në Greqinë e lashtë, u përqaftua gjerësisht në shekullin e nëntëmbëdhjetë. Zhvillimi më i rëndësishëm që e bëri teorinë temën kryesore të botës së shkencës ishte botimi në vitin 1859 i librit Origjina e Llojeve të Çarls Darvinit. Në këtë libër, ai doli me pretendimin se llojet e ndryshme në tokë nuk janë krijuar veç e veç, por rrjedhin nga një stërgjysh i përbashkët dhe kanë ndryshuar nga njëra-tjetra nëpërmjet ndryshimeve të vogla me kalimin e kohës. Teoria e Darvinit nuk mbështetet në asnjë zbulim shkencor konkret, siç e pranoi edhe ai vet, ajo ishte vetëm një “supozim”. Veç kësaj, ashtu siç e pranoi Darvini në kapitullin e gjatë të librit të tij të titulluar “Vështirësitë e Teorisë”, teoria dështoi përballë një sërë çështjesh vendimtare.

Darvini mbështeti të gjitha shpresat e tij në zbulimet e reja shkencore, të cilat shpresonte që do të zgjidhnin këto vështirësi. Mirëpo, në kundërshtim me atë që ai shpresonte, zbulimet shkencore zgjeruan përmasat e këtyre vështirësive. Disfata e darvinizmit përballë shkencës mund të përmbledhet në tre tituj kryesorë:

- 1) *Teoria nuk arrin të shpjegojë se si ka zënë fill jeta në tokë.*
- 2) *Nuk gjendet asnjë zbulim shkencor që treg evolucionit” të propozuara nga kjo teori, posedojnë*
- 3) *Të dhënat fosile provojnë pikërisht të k*



*parashtruara nga kjo teori.*

Në këtë pjesë, do të shtjellojmë në vija të përgjithshme këto tri çështje themelore:


### **Pengesa e parë e pakapërcyeshme: Zanafilla e jetës**

Teoria e evolucionit pretendon se të gjitha llojet rrjedhin nga një qelizë e vetme e shfaqur në Tokën primitive 3.8 miliardë vjet më parë. Si është e mundur që një qelizë e vetme të ndërtojë miliona lloje të gjalla e të komplikuara dhe, nëse me të vërtetë ka ndodhur diçka e tillë, përse nuk gjendet asnjë gjurmë në të dhënat fosile janë disa nga pyetjet në të cilat teoria nuk është në gjendje të jap përgjigje. Por në fillim, duhet të pyetemi: **Si u krijua kjo “qelizë e parë”?**

Meqë teoria e evolucionit e mohon krijimin dhe çfarëdo ndërhyrje të mbinatyrshe, ajo supozon se “qeliza e parë” është shfaqur rastësisht pa asnjë projektim, planifikim apo rregullim, përbrenda ligjeve të natyrës. Sipas kësaj teorie, materia e pajetë duhet të ketë krijuar rastësisht qelizën e gjallë. Por kjo hipotezë bie ndesh me ligjet më të pakundërshtueshme të biologjisë.

### **“Jeta buron nga jeta”**

Në librin e tij, Darvini nuk ka folur kurrë mbi zanafillën e jetës. Kuptimi primitiv i shkencës në kohën e tij mbështetej në supozimin se gjallesat kishin një përbërje shumë të thjeshtë. Që nga mesjeta, krijimi spontan, sipas të cilit lëndët e pajetë u bashkuan për të formuar organizma të gjallë, ishte një gjë e pranuar botërisht. Përgjithësisht besohej se insektet krijoheshin



nga tepricat e ushqimeve, ndërsa minjtë nga gruri. Për të vërtetuar këtë teori, u bënë eksperimente interesante. Pak grurë vendosej mbi një leckë të dhe besohej që pas një kohe minjtë do të krijoheshin.

Gjithashtu, zhvillimi i krimbave në një copë mishi merrej si dëshmi e krijimit spontan. Por, **më vonë u kuptua se krimbat nuk u shfaqën vetvetiu në mish, por u bartën atje nga mizat në formë të larvave të padukshme për sy të lirë.**


Madje edhe kur Darvini shkroi librin *Origjina e Llojeve*, besimi se bakteret mund të krijoheshin nga materia e pajetë ishte një gjë e pranuar gjerësisht në botën e shkencës.

Mirëpo, **5 vite pas botimit të librit të Darvinit, Lui Paster bëri të ditura rezultatet e tij pas shumë studimeve dhe eksperimenteve të gjata, që hodhën poshtë krijimin spontan, një gur-themel të teorisë së Darvinit.** Në ligjëratën e tij triumfale në Sorbonë në vitin 1864, *Pasteri tha: "Kurrë më nuk do të rimarr veten krijimi spontan prej goditjes vdekjeprurëse të dhënë nga ky eksperiment i thjeshtë."*<sup>25</sup>

Mbrojtësit e teorisë së evolucionit i kundërshtuan për një kohë të gjatë këto zbulime. Mirëpo, pasi që zhvillimi i shkencës shpalosi ndërtimin kompleks të qelizës së një qenie të gjallë, ideja se jeta mund të krijohej rastësisht hasi në një qorrsokak edhe më të madh.

### **Përpjekjet e pafrytshme të shekullit njëzet**

Evolucionisti i parë, i cili u mor me çështjen e zanafillës së jetës në shekullin e njëzet ishte biologu i njohur rus Aleksandër Oparin, i cili u mundua të provonte, me anë të një sërë tezash të hedhura nga vetë ai në vitet 1930, se qeliza e gjallë mund të krijohej rastësisht. Por këto punime do të dilnin të pasuksesshme



dhe Oparin do të detyrohej ta bënte këtë rrëfim:

*Mirëpo, fatkeqësisht, çështja e zanafillës së qelizës përbën ndoshta pikën më të errët të gjithë studimit të evolucionit të organizmave.<sup>26</sup>*

Pasuesit evolucionist të Oparinit u munduan të bënin eksperimente për të gjetur një zgjidhje për këtë çështje. Më i njohuri nga këto eksperimente ishte ai që u ndërmor në vitin 1953 nga kimisti amerikan Stenli Miler, i cili, duke bashkuar gazrat, që ai pretendonte se kishin ekzistuar në atmosferën primitive në një ambient eksperimental dhe duke i ekspozuar ato ndaj një burimi të jashtëm energjie, Mileri formoi disa molekula organike (aminoacide) të pranishme në strukturën e proteinave.

Mezi kishin kaluar disa vite para se të zbulohesh se ky eksperiment, i cili atëherë u paraqit si një hap i rëndësishëm në emër të evolucionit, ishte i pavlefshëm, sepse atmosfera e përdorur në këtë eksperiment ishte shumë më e ndryshme nga kushtet reale të Tokës.<sup>27</sup>

Pas një periudhe të gjatë heshtjeje, Mileri pranoi se atmosfera e përdorur nga ai nuk ishte reale.<sup>28</sup>

Të gjitha përpjekjet evolucioniste që u ndërmorën gjatë shekullit të njëzet për të shpjeguar zanafillën e jetës përfunduan pa sukses. Xhefri Bada, gjeo-kimisti i njohur nga Instituti Skrips i San Diegos, në një artikull të botuar në vitin 1998 në revistën "Earth (Toka)", pranon këtë fakt:

*Sot, duke e lënë pas shekullin e njëzet, akoma përballemi me problemin më të madh të pazgjidhur që kishim kur hymë në shekullin e njëzet: Si zuri fill jeta në tokë?<sup>29</sup>*

**Ndërtimi i ndërlikuar i jetës**




Shkaku kryesor që çështja mbi zanafillën e jetës ka hyrë në një dilemë të tillë është se madje ata organizma të gjallë që mendohej të jenë më të thjeshtat kanë ndërtim jashtëzakonisht të ndërlikuar. Qeliza e një gjallese është shumë më e ndërlikuar se të gjitha produktet teknologjike që ka arritur të prodhojë njeriu. **Sot, madje edhe në laboratorët më të përparuara të botës, duke bashkuar materie kimike organike, nuk do të mund të arrijmë kurrë të përfitojmë një qelizë të vetme.**

Kushtet që nevojiten për formimin e një qelize janë aq të shumta sa kurrë nuk mund të shpjegohen me rastësi. **Probabiliteti që proteinat, njësia bazë e qelizës, të sintetizohen rastësisht është 1 në  $10^{950}$  (për një proteinë mesatare me 500 aminoacide). Në matematikë probabilitetet më të vogla se 1050 konsiderohen të pamundura.**

Molekula e ADN-së përmban informacionet gjenetike si një bankë informacionesh me kapacitet të pabesueshëm. **Nëse do ta hidhnim në letër informacionin që përfshin ADN-ja e njeriut, do të krijohet një bibliotekë me 900 volume enciklopedike me nga 500 faqe secili.**

Në këtë pikë shfaqet një dilemë shumë interesante: ADN-ja mund ta kopjoj/përsëris vetveten vetëm me ndihmën e disa proteinave të specializuara (enzimave). Mirëpo, sinteza e këtyre enzimave mund të realizohet vetëm me anë të informacionit të koduar në ADN. Pasi që ato të dyja janë të varura nga njëra tjetra, ato duhet të ekzistojnë në të njëjtën kohë për kopjim/përsëritje. Kjo e sjellë skenarin se jeta ka zënë fill vetvetiu në një rrugë pa krye. Prof. Lesli Orgel, një evolucionist me reputacion nga Universiteti i San Diegos në Kaliforni, e pranon këtë fakt në botimin e revistës *Scientific American* të Shtatorit të vitit 1994:

*Është krejtësisht e pamundshme që proteinat dhe acidet nuk-*



*leike, duke qenë të dyja komplekse për nga ndërtimi, të jenë krijuar vetvetiu në të njëjtin vend dhe në të njëjtën kohë. Po ashtu duket e pamundshme ta kemi njëzën pa tjetrën. Dhe kështu, në shikim të parë, njeriut do t'i duhej të vjen në përfundimin se, në të vërtetë, jeta kurrë nuk ka mundur të zë fill me anë të mjeteve kimike.<sup>30</sup>*


Padyshim, nëse është e pamundur që jeta të ketë zënë fill nga shkaqet natyrore, atëherë duhet të pranohet se jeta u “**krijua**” në mënyrë të mbinatyrshme. Ky fakt zhvlerëson në mënyrë të qartë teorinë e evolucionit, qëllimi kryesor i së cilës është të mohoj krijimin.

### **Mekanizmat imagjinarë të evolucionit**

Çështja e dytë e rëndësishme që e bën teorinë e Darvinit të pavlefshme është se të dy konceptet e paraqitura nga kjo teori si “mekanizma të evolucionit”, u kuptua se në të vërtetë nuk zotërojnë asnjë forcë evoluese.

Darvini e mbështeti hipotezën e tij në tërësi në mekanizmin e “seleksionimit natyror.” Rëndësia që i jepte këtij mekanizmi mund të kuptohet fare lehtë edhe nga titulli i librit të tij: Origjina e Llojeve nëpërmjet seleksionimit natyror”...

Seleksionimi natyror pohon se ato gjallesa që janë më të fuqishme dhe që i përshtaten më mirë kushteve natyrore të vendbanimeve të tyre do të mbijetojnë në luftën për jetë. P.sh., në një kope sorkadhesh që kërcënohet prej kafshëve të ndryshme grabitqare, do të mbijetojnë vetëm ato sorkadhe që vrapojnë më shpejt. Kështu që kopeja e sorkadheve do të përbëhet nga individët më të fortë dhe më të shpejtë. Mirëpo, sigurisht që ky mekanizëm nuk mund të shkaktojë evoluimin e sorkadheve e t'i kthejë në një lloj tjetër gjallese, për shembull, në kuaj.



Për këtë arsye, **mekanizmi i seleksionimit natyror nuk zotëron asnjë forcë evoluese. Edhe Darvini ishte i ndërgjegjshëm për këtë realitet**, ndaj në librin e tij *Origjina e Llojeve* u detyrua të pohonte:


*Seleksionimi natyror s'mund të bëjë asgjë përderisa nuk shfaqen dallime dhe ndryshime të dobishme individuale.*<sup>31</sup>

### **Ndikimi i Lamarkut**

Si mund të formoheshin këto ndryshime të dobishme? Darvini, kësaj pyetjeje u mundua t'i përgjigjej nga këndvështrimi i të kuptuarit primitiv të shkencës së asaj kohe. Sipas biologut francez Shevalie Lamark (1774-1829), i cili ka jetuar para Darvinit, gjallesat ia përcollën brezit pasardhës të gjitha ndryshimet fizike, të cilat kishin fituar gjatë jetës së tyre. Ai pohonte se këto cilësi, të cilat u akumuluan nga një brez në tjetrin, bënë që të formohen lloje të reja. Për shembull, ai pohonte se gjirafat evoluuan nga antilopat gjatë përpjekjeve të tyre për të arritur gjethet e pemëve të larta, qafat e tyre u zgjatën nga njëri brez në tjetrin

Edhe Darvini ka dhënë shembuj të ngjashëm. Në librin e tij *Origjina e Llojeve*, për shembull, ai thotë se disa arinj për të gjetur ushqim në thellësi të detit me kohë u shndërruan në balena.<sup>32</sup>

Por zbulimet e Gregor Mendelit (1822-1884) të ligjeve të trashëgimisë, të cilat u saktësuan nga shkenca e gjenetikës, e cila lulëzoi në shekullin e njëzet, hedhën poshtë plotësisht legjendën e përcjelljes së karakteristikave të fituara në brezat pasardhës. Kështu, u vërtetua përfundimisht se seleksionimi natyror ishte një mekanizëm joefikas.



## Neo-darvinizmi dhe mutacionet


Për të gjetur një zgjidhje, darvinistët nxorën në dritë “Teorinë Sintetike Moderne”, apo siç njihet ndryshe Neo-Darvinizmin, në fund të viteve 1930. Neo-Darvinizmi shtoi mutacionet, të cilat janë shtrembërime të formuara në gjenet e gjallesave për shkak të faktorëve të tillë të jashtëm si rrezatimi apo gabimet në përsëritje, si “shkaqe të ndryshimeve të dobishme” përveç mutacionit natyror.

Modeli, i cili edhe sot e ruan vlerën në emër të evolucionit, është Neo-Darvinizmi. Sipas kësaj teorie miliona gjallesa në botë u formuan si rezultat i një procesi me anën e të cilit organe të shumta komplekse të këtyre organizmave (p.sh, veshët, mushkëritë dhe krahët) iu nënshtruan “mutacioneve,” domethënë çrregullimeve gjenetike. Por ekziston një fakt i prerë shkencor që plotësisht e hedh poshtë këtë teori: **Mutacionet nuk i zhvillojnë gjallesat, përkundrazi, ato janë gjithmonë të dëmshme.**

Arsyeja për këtë është shumë e thjeshtë: **ADN-ja ka një ndërtim shumë të ndërlëkuar dhe çdo ndikim spontan mbi këtë molekulë, mund vetëm t’i shkaktojë dëm asaj.** Gjeneticisti amerikan B. G. Ranganathan e shpjegon këtë fakt si në vazhdim:

*Së pari, mutacionet e vërteta janë shumë të rralla në natyrë. Së dyti, shumica e mutacioneve janë të dëmshme pasi që janë të rastësishme, më parë se ndryshime të rregullta në strukturën e gjeneve; çfarëdo ndryshimi i rastësishëm në një sistem tejet të rregullt do të ndikojë për të keq, jo për të mirë. Për shembull, nëse një tërmet do të dridhte një ndërtim tejet të rregullt siç është një ndërtesë, do të ndodhte një ndryshim i rastësishëm në kornizën e ndërtesës, i cili sipas të gjitha gjasave, nuk do të ishte një përmirësim.<sup>33</sup>*

Nuk çudit fakti se deri më sot nuk është vëzhguar asnjë rast





i ndonjë mutacioni të dobishëm, domethënë, i cili është parë të zhvilloj kodin gjenetik. Është vërtetuar se të gjitha mutacionet janë të dëmshme. Është kuptuar se mutacioni, i cili është paraqitur si një “mekanizëm i evolucionit,” është në të vërtetë një dukuri gjenetike që dëmton gjallesat dhe i lë të gjymtuara. (Efekti më i zakonshëm i mutacionit në qeniet njerëzore është kanceri.) Natyrisht, një mekanizëm shkatërrues nuk mund të jetë “mekanizëm evolutiv.” Seleksionimi natyror, në anën tjetër, “s’mund të bëj asgjë i vetëm,” siç e pranoi edhe Darvini. Ky fakt na tregon se **nuk ekziston ndonjë “mekanizëm evolutiv” në natyrë.** Pasi që nuk ekziston asnjë mekanizëm evolutiv, asnjë proces i tillë i imagjinuar i quajtur “evolucion” nuk ka mundur të ndodhë.


### **Të dhënat fosile: asnjë gjurmë e formave kalimtare**

Të dhënat fosile janë treguesi më i qartë se skenari që sugjerohet nga teoria evolucionit nuk ka ndodhur kurrë.

Sipas kësaj teorie, të gjitha gjallesat kanë evoluar nga një paraardhës. Një lloje, e cila ekzistonte më parë, me kalimin e kohës, u shndërrua në diçka tjetër dhe të gjitha llojet u krijuan në këtë mënyrë. Me fjalë të tjera, ky transformim u zhvillua gradualisht gjatë një periudhe të gjatë prej qindra miliona vjetësh.

Po të kishte qenë kështu, lloje të shumta kalimtare duhej të kishin ekzistuar dhe jetuar brenda kësaj periudhe të gjatë transformimi.

Për shembull, disa krijesa gjysmë peshk–gjysmë zvarranik duhej të kishin jetuar në të kaluarën të cilat kishin fituar disa tipare zvarranikësh, përveç tipareve të peshkut të cilat ato




tashmë i kishin. Apo duhej të kishin ekzistuar disa zvarranik-zogj, të cilët fituan disa tipare të zogjve përveç tipareve të zvarranikëve që ato tashmë i kishin. Meqë këto gjallesa do të duhej të kishin ekzistuar në një periudhë kalimtare, gjallesat duhet të kenë qenë të gjymtuara dhe me një sërë të metash. Evolucionistët, këto qenie imagjinare që besojnë të kenë jetuar në të kaluarën, i quajnë “forma kalimtare”.

**Nëse me të vërtetë do të kishin ekzistuar gjallesa të tilla në të kaluarën, atëherë do të duhej të kishte me miliona dhe madje miliarda sosh për nga numri dhe llojllojshmëria. Ajo që është më me rëndësi, mbetjet e këtyre qenieve të çuditshme do të duhej të haseshin në të dhënat fosile. Darvini, në librin Origjina e Llojeve, këtë fakt e shpjegon kështu:**

*Nëse teoria ime është e vërtetë, atëherë forma kalimtare të panumërta që lidhin llojet e të njëjtit grup, duhet të kenë ekzistuar sigurisht... Si rrjedhim, provat për ekzistencën e tyre të mëparshme do të mund të gjendeshin vetëm në mbetjet fosile.”<sup>34</sup>*

Megjithatë, **Darvini ishte më se i vetëdijshëm se ende nuk ishin gjetur fosile të këtyre formave të ndërmjetme. Ai e konsideronte këtë si pengesë madhore për këtë teori. Në një kapitull të librit të tij të titulluar “Vështirësitë e Teorisë,” ai shkroi:**

*Përse, nëse llojet kanë prejardhje nga llojet tjera përmes ndryshimeve delikate graduale, nuk shohim gjithandej forma të panumërta kalimtare? Përse nuk është e gjithë natyra në rrëmuje në vend se llojet të jenë, siç i shohim, të definuara mirë? ... Por, pasi që sipas kësaj teorie duhet të kenë ekzistuar forma të panumërta kalimtare, përse nuk i gjejmë ato të ngulitura në koren e tokës? ... Përse atëherë nuk është çdo formacion gjeologjik dhe çdo shtresë përplot me hallka të tilla kalimtare? Gjeologjia sigurisht nuk zbu-*



*lon çfarëdo zinxhiri të tillë organik të shkallëzuar në mënyrë të përsosur; dhe kjo, mbase, është kundërshtimi më i dukshëm dhe më serioz që mund t'i bëhet teorisë sime.*<sup>35</sup>

## **Shpresat e venitura të Darvinit**


Mirëpo, edhe pse janë bërë shumë kërkime intensive për të gjetur fosilet që nga mesi i shekullit të nëntëmbëdhjetë në mbarë botën, **ende nuk është gjetur asnjë formë kalimtare.** Të gjitha fosilet, në kundërshtim me atë që shpresonin evolucionistët, tregojnë se **jeta në Tokë u shfaq krejt papritur dhe plotësisht e formuar.**

Një paleontolog i njohur britanik, Derek V. Ager, edhe pse një evolucionist, e pranon këtë realitet:

*Problemi ynë është ky: Tek analizojmë me hollësi të dhënat fosile në nivelin e klasave apo llojeve, **hasim gjithnjë e më tepër jo në evolucion gradual, por në shpërthim të papritur të një lloji në llogari të një tjetri.***<sup>36</sup>

Me fjalë të tjera, te **fosilet e gjetura, të gjitha llojet e gjallesave shfaqen papritmas dhe në formën e tyre të plotë, pa asnjë formë të ndërmjetme në mes.** Kjo është pikërisht e kundërta e supozimeve të Darvinit. Për më tepër, kjo është një provë shumë e fortë që **të gjitha gjallesat janë krijuar.** I vetmi shpjegim që një lloj i gjallë të shfaqet papritmas i plotë dhe pa paraardhës nga i cili të ketë evoluar është se ai u krijua. Kjo e vërtetë është pranuar po ashtu nga biologu i mirënjohur evolucionist Daglas Futujuma:

*Krijimi dhe evolucionin janë dy shpjegimet e vetme që mund të bëhen rreth origjinës së qenieve të gjalla. Krijimi dhe evolucionin, në mes tyre, shter shpjegimet e mundshme për zanafillën e gjallesave. Orga-*



nizmat ose janë shfaqur në tokë të zhvilluara plotësisht, ose jo. Në rast se nuk janë zhvilluar gradualisht, ato duhet të jenë zhvilluar nga lloje që kanë ekzistuar më parë me anë të ndonjë procesi modifikimi. Në rast se janë shfaqur plotësisht të zhvilluara, ato me të vërtetë duhet të jenë krijuar nga ndonjë intelekt i plotfuqishëm.<sup>37</sup>


**Fosilet tregojnë se qeniet e gjalla u shfaqën në Tokë të formuara plotësisht dhe në gjendje të përkryer.** Me fjalë të tjera “origjina e llojeve,” në kundërshtim me supozimin e Darvinit, nuk është evolucioni, por **Krijimi**.

### **Përralla e evolucionit të njeriut**

Çështja që trajtohet më shpesh nga mbrojtësit e teorisë së evolucionit është prejardhja e njeriut. Mendimi darvinist mbi këtë çështje thotë se qeniet njerëzore moderne që jetojnë sot kanë evoluar nga disa krijesa të ngjashme me majmunët. Gjatë kësaj periudhe të supozuar, e cila mendohet të ketë filluar rreth 4-5 milionë vjet më parë, pretendohet se kanë jetuar “forma kalimtare” midis njeriut modern dhe të parëve të tij. Ka katër “kategoritë” bazë në gjithë këtë skenar të imagjinuar:

1. Australopiteku
2. Homo habilis
3. Homo erectus
4. Homo sapiens

Evolucionistët i japin emrin “*Australopitek*” (që do të thotë “majmuni i jugut”), të ashtuquajturit paraardhës të parë të njeriut të ngjashëm me majmunët. Këto qenie të gjalla nuk janë në fakt asgjë tjetër, përveçse një lloje e zhdukur majmuni. Kërkimet e shumta të Lordit Solli Cukerman dhe Profesorit Çarlls Oksnard, dy anatomistë me famë botërore nga Anglia dhe SHBA-ja, rreth mbetjeve të australopitekëve tregojnë se këto




qenie i përkisnin një lloji të majmunit të zhdukur dhe se nuk kishin asnjë ngjashmëri me qeniet njerëzore.<sup>38</sup>

Evolucionistët e quajnë fazën tjetër të evolucionit njerëzor “*homo*,” domethënë “njeri”. Sipas këtij pretendimi, qeniet e gjalla të serisë “*homo*” ishin më të zhvilluara se *australopitekët*. Evolucionistët i vendosën fosilet e këtyre krijesave të ndryshme pranë njëra-tjetrës me një renditje të caktuar dhe përpiluan një plan imagjinar evolucioni. Ky plan është imagjinar, sepse faktikisht asnjë lidhje evolucionare mes këtyre klasave të ndryshme nuk është provuar. Ernst Majer, njëri prej mbrojtësve më të rëndësishëm të teorisë së evolucionit në shekullin e njëzet në librin e tij *Një argument i gjatë pohon se: “në veçanti (enigmat) historike si zanafilla e jetës apo e Homo sapiensit, janë tejet të vështira dhe mund madje t’i bëjnë ballë një shpjegimi përfundimtar të kënaqshëm.”*<sup>39</sup>

Kur konturojnë zinxhirin *Australopitek > Homo Habilis > Homo Erektus > Homo Sapiens*, evolucionistët nënkuptojnë se këto lloje kanë qenë paraardhëse të njëra-tjetrës. Mirëpo, zbulimet më të fundit të paleo-antropologëve tregojnë se *Australopiteku, Homo Habilis dhe Homo Erektus* kanë jetuar në të njëjtën periudhë në pjesë të ndryshme të botës.<sup>40</sup>

Për më tepër, një segment i caktuar njerëzish i klasifikuar si *Homo Erektus* ka jetuar deri në kohërat moderne. *Homo sapiens, Neandertalët dhe Homo Sapiens Sapiens (njeriu modern) kanë bashkëjetuar në të njëjtin rajon.*<sup>41</sup>

Kjo, sigurisht, provon përfundimisht se këto lloje nuk ishin paraardhëse të njëra-tjetrës. Stefën Xhej Gold, njëri prej paleontologëve të universitetit të Harvardit, megjithëse është evolucionist, e shpjegon qorrkakun në të cilin gjendet teoria darviniste në këtë mënyrë:




*Çfarë i ndodhi shkallës sonë, nëse bashkekzistojnë tri linja hominide (A. Afrikanus, Robust Australopitekët robust (shtatmëdhenj) dhe H. Habilis) që nuk rrjedhin nga njëra-tjetra? Për më tepër, asnjë nga të tre nuk shfaq ndonjë tendencë evolutive gjatë qëndrimit të tyre në tokë.<sup>41</sup>*

Me pak fjalë, i gjithë skenari i evolucionit njerëzor që po mbahet gjallë me ndihmën e vizatimeve të ndryshme të krijesave imagjinare “gjysmë-majmun-gjysmë-njeri”, që shfaqen në media apo libra shkollorë, domethënë, sinqerisht, me anë të metodave propagandistike, s’janë gjë tjetër veçse **një mit pa asnjë bazë shkencore.**

Lordi Solli Cukerman, një nga shkencëtarët më të njohur dhe më të spikatur të Mbretërisë së Bashkuar, e ka studiuar këtë çështje për vite me radhë dhe ka kryer një punë kërkimore 15-vjeçare mbi fosilet e Australopitekut. Edhe pse evolucionist, ai arriti në përfundimin se, në të vërtetë, **nuk ekziston asnjë pemë gjenealogjike midis majmunit dhe njeriut.**

Cukerman gjithashtu bëri një “spektër interesant të shkencave”, duke i radhitur ato nga ato që ai i konsideronte si më shkencoret tek ato që i konsideronte si më joshkencoret. Sipas spektrit të Cukermanit, më “shkencoret,” duke marrë parasysh mbështetjen e tyre në argumente, janë shkenca e fizikës dhe kimisë. Më pas vijnë shkencat biologjike dhe pastaj shkencat shoqërore. Në fund fare, në pjesën që konsiderohet të jetë si pjesa më “joshkencore”, radhitet “perceptimi jashtë-shqisor” – konceptet si telepatia dhe shqisa e gjashtë – dhe në fund të fundit u vendos “evolucionit i njeriut”. Cukerman shpjegon kështu arsyetimin e tij:

*Më pas zhovendosim regjistrin e të vërtetës objektive në drejtim të atyre fushave të shkencës të konsideruara si shkenca biologjike, si*



*p.sh. perceptimi jashtë-shqisor apo interpretimi i historisë së fosileve të njeriut, ku për (evolucionistin) besnik gjithçka është e mundur – dhe ku besimtari i zjarritë (i evolucionit ndonjëherë është në gjendje të besojë shumë gjëra kontradiktore në të njëjtën kohë.<sup>43</sup>*


**Përralla për evolucionin njerëzor** nuk është gjë tjetër veçse një përmbledhje e “disa interpretimeve të paragjykuara të fosileve të zhvarrosura prej njerëzve të caktuar, të cilët ndjekin verbërisht teorinë e tyre.

### **Formula e Darvinit!**

Përveç të gjitha provave teknike me të cilat jemi marrë gjer më tani, le ta shtjellojmë njëherë, se çfarë paragjykimi kanë evolucionistët me një shembull të thjeshtë që të kuptohet madje edhe prej fëmijëve:

Teoria e evolucionit pohon se jeta u krijua rastësisht. Sipas këtij pohimi, atomet e pajetë dhe të pavetëdije u bashkuan për të formuar qelizën dhe pastaj ata disi formuan gjallesat tjera, duke përfshirë edhe njeriun. Le të mendojmë për këtë. Kur i bashkojmë elementet që janë bazë e ndërtimit jetës si karboni, fosfori, nitrogjeni dhe potasiumi, vetëm një grumbull formohet. Pa marrë parasysh se çfarë trajtimi i nënshtrohet, ky grumbull atomev nuk mund të formojë madje as edhe një gjallesë të vetme. Nëse dëshironi, le ta formulojmë një “eksperiment” në lidhje me këtë çështje dhe ta shtjellojmë në emër të evolucionistëve atë që ata vërtet e pohojnë pa e shprehur zëshëm me emrin **“formula e Darvinit”**:


Le të vendosin materialistët plot materiale të pranishme në përbërjen e gjallesave si fosfori, nitrogjeni, karboni, oksigjeni, hekuri dhe magnezi në fuçi të mëdha. Veç kësaj, le të shtojnë në këto fuçi çfarëdo lloj materiali që nuk ekziston në kushte



normale, por që ata mendojnë se është i domosdoshëm. Le të shtojnë në këtë përzierje aq sa të dëshirojnë amino acide – të cilat nuk kanë mundësi të formohen në kushte natyrore – dhe proteina – që një e vetme e ka probabilitetin e formimit 10 në 950 – sa të duan. Le t'ia ekspozojnë këto përzierje deri në masën që dëshirojnë nxehtësisë dhe lagështisë. Le t'i përziejnë këto me çfarëdo pajisje të përparuar teknologjike që të duan. Le t'i vënë shkencëtarët më të shquar pranë këtyre fuçive. Le të presin këta ekspert me radhë pranë këtyre fuçive për miliarda dhe trilionë vite. Le të lejohen të përdorin të gjitha llojet e kushteve që ata besojnë të jenë të domosdoshme për formimin e një njeriu. **Pa marrë parasysh se çfarë bëjnë, ata nuk mund ta krijojnë një njeri prej këtyre fuçive, të themi një profesor që ekzaminon strukturën e qelizës së tij nën një mikroskop elektronik.** Ata nuk mund të krijojnë gjirafa, luanë, bletë, kanarina, kuaj, delfinë, trëndafila, orkide, zambakë, karafila, banane, portokaj, molla, hurma, domate, pjepja, shalqi, fiq, ullinj, rrush, pjeshka, pallonj, fazanë, flutura shumëgjyreshe apo me miliona gjallesa si këto. Me të vërtetë, ata nuk do të mund të përfitonin as edhe një qelizë të vetme prej cilëso prej tyre.

Thënë shkurt, **atomet e pavetëdijshme nuk mund të formojnë qelizën** duke u bashkuar. Ato nuk mund të marrin një vendim të ri dhe ta ndajnë këtë qelizë më dysh dhe pastaj të marrin vendime tjera dhe të krijojnë profesorët të cilët së pari shpikin mikroskopin elektronik dhe pastaj ekzaminojnë strukturën e qelizës së vet nën atë mikroskop. **Materia është një grumbull i pavetëdijshëm, i pajetë dhe ajo vjen në jetë me krijimin e lartë të All-llahut.**

Teoria e evolucionit, e cila pohon të kundërtën e kësaj, është një gjykim plotësisht i gabuar i kundërt me arsyen. Të menduarit





madje edhe vetëm për pak kohë për pohimet e evolucionistëve zbulon këtë të vërtetë, sikurse në shembullin më lartë.


### **Teknologjia e syrit dhe veshit**

Një çështje tjetër që mbetet pa përgjigje nga teoria e evolucionit është cilësia e shkëlqyer e perceptimit të syrit dhe veshit.

Para se të kalojmë te syri, le t'i përgjigjemi shkurtimisht pyetjes "Si shohim ne?" Rrezet e dritës që vijnë nga një objekt, bien në retinën e syrit duke dhënë një imazh të përmbysur të objektit. Këtu, këto rreze drite transformohen në sinjale elektrike nga qelizat dhe pastaj përcillen në një zonë të vogël në pjesën e prapme të trurit, ku ndodhet "qendra e shikimit". Këto sinjale elektrike perceptohen në këtë qendër të trurit si imazh pas një sërë procesesh. Le të mendojmë pak, duke u bazuar në këto njohuri teknike.

**Truri është i izoluar tërësisht nga drita.** Kjo do të thotë se pjesa e brendshme e trurit është në errësirë të plotë dhe drita nuk arrin atje. Qendra e shikimit është një vend në errësirë të plotë ku nuk hyn kurrë dritë. Ka mundësi që të jetë vendi më i errët që ekziston. Megjithatë, ne shikojmë një botë të ndritshme plot dritë në këtë errësirë të plotë.

**Imazhi i formuar në sy është kaq i mprehtë dhe i qartë, sa që as teknologjia e shekullit njëzet nuk ka arritur ta realizojë.** Për shembull, shikoni librin që jeni duke e lexuar, duart me të cilat e mbani atë dhe pastaj ngrini kokën dhe shikoni përreth. A keni parë ndonjëherë një imazh të tillë të mprehtë e të qartë si ky në ndonjë vend tjetër? Edhe ekrani më i zhvilluar i televizorit i prodhuar nga prodhuesi më i fuqishëm i televizorëve në botë nuk mund të sigurojë një imazh aq të mprehtë për ju. Ky është




një imazh tre-dimensional, me ngjyra dhe jashtëzakonisht i pastër. Për vite të tëra, mijëra inxhinierë janë përpjekur të prodhojnë një televizor tre-dimensional, i cili mund të arrijë cilësinë e shikimit të syrit. Ata kanë arritur të shpikin një sistem TV tre-dimensional, por ai nuk mund të shihet pa vendosur një palë syze speciale 3-D. Për më tepër, bëhet fjalë vetëm për një tre-dimensional artificial. Sfondi është më i mjegulluar, ndërsa plani i parë duket sikur është dekor prej letre. Asnjëherë s'ka qenë e mundur të arrihet një imazh me cilësinë e syrit. Edhe në kamera apo në televizor, ka një humbje të cilësisë së imazhit.

Evolucionistët pretendojnë se mekanizmi që prodhon këtë imazh të mprehtë e të qartë është formuar krejt rastësisht. Nëse dikush do t'ju thoshte se televizori në dhomën tuaj është formuar si rezultat i bashkimit të rastësishëm të miliona atomeve, çfarë do të mendonit ju? Si mund ta bëjnë atomet atë që mijëra njerëz s'e bëjnë dot?

Nëse një pajisje që prodhon një imazh më primitiv se syri nuk mund të jetë formuar rastësisht, atëherë është shumë e qartë që edhe **syri apo imazhi që shikohet prej tij nuk mund të jenë krijuar rastësisht**. E njëjta gjë vlen edhe për veshin. Veshi i jashtëm i kap tingujt dhe i drejton te veshi i mesëm, i cili ia përcjell veshit të brendshëm duke i përforcuar ato. Veshi i brendshëm ia dërgon valët zanore trurit, duke i kthyer në sinjale elektrike. Ashtu si me shikimin, procesi i dëgjimit përfundon në qendrën e dëgjimit në tru.

Ajo që thamë për syrin është e vërtetë edhe për veshin. Do të thotë, **truri është i izoluar nga tingujt**, ashtu si është i izoluar edhe nga drita: asnjë tingull nuk mund të depërtojë brenda. Prandaj, s'ka rëndësi sa zhurmë ka jashtë, brenda trurit mbizotëron një qetësi absolute. Megjithatë edhe tingujt më të




mprehtë perceptohen nga truri. Në trurin tuaj, i cili është i izoluar nga tingujt, ju dëgjoni simfoninë e ekzekutuar nga një orkestër apo zhurmat në një vend të mbushur plot me njerëz. Megjithatë, nëse bëhet një matje ekzakte e nivelit të tingujve në trurin tonë në këto momente, do të kuptonim se një qetësi absolute mbizotëron aty.

Ashtu si në rastin e imazhit, dekada të tëra përpjekjesh kanë kaluar për të krijuar dhe riprodhuar tinguj sa më të afërt me origjinalin. Rezultatet e këtyre përpjekjeve janë regjistruarit e zërit, sistemet HI-FI dhe sistemet e ndryshme për kapjen e tingujve. Pavarësisht nga teknologjia e përparuar dhe përpjekjet e mijëra inxhinierëve e ekspertëve, nuk është përfutur asnjë tingull që të ketë të njëjtën mprehtësi dhe qartësi si tingulli që kapet nga veshi. Mendoni për sistemet HI-FI të cilësisë më të lartë të prodhuar nga kompania më e madhe e industrisë së muzikës. Edhe në këto pajisje, kur regjistrohet zëri, humbet një pjesë e cilësisë. Kur ndizni një HI-FI gjithmonë dëgjoni një zhurmë të lehtë para se të fillojë muzika. Veshi i njeriut asnjëherë nuk e kap një tingull të shoqëruar me zhurmë; ai e kap tingullin pikërisht ashtu siç është, i mprehtë e i qartë. Kështu ka qenë gjithmonë që nga **krijimi i njeriut**.

Deri më sot, asnjë aparat vizual apo regjistruar i bërë nga njeriu nuk ka qenë aq i ndjeshëm dhe i suksesshëm në marrjen e të dhënave shqisore si syri dhe veshi. Mirëpo, për sa i përket të pamurit dhe të dëgjuarit, një e vërtetë shumë më madhështore qëndron pas gjithë kësaj.

### **Kujt i takon ndërgjegjja që sheh dhe dëgjon në brendi të trurit?**

Kush shikon një botë joshëse në trurin tonë, dëgjon simfonitë dhe cicërimën e zogjve dhe ndien aromën e trëndafilin?




Nxitjet që vijnë prej syve, veshëve dhe hundës së një personi shkojnë në tru si impulse nervore elektro-kimike. Në librat e biologjisë, fiziologjisë dhe biokimisë, mund të gjeni shumë hollësi për mënyrën se si ky imazh formohet në tru. Mirëpo, kurrë nuk do të mund të ndesheni me faktin më të rëndësishëm: Kush i pranon këto impulse nervore elektro-kimike si imazhe, tinguj, aroma dhe ngjarje shqisore në tru? **Ekziston një ndërgjegje në tru që i pranon gjithë këto pa ndier ndonjë nevojë për një sy, vesh apo hundë.** Kujt i takon kjo ndërgjegje? Natyrisht se nuk u takon nervave, shtresës yndyrore dhe neuroneve që e përbëjnë trurin. Kjo është arsyeja pse darvinistët-materialist, të cilët besojnë se gjithçka përbëhet prej materies, nuk mund të japin përgjigje në këto pyetje.

Sepse **kjo ndërgjegje është shpirti i krijuar prej All-llahut**, i cili nuk ka nevojë as për syrin për të shikuar imazhet dhe as për veshin për t'i dëgjuar tingujt. Për më tepër, nuk ka nevojë për trurin për të menduar.

Çdo njeri që e lexon këtë fakt të qartë shkencor do të duhej të mendonte thellë për All-llahun e Gjithëfuqishëm dhe të ketë frikë dhe të kërkoj strehim tek Ai, sepse Ai ngjesh tërë gjithësinë në një vend plotësisht të errët prej disa centimetrave kub në një formë tre-dimensionale, me ngjyra, me hije dhe të ndritshme.

### **Një besim materialist**

Informacioni që kemi paraqitur deri tani tregon se **teoria e evolucionit është një pretendim që bie hapur në kundërshtim me faktet shkencore.** Pretendimi i teorisë në lidhje me prejardhjen e jetës është në kundërshtim me shkencën, mekanizmat e evolucionit të propozuara nga kjo teori nuk kanë asnjë forcë evolutive, dhe fosilet tregojnë se **format kalimtare**




**nuk kanë ekzistuar kurrë.** Prandaj, teoria e evolucionit duhet të hidhet poshtë si një ide joshkencore. Në këtë mënyrë shumë ide, si modeli i gjithësisë me qendër Tokën, janë nxjerrë jashtë agjendës së shkencës gjatë historisë.

Por teoria e evolucionit vazhdon të mbahet me vendosmëri në listën e teorive shkencore. Disa njerëz madje përpiqen t'i paraqesin kritikën në adresë të saj si "sulm ndaj shkencës". Po pse ndodh kjo gjë?

Arsyeja është se kjo teori është situatë të krijuar është një besim dogmatik i domosdoshëm për disa qarqe. Këto qarqe janë verbërisht besnike ndaj filozofisë materialiste dhe e pranojnë darvinizmin sepse ai është shpjegimi i vetëm materialist që mund të prezantohet për të shpjeguar funksionimin e natyrës.

*Nuk është puna se metodat dhe institucionet e shkencës në njëfarë mënyre na detyrojnë të pranojmë një shpjegim material për botën, por përkundrazi, ne jemi të detyruar nga përkrahja jonë arbitrare e kauzës materialiste të krijojmë një aparat hetimi dhe një sërë konceptesh që japin shpjegime materiale, edhe nëse janë kundër intuitës, pa marrë parasysh se sa të mjegullta janë për të panisurën. Për më tepër, materializmi është absolut, kështu që ne nuk mund të lejojmë të dalë në skenë një Qenie Hyjnore.<sup>44</sup>*

Këto fjalë janë deklarata të qarta se **Darvinizmi është një dogmë** e mbajtur gjallë për hir të lidhjes me filozofinë materialiste. Sipas kësaj dogme asgjë nuk ekziston përveç materies. Prandaj, ajo predikon se materia e pajetë dhe e pavetëdijshme krijoi jetën. Ajo këmbëngul se miliona lloje të gjalla, (si zogjtë, peshqit, kafshët, insektet, pemët, lulet, balenat dhe qeniet njerëzore) u shfaqën si pasojë e bashkëveprimit të materies si shiut, rrufeve dhe kështu me radhë prej materies së pajetë. Ky besim është në kundërshtim të plotë si me arsyen




ashtu edhe shkencën. Por darvinistët vazhdojnë të mbrojnë këtë besim me qëllim që “të mos lejojnë daljen në skenë të një Qenie Hyjnore.”

Kushdo që nuk e shikon prejardhjen e gjallesave me paragjykim materialist do ta kuptojë këtë të vërtetë të qartë: **të gjitha gjallesat janë rezultat i krijimit të një Krijuesi**, i Cili zotëron fuqi, dije dhe inteligjencë superiore. **Ky Krijues është All-Ilahu**, i Cili krijoi tërë gjithësinë nga asgjëja, i Cili e konstruktoi atë në mënyrën më të përkryer dhe u dha formë të gjitha gjallesave.

### **Teoria e evolucionit: Magjia më e fuqishme në botë**

Çdo njeri i lirë prej paragjykimeve dhe ndikimit të çfarëdo lloj ideologjie, që përdor arsyen dhe logjikën e tij apo të saj, do të kuptojë qartë se besimi në teorinë e evolucionit, i cili na përkujton besëtytnitë e shoqërive pa dijeni të shkencës apo qytetërimit, është plotësisht i pamundshëm.

Siç u shpjegua më lartë, ata që besojnë në teorinë e evolucionit mendojnë se disa atome dhe molekula të hedhura në një fuçi të madhe do të mund të krijojnë profesorë dhe studentë universiteti që janë në gjendje të mendojnë dhe gjykojnë; shkencëtarë si Ajnshtajni dhe Galileo; artistë si Hemfri Bogart, Frenk Sinatra dhe Luçano Pavaroti; si edhe antilopa, drurë limoni dhe karafila. Për më tepër, pasi që shkencëtarët dhe profesorët të cilët besojnë në këto gjepura janë njerëz të shkolluar, është krejtësisht e arsyeshme të flitet për këtë teori si për “magjinë më të fuqishme në histori.” Asnjëherë më parë asnjë besim apo ide tjetër nuk ua ka larguar aftësinë e të gjykuarit të njerëzve, nuk ka pranuar t’i lejojë ata të mendojnë



me mençuri dhe me arsye dhe ua ka fshehur të vërtetën sikur ata t'i kishin sytë e lidhur. Kjo është një verbëri madje edhe më e keqe dhe më e pabesueshme se adhurimi i zotit të Diellit Ra nga egjiptianët, adhurimi i totemeve në disa pjesë të Afrikës, adhurimi i Diellit nga populli i Sebes, adhurimi i idhujve që kishin mbaruar me duart e tyre nga ana e fisit të Profetit Ibrahim (paqja qoftë mbi të) apo adhurimi i Viçit të Artë nga ana e popullit të Profetit Musa (paqja qoftë mbi të).


Në të vërtetë, All-llahu ka theksuar këtë mungesë arsyeje në Kuran. Në shumë vargje, Ai zbulon se mendjet e disa njerëzve do të jenë të mbyllura dhe se ata do të jenë të pafuqishme të shohin të vërtetën. Disa nga këto vargje jepen në vazhdim:

**Sa për ata që mohojnë, njësoj është, i paralajmërove apo nuk i paralajmërove - ata nuk besojnë. All-llahu i ka vulosur zemrat e tyre, ndërsa në veshët dhe sytë e tyre kanë mbulesë; ata i pret një dënim i madh. (Surja Bekare: 6-7)**

**...ata kanë zemra, por nuk kuptojnë, kanë sy, por nuk shohin dhe kanë veshë, por nuk dëgjojnë. Ata janë si bagëtitë, madje edhe më zi. Pikërisht këta janë të shkujdesurit. (Surja A'raf: 179)**

**Edhe sikur Ne t'u hapnim atyre një derë në qiell dhe të ngjiteshin vazhdimisht lart në të (e të shihnin engjëjt e fshehtësitë), ata vetëm do të thoshin: "Neve na janë ndalë sytë (të parët). Jo, ne jemi njerëz të magjepsur. (Surja Hixhr: 14-15)**

Fjalët nuk mund ta shprehin se sa është e habitshme se si kjo magji ka arritur të mbajë një komunitet aq të gjerë në skllavëri, t'i largojë njerëzit nga e vërteta dhe të mos ndërpritet për 150 vjet. Është e kuptueshme se një apo disa njerëz do të mund të besonin



në skenarë dhe pohime të pabesueshme përplot marrëzi dhe mungesë arsyeje. Mirëpo, “magjia” është shpjegimi i vetëm i mundshëm për njerëzit në mbarë botën që besojnë se atomet e pavetëdijshme dhe të pajetë papritur vendosën të bashkohen dhe të formojnë një gjithësi që funksionon me një sistem të organizimit, rregullit, arsyes dhe vetëdijes së përkryer; një planet të quajtur Tokë me të gjitha veçoritë e saj të përshtatura në mënyrë aq të përkryer për jetën; dhe gjallesat përplot sisteme të panumërta komplekse.


Në të vërtetë, Kurani rrëfen ngjarjen e Profetit Musa dhe Faraonit për të treguar se disa njerëz të cilët përkrahin filozofitë ateiste në të vërtetë ndikojnë tek të tjerët me anë të magjisë. Kur iu tha Faraonit për fenë e vërtetë, ai i tha Profetit Musa të ndeshet me magjistarët e tij. Kur Musai e bëri këtë, ai u tha atyre që të tregojnë aftësitë e tyre të parët. Vargjet pasojnë:

**“Hidhni ju!” – u përgjigj ai. Kur magjistarët hodhën shkopinj të tyre, i magjepsën sytë e njerëzve, i frikësuan ata dhe shfaqën një magji të madhe. (Surja A’raf: 116)**

Siç kemi vënë re, magjistarët e Faraonit ishin në gjendje të mashtrojmë çdo njeri, përveç Musait dhe atyre të cilët i besuan atij. Mirëpo, dëshmia e tij zhduki magjinë, apo “gëlltiti atë që ata kishin sajuar,” siç përshkruhet në ajet.

**Atëherë Ne i kumtuam Musait: “Hidhe shkopin tënd!” - dhe ai filloi të gëlltiste gjithçka që trilluan ata. Në këtë mënyrë, doli në shesh e vërteta dhe dështoi ajo që kishin bërë ata. (Surja A’raf: 117-118)**

Siç mund të shohim, kur njerëzit e kuptuan se ata kishin qenë të magjepsur dhe se ajo që panë ishte vetëm një iluzion, magjistarët e Faraonit humbën tërë besueshmërinë. Edhe në






ditët tona po ashtu, përveç nëse ata të cilët, nën ndikimin e një magjie të ngjashme, besojnë në këto pretendime qesharake dhe kalojnë jetët e tyre duke i mbrojtur ato nën maskën e tyre shkencore, i braktisin besimet e tyre paragjykuese, ata po ashtu do të poshtërohen kur të shfaqet e vërteta e plotë dhe magjia të prishet. Në të vërtetë, Malkolm Magerixh, i cili ishte një ateist që mbrojti teorinë e evolucionit për rreth 60 vite, por i cili më pas e kuptoi të vërtetën, zbulon pozitën në të cilën do të gjendet teoria e evolucionit në të ardhmen e afërt me këto fjalë:

*Unë personalisht jam i bindur se teoria e evolucionit, posaçërisht shtrirja e zbatimit të saj, do të jetë njëra prej shakave më të mëdha në librat e historisë në të ardhmen. Brezat e ardhshëm do të çuditen se si një hipotezë aq jo bindëse dhe e dyshimtë ka mundur të pranohej me naivitetin e pabesueshëm që ajo përmban.<sup>45</sup>*

Se e ardhmja nuk është larg: Përkundrazi, njerëzit së shpejti do ta shohin se “rasti” nuk është hyjni dhe do të shikojnë prapa në teorinë e evolucionit si në mashtrimin më të keq dhe magjinë më të tmerrshme në botë. Ajo magji tashmë ka filluar të ngrihet me shpejtësi prej shpatullave të njerëzve në mbarë botën. Shumë njerëz që e shohin fytyrën e saj të vërtetë po pyeten me habi se si është e mundur që të jenë kapluar prej saj.

**“Qofsh i lavdëruar! - thanë ata -  
Ne dimë vetëm atë që na  
kemësuar Ti. Në të vërtetë,  
Ti je i Gjithëdituri, i Urti.”  
(Surja Bekare: 32)**



# SHËNIMET

1. Njoftimet dhe mësimet mbi thëniet dhe veprat e Profetit Muhammed (saas)

2. Kuptimi i vërtetë i fjalës 'Mehdi' është i Udhëzuarit dhe ky do të jetë dikush i cili, përkrah Isait (as) do të punojë ta reformojë shoqërinë drejt Islamit para Ditës së Gjykimit.

3. Transmetuar nga Ebu Hudhejfe; Sahih Buhari; *Being the Tradition of Saying and Doings of the Prophet Muhammad as Narrated by His Companions*, New Delhi, Islamic Book Service, 2002, hadith nr. 6324, 239; Tefsir Ibn Kethir, përmbledhur nga Sheikh Muhammed Nasib ar-Rafa'i, London, Al-Firdous Ltd., 1999, 176

4. Ibn Kethiri, *Tefsir el-Kur'an el-'Azim*, 1:573-576, Kairo, 1996

5. Imam Muhammed Zahid el-Keutheri, *Nazra 'Abira fi Maza'im Man Yankur Nuzul 'Profeti Isa 'alyhi al-Salam aabla al-Akhira (Një vështrim i shpejtë i pretendimeve të atyre të cilët mohojnë zbritjen e Isait para Jetës së ardhshme)*, Egjipt, 1980, f. 34-37

6. Ebu Mensur Muhammed el-Maturidi, *Kitab Tawilat al-Qur'an*, Bejrut, f. 67

7. Ibn Xherir el-Tabari, *Tafsir al-Tabari*, 3:290-291, Bejrut, 1997

8. Hamdi Jazir i Elmalit, *Hak Din Kuran Dili (Feja e vërtetë, Gjuha e Kur'anit)*, 2:1112-1113, Eser Publishing, Stamboll, 1971

9. El-Ash'ari, *Al-Ash'ari's al-Ibana 'an Usul al-Diyana*, Kairo, 1986, 2:115

10. Hasan Basri Kantaj, *Kuran-i Hakim ve Meal-i Kerim (Tafsir of the Qur'an)*, Risale Publishing, Stamboll, 1980, 1:92

11. Imam Ibn Tejmije, *Majmu' Fatawa*, trans. by Abdurrahman ibn Muhammad ibn Qasim al-Asimi an-Najdi, 4:323

12. El-Keutheri, *Nazra 'Abira fi Maza'im*, f. 93

13. Sheikh al-Islam Mustafa Sabri, *Mawqif al-'Aql (Pozita e Arsyjes)*, Bejrut, 1992, f. 233

14. Said Ramadan al-Buti, *Islam Akaidi (Katekizmi Islamik)*, Stamboll, Mavde Publishings, 1996, f. 338

15. Omer Nasuhi Bilmen, *Kuran-i Kerim'in Türkce Meali Alisi ve Tefsiri (Përkthimi në turqisht i Kur'anit Fisnik dhe komentimi i tij)*, Timas Publishing, Stamboll, botimi i 8-të, Vëllimi 7, f. 3292

16. Prof. Sulejman Ates, *Yuçe Kur'an'in Cagdas Tefsiri (Komentimi bashkëkohor i Kur'anit)*, Stamboll, 1988-1992, vol. 6, f. 4281

17. Sajjid Kutb, *Fi Zilal al-Qur'an (Nën hijen e Kur'anit)*, [www.sevde.de/](http://www.sevde.de/) Kuran-

Tevsiri/Kuran\_Tefsiri.htm

18. Imam Muhammed Zahid el-Keutheri, *Nazra 'Abira fi Maza'im Man Yankur Nuzul 'Profeti Isa 'alyhi al-Salam aabla al-Akhira (Një vështrim i shpejtë i pretendimeve të atyre të cilët mohojnë zbritjen e Isait para Jetës së ardhshme)*, Egjipt, 1980, f. 105


19. Omer Nasuhi Bilmen, *Kuran-i Kerim'in Türkce Meali Alisi ve Tefsiri (Përkthimi në turqisht i Kur'anit Fisnik dhe komentimi i tij)*, Timas Publishing, Istanbul, 8th edition, Vëllimi 7, f. 3292

20. Muhammed Khalil Herras, *Fasl al-maqal fi raf'i 'Profeti Isa hayyan ëa nuzulih'i ëa qatlih'i d-Dajjal (Zbritja e Jezusit, rigjallërimi i tij, ringjallja dhe*



- orasja e Dexhhalit nga ana e tij), Makatabat as-Sunnah, Kairo, 1990, f. 20
21. Imam et-Tabariu, *Kometi i Taberiu*, Vëll. 1, f. 247
22. Imam Ebu Hanife, *El-Fikh el-Ekber*, <http://muslim-canada.org/fiqh.htm>
23. Said-i Nursi, *Letrat, Letra e pesëmbëdhjetë*, Sozler Publishing, Stamboll, 1980, f. 54
24. Said-i Nursi, *Rrezet, Rrezja e pestë*, Sozler Publishing, Stamboll, 1980, f. 487
25. Sidney Fox, Klaus Dose, *Evolucioni molekular dhe origjina e jetës*, W. H. Freeman and Company, San Francisco, 1972, f. 4.
26. Aleksander I. Oparin, *Origjina e jetës*, Dover Publications, New York, 1936, 1953 (reprint), f. 196.
27. "Dëshmi të reja mbi evolucionin e atmosferës së hershme dhe jetës," *Buletini i Shoqatës Meteorologjike Amerikane*, vëll 63, Nëntor 1982, 1328-1330.
28. Stenli Miler, *Evolucioni molekular i jetës: Gjendja e tanishme e sintezës prebiotike të molekulave të vogla*, 1986, f. 7.
29. Xhefri Bada, *Earth*, Shkurt 1998, f. 40.
30. Lesli E. Orgel, "Origjina e jetës në tokë," *Scientific American*, vol. 271, Tetor 1994, f. 78.
31. Çarls Darvin, *Origjina e Llojeve: Një faksimile e botimit të parë me anë të seleksionimit natyror*, The Modern Library, New York, f. 127.
32. Çarls Darvin, *Origjina e Llojeve: Një faksimile e botimit të parë*, Harvard University Press, 1964, f. 184.
33. B. G. Ranganathan, *Origjina?*, Pennsylvania: Flamuri i të vërtetës besimi, 1988, f. 7.
34. Çarls Darvin, *Origjina e Llojeve: Një faksimile e botimit të parë*, f. 179.
35. Çarls Darvin, *Origjina e Llojeve*, f. 172.
36. Derek A. Ager, "Natyra e regjistrit të fosileve," *Mënyrat e veprimit të Asociacionit Gjeologjik Britanik*, vol 87, 1976, f. 133.
37. Daglas J. Futujuma, *Shkenca në provë*, Pantheon Books, Neë York, 1983, p. 197.
38. Soli Cukerman, *Matanë kullës së fildishtë*, Toplinger Publications, New York, 1970, 75-14; Çarls E. Oksnard, "Pozita e Australopitekut në Evolucionin Njerëzor: Bazë për dyshime", *Nature*, vëll 258, 389.
39. "A ka mundësi që shkencës t'i vjen fundi nga për shkak të besimit të shkencetarëve se ata kanë përgjigjet përfundimtare apo nga mosdashja e shoqërisë për t'i paguar faturat?" *Scientific American*, Dhjetor 1992, f. 20.
40. Alen Uoker, *Shkrmos*, vol. 207, 7 Mars 1980, f. 1103; A. J. Kelso, *Antropologjia Fizike*, ed. i 1rë ed., J. B. Lipincott Co., New York, 1970, f. 221; M. D. Leakey, *Olduvai Gorge*, vol. 3, Cambridge University Press, Cambridge, 1971, f. 272.
41. Xhefri Kluger, "Megjithatë jo aq të zhdukur: Homo Erektusi primitiv mund të ketë mbijetuar aq gjatë sa të bashkëjetoj me njerëzit modern," *Time*, 23 Dhjetor 1996.
42. S. J. Gold, *Natural History*, vol. 85, 1976, p. 30.
43. Soli Cukerman, *Matanë kullës së fildishtë*, f. 19.
44. Riçard Levontin, "Bota e përndjekur prej demonëve," *The New York Review of Books*, 9 Janar 1997, f. 28.
45. Malkolm Magerixh, *Fundi i Botës së Krishterë*, Grand Rapids: Eerdmans, 1980, f. 43.

# GJITHASHTU NGA HARUN JAHJA





Shumë njerëz mendojnë se Teoria e Evolucionit e Darvinit është një fakt i vërtetuar. Në kundërshtim me këtë mendësi tradicionale, zhvillimet e fundit në shkencë e përgënjeshtrojnë plotësisht këtë teori. E vetmja arsye pse Darwinizmi është ende duke u përvjedhur fshehurazi tek njerëzit nëpërmjet një fushate propaganduese mbarëbotërore qëndron në aspektet ideologjike të kësaj teorie. Të gjitha ideologjitë dhe filozofitë jofetare përipiqen të sigurojnë një bazë për veten e tyre duke u mbështetur në teorinë e evolucionit. Ky libër sqaron shembjen shkencore të teorisë së evolucionit në një mënyrë të detajuar por të lehtë për të kuptuar. Ai zbulon mashtrimet dhe shtrembërimet e bëra nga ana e evolucionistëve për ta “vërtetuar” evolucionin. Në fund ai analizon forcat dhe motivet që përipiqen ta mbajnë gjallë këtë teori dhe t’i bëjnë njerëzit të besojnë në të. Çdokush që dëshiron të mësojë për zanafillën e gjallesave, duke përfshirë edhe njerëzit, duhet ta lexojë këtë libër.

238 FAQE ME 166 FOTO ME NGJYRA

Një nga qëllimet pse është shpallur Kur’ani është të thërrasë njerëzit të mendojnë për krijimin dhe mekanizmat e tij. Kur një person vështron me kujdes vet trupin e tij apo të ndonjë gjallesë tjetër në natyrë, botën apo tërë gjithësinë, në të ai sheh një projektim, art, plan dhe intelekt madhështor. E gjithë kjo është dëshmi që vërteton ekzistencën, njësinë dhe fuqinë e përjetshme të All-llahut. Për të zotët e mendjes është shkruar për të bërë lexuesit t’i shohin dhe t’i kuptojnë disa nga dëshmitë e krijimit në natyrë. Shumë mrekulli të gjalla shpalosen në këtë libër me qindra foto dhe shpjegime të shkurtra.

288 FAQE ME 467 FOTO ME NGJYRA




Ata të cilët janë të shtypur, të cilët torturohen për vdekje, foshnjat e pafajshme, ata të cilët nuk mund t’ia sigurojnë vetes as edhe një copë buke, të cilët janë të detyruar të flenë në tenda apo madje edhe në rrugë në mot të ftohtë, ata të cilët masakrohen vetëm sepse i takojnë një fisi të caktuar, gra, fëmijë dhe të moshuar të cilët janë dëbuar prej shtëpive të tyre për shkak të besimit të tyre... Përfundimisht, ekziston vetëm një zgjidhje për padrejtësinë, kaosin, terrorin, masakrat, urinë, varfërinë dhe shtypjen: morali i Kur’anit.

208 FAQE ME 276 FOTO ME NGJYRA

Ky libër na jep një pasqyrë në disa aspekte të mira morale të filozofisë Karma të cilat janë në pajtim me Kur’anin, si edhe pikëpamjet e saj të shtrembëruara të cilat bien ndesh me arsyen dhe ndërgjegjen njerëzore. Ky libër gjithashtu shpjegon pse ndjekja e rrugës së All-llahut dhe të jetuarit sipas Kur’anit është rruga e vetme drejt lumturisë, paqes dhe sigurisë së vërtetë.







A ju ka shkuar ndonjëherë në mendje që ju nuk ekzistonit para se të lindnit dhe papritmas u shfaqët në Tokë? A ju ka shkuar ndonjëherë në mendje se lëvorja e një banane, pjepëri, shalqiri apo një portokalli secila shërben si një paketim cilësor që ruan aromën dhe shijen e frutit? Njeriu është një qenie të cilës All-llahu i ka dhuruar aftësinë e të menduarit. E megjithatë, shumica e njerëzve nuk e shfrytëzojnë këtë aftësi ashtu siç duhet... Qëllimi i këtij libri është t'i ftojë njerëzit që të mendojnë ashtu siç duhet të mendojnë dhe t'i udhëzojë ata në përpjekjet e tyre për të menduar.

**128 FAQE ME 137 FOTO ME NGJYRA**

Darvini ka thënë: "Po të mund të demonstrohej se ka ekzistuar ndonjë organ kompleks, i cili kursesi nuk ka mundur të formohet përmes modifikimeve të shumta, të njëpasnjëshme, të vogla, teoria ime do të binte poshtë plotësisht." Kur e lexoni këtë libër, do të shihni se teoria e Darvinit ka rënë plotësisht, pikërisht ashtu siç kishte frikë ai se do të ndodhte.

Një ekzaminim i plotë i puplave të një zogut, sistemi sonar i një lakuriqi nate apo struktura e krahut të një mize zbulojnë projektme mahnitëse komplekse. Dhe këto projektme tregojnë se ata janë krijuar në mënyrë të përkryer nga All-llahu.

**208 FAQE ME 302 FOTO ME NGJYRA**




Dëshmitë e krijimit të All-llahut janë të pranishme kudo në gjithësi. Njeriu takon shumë prej këtyre dëshmimeve gjatë jetës së tij të përditshme; megjithatë nëse nuk mendon thellësisht, ai gabimisht mund t'i marr ato si detaje të parëndësishme. Në të vërtetë, në secilën krijesë ekzistojnë mistere të mëdha që të bëjnë për të menduar.


Këto kafshë me madhësi prej një milimetri të cilat shpesh i takojmë por për të cilat nuk lodhemi fare kanë një aftësi të mrekullueshme për organizim dhe specializim që nuk e ka asnjë qenie tjetër mbi faqen e dheut. Këto aspekte të milingonave nxisin tek njeriu një admirim të madh për fuqinë superiore dhe krijimin e pakrahasueshëm të All-llahut.

**165 FAQE ME 104 FOTO ME NGJYRA**

Kurrë mos u arsyeto me mosdije për ekzistencën e dukshme të All-llahut, se çdo gjë u krijuar nga All-llahu, se çdo gjë që ju posedoni ju është dhënë nga All-llahu për mbijetesën tuaj, se ju nuk do të qëndroni aq gjatë në këtë botë, për realitetin e vdekjes, se Kur'an i është Libri i së vërtetës, se ju do të jepni llogari për veprat tuaja, për zërin e ndërgjegjes suaj që gjithnjë ju thërrret në drejtësisë, për ekzistencën e jetës së përjetshme dhe ditën e llogaridhënies, se xhehennemi është banesa e përjetshme e ndëshkimit të ashpër dhe për realitetin e fatit.

**112 FAQE ME 74 FOTO ME NGJYRA**







Një nga arsyt kryesore pse njerëzit kanë një ndjenjë të thellë të dashurisë ndaj jetës dhe lënë mënjane fenë është supozimi se jeta është e përjetshme. Duke harruar se vdekja ka mundësi t'i jap fund kësaj jete në çdo kohë, njeriu thjesht beson se mund të gëzojë një jetë të përkryer dhe të lumtur. E megjithatë, ai vetëm se e mashtron veten e tij. Kjo botë është një vend i përkohshëm i krijuar posaçërisht nga All-llahu për të vënë njeriun në sprovë. Kjo është arsyeja pse ajo ka të meta në vetvete dhe është larg nga kënaqja e nevojave dhe dëshirave të pafund të njeriut. Secila dhe çdo joshje që ekziston në këtë botë në fund mbaron, degjenerohet dhe më në fund zhduket. Ky është realiteti i jetës që nuk ndryshon kurrë. Ky libër shpjegon këtë thelb më të rëndësishëm të jetës dhe e udhëzon njeriun që të mendojë për banesën e vërtetë të cilës ai i takon, domethënë Jetën e përtejme.

**224 FAQE ME 144 FOTO ME NGJYRA**

Shumë shoqëri që u rebeluan kundër vullnetit të All-llahut apo që i konsideruan të dërguarit e Tij si armiq u fshinë nga faqja e dheut tërësisht... Të gjitha ato u shkatërruan – disa nga një shpërthim vulkanik, disa nga një përmblytje katastrofike dhe disa nga një stuhie rëre...

Libri Popujt e Zhdukur shqyrton këto dënime të shpallura në ajetet e Kur'anit dhe në dritën e zbulimeve arkeologjike.

**149 FAQE ME 73 FOTO ME NGJYRA**




Ngjyrat, motivet, pikat, madje edhe vijat e secilës gjallesë që ekziston në natyrë kanë një kuptim. Për disa lloje, ngjyrat shërbejnë si mjet komunikimi; për tjerat, ato janë paralajmërim ndaj armiqve. Cilado qoftë arsyeja, këto ngjyra janë thelbësore për mirëqenien e gjallesave. Një sy i vëmendshëm menjëherë do të kuptojë se jo vetëm gjallesat, por edhe çdo gjë në natyrë janë pikërisht ashtu siç duhet të jenë. Për më tepër, do të kuptojë se çdo gjë është vënë në shërbim të njeriut; ngjyra qetësuese e kaltër e qiellit, pamja gjithë ngjyra e luleve, pemët dhe livadhet me ngjyrë gjelbër të ndritshme, hëna dhe yjet që ndriçojnë botën në errësirë së bashku me bukuri të panumërta që e rrethojnë njeriun...

**160 FAQE ME 215 FOTO ME NGJYRA**

Në një organizëm që përbëhet prej atomeve, ju thithni ajër, hani ushqim dhe pini lëngje që të gjitha përbëhen prej atomeve. Çdo gjë që shikoni nuk është asgjë tjetër veçse rezultat i përplasjes së elektroneve të atomeve me fotonet.

Në këtë libër, rrëfëhet papranueshmëria e formimit spontan të një atomi, të materialit ndërtues të çdo gjëje, të gjallë apo të vdekur, dhe demonstrohet natyra e përkryer e krijimit të All-llahut.

**139 FAQE ME 122 FOTO ME NGJYRA**



# LIBRAT PËR FËMIJË



## HARUN YAHYA NË INTERNET

MUND T'I GJENI TË GJITHA VEPRAT E HARUN YAHJASË NË INTERNET



www.harunyahya.com  
e-mail: info@harunyahya.com